



Analizë e gjendjes së menaxhimit me ujërat në Republikën e Maqedonisë dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve

Projekti

**“Qytetarët – partner aktiv në reformat e
politikave për ujë”**





Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian




Analizë e gjendjes së menaxhimit me ujërat në Republikën e Maqedonisë dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve

Projekti

**“Qytetarët – partner aktiv në reformat e
politikave për ujë”**





Dokument: “Analiza e gjendjes me menaxhimin e ujërave në Republikën e Maqedonisë dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve“ në kuadër të

Projekti „Qytetarët partner aktiv në reformat e e politikave për ujin“

IMPLEMENTUES: FLOROZON – QENDRA PËR DEMOKRACI EKOLOGJIKE

PARTNER: ORGANIZATA E KONSUMATORËVE TË MAQEDONISË

DONATOR: Sektori për Financim Qendror dhe Kontraktimit (SFQK) në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Maqedonisë si pjesë e programit: „Përfshirja e shoqërisë civile në reforma në rrugën drejt integritimit në BE“ (Europe Aid/138660/ID/ACT/MK)

Botues: QENDRA PËR DEMOKRACI EKOLOGJIKE FLOROZON – SHKUP

Dizajni grafik dhe shtypi: GRAFIK MAK PRINT

Me kontratë nr: 0307-23/12.03.2018

Raportin e hartoi: m-r Olgica Micevska, ing e dipl e biologjisë

Igor Kukullovski, ing i dipl i Mjedisit jetësor

Lubomir Petkovski, ing i dipl i Mjedisit jetësor

Miratoi: Kiril Ristovski, kryetar i QDE Floroton

Përgatiti për nevojat e projektit:

Shoqëria për Konsulencë Enviro Resursi SHPK Shkup

Tirazhi: 250 ekzemplarë

Shkup, mars 2018

Ky botim është prodhuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja, pikëpamjet dhe opinionet janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen për të pasqyruar pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



PËRMBAJTJE

HYRJE	5
1. PASQYRË E TË DREJTËS SË BE-së NË FUSHËN E UJËRAVE.....	7
1.1 Të dhëna të përgjithshme për të drejtën e BE-së në fushën e ujërave	8
1.2. Direktiva kornizë për ujëra.....	8
1.3. Direktiva për ujin e dedikuar për konsum nga njeriu	12
1.4. Direktiva për menaxhim me cilësinë e ujit për larje	13
1.5. Direktiva për ujërat e zeza urbane	14
1.6. Direktiva për vlerësim dhe menaxhim me rrezikun ngaj vërshimet	14
1.7. Direktiva për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja.....	15
1.8. Direktiva për ndotje të shkaktuar prej substancave të caktuara të rrezikshme që shkarkohen në mjedisin ujor.....	15
1.9. Rregullore tjera të BE-së nga sfera e mjedisit jetësor të rëndësishme për menaxhim me ujërat ...	15
1.10. Shkalla e transponimit të legjislacionit të BE-së për ujëra në legjislacionin nacional për ujërat .	17
2 MENAXHIMI ME UJËRAT NË LEGJISLACIONIN NACIONAL.....	19
2.1. Statusi i ujërave në Republikën e Maqedonisë.....	20
2.2. Dispozita me të cilat rregullohet menaxhimi me ujërat në Republikën e Maqedonisë.....	20
2.3. Ligji për mjedisin jetësor	20
2.4. Ligji për ujërat	22
2.4.1. Planifikim i zhvillimit dhe menaxhimi me ujërat.....	23
2.4.2. Shfrytëzimi i ujërave	26
2.4.3. Mbrojtja e ujërave	27
2.4.3.1. Qëllime të mjedisit jetësor	27
2.4.3.2. Shkarkime në ujëra	27
2.4.3.3 Zona të mbrojtura	27
2.4.4 Ujë i dedikuar për konsum nga njeriu	28
2.4.5 Ligji për siguri të ushqimit.....	29
2.4.6 Uji për larje	29
2.4.7. Ujërat e zeza urbane	30
2.4.8. Zona sensitive ndaj nitrateve	32
2.4.9. Mbrojtje nga ndikimi ndikimi i dëmshëm i ujërave	32
2.4.9.1. Vërshime	32
2.4.9.2. Mbrojtje nga erozioni dhe rregullim i rrëkeve	32
2.4.10. Monitorimi i ujërave	33
2.4.11. Sistemi i informimit për ujërat.....	33
2.4.12. Shërbime dhe objekte të ekonomive ujore	34
2.4.13 Furnizimi me ujë.....	34



2.4.14. Furnizim me ujë të pijshëm dhe kullimi i ujërave të zeza urbane	35
2.4.15. Vadtja dhe kullim i ujërave	36
2.4.16. Ekonomi të ujërave	36
2.4.17. Çmime të shërbimeve ujore	37
3 SHPËRNDARJA E INGERENCAVE NË MENAXHIMIN ME UJËRAT NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL.....	39
3.1. Kompetenca në nivel qendror në menaxhimin me ujërat	40
3.2. Kompetenca të njëjësive të vetëqeverisjes lokale në menaxhimin me ujërat	43
4 FINANCIMI I MENAXHIMIT ME UJËRAT DHE INVESTIMET NË SEKTORIN E UJËRAVE.....	45
4.1 Investime në Sektorin e ujërave	46
4.2 Programi për menaxhim me ujëra.....	46
4.3. Programe tjera me të cilat financohen aktivitete në sektorin e ujërave.....	48
5 MBROJTJA E TË DREJTAVE TË KONSUMATORËVE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE PËR UJËRAT DHE MENAXHIMIN ME UJËRAT	51
5.1. Të drejtat e konsumatorëve.....	52
5.1.1 Rregullore për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.....	53
5.1.2. Të drejtat e konsumatorëve në Ligjin për veprimtaritë komunale	54
5.1.3 Konsumatorët në dispozitat për ujërat	55
5.1.3.1 Ligji për përcaktimin e çmimit të shërbimeve ujore.....	55
5.1.3.2 Ligji për furnizim me ujë të pijshëm dhe kullim të ujërave të zeza urbane	59
6 PUBLIKU NË DISPOZITAT PËR MJEDIS JETËSOR	61
6.1 Publiku në Ligjin për mjedis jetësor	62
6.2 Publiku në dispozitat për ujërat.....	63
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	65



HYRJE

Uji paraqet një prej elementeve kyçe për realizimin e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit jetësor. Gjendja dhe cilësia e ujërave janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin socio-ekonomik, mbrojtjen e mjedisit jetësor si dhe për ekzistencën dhe mirëqenien e njerëzimit. Si resurs i pazëvendësueshëm i kufizuar, mund të rigjenerohet vetëm nëse i njëjti menaxhohet në mënyrë adekuate.

Menaxhimi i qëndrueshëm me resurset ujore paraqet sfidë të madhe dhe nëse ato menaxhohen në mënyrë efikase dhe të baraspeshuar, uji mund të ketë rol kyç në sigurimin e mirëqenies sociale, prosperitetin ekonomik si dhe ekosisteme të shëndosha.

Menaxhimi me “bilansin ujqor” është baza e politikës për menaxhim efektiv me ujërat. Çekuilibrimi gjithnjë e më i madh mes ofertës dhe kërkesës për ujë në shumë pjesë të Evropës, si dhe në Maqedoni, dispozicioni i ujit dhe mungesa e ujit gradualisht janë shndërruar në pikat kryesore gjatë krijimit të politikave për ujë në nivel nacional dhe në nivel të BE-së. Ndryshimet në dispozicionin e ujit do të kenë ndikim negativ mbi ekosistemet dhe mbi disa sektorë socio-ekonomik, duke përfshirë pompimin e ujit të pijshëm, për bujqësi, industri, prodhim të energjisë elektrike dhe për lundrim. Një prej obligimeve themelore nga politika e BE-së për ujëra është të bëhet identifikimi dhe matja e qartë rreziqeve nga mungesa e ujit.

Resurset ujore në Maqedoni përdoren për më shumë dedikime, përkatësisht për aktivitete të cilat nënkuptojnë akumulim, kapje, abstraksion për:

- konsum nga njerëzit për më shumë qëllime, si: vaditje, nevoja industriale dhe teknologjike, nevoja ekonomike dhe tjera.;
- prodhim të energjisë elektrike;
- kultivim të peshkut, transport, lundrim;
- sport, rekreacion, larje, turizëm dhe qëllime tjera.

Në këtë analizë, theksi kryesor do të vendoset në shfrytëzimin e ujit dhe dispozicioni i ujit për konsumatorët – sektori qytetar, si dhe përfshirja e tyre në krijimin e politikave për menaxhimin e ujërave dhe krijimin e politikës për formulimin e çmimeve për shërbimet ujore.

Raporti përmban analizë të rregullores nacionale ekzistuese në fushën e menaxhimin me ujërat, si dhe rregullores së BE-së. Është pasqyruar edhe shkalla e zbatimit të legjislacionit nacional dhe gjendjes me transponimin e rregulloreve të BE-së.

Gjithashtu, analiza fokusohet edhe në qasjen e publikut tek informatat me karakter publik nga fusha e mjedisit jetësor, konkretisht ujërat dhe mënyra e pjesëmarrjes së tyre në miratimin e vendimeve për menaxhim me ujërat.

Janë identifikuar organet përgjegjëse në nivel nacional dhe lokal, organet kryesore në menaxhimin me ujërat dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me legjislacionin nacional.

Është shqyrtuar edhe financimi i menaxhimit me ujërat përkatësisht burimet e financimit të parapara në legjislacionin nacional.

Në fund janë paraqitur konkluzione dhe rekomandime nga aspekti i pjesëmarrjes së publikut në gjithë procesin e menaxhimit me ujërat, si dhe të drejtat e obligimet e shfrytëzuesve të fundit të shërbimeve në rastin konkret të shërbimeve ujore.



Lista e shkurtesave

BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
VA	Vende anëtare
DKU	Direktiva kornizë për ujëra
SNU	Strategjia nacionale për ujërat
BEU	Baza për ekonomi ujore
PMPL	Plane për menaxhim me pelëgjet lumore
NPAA	Programi nacional për miratimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian
MMJPH	Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor
MTL	Ministria për transport dhe lidhje
MSH	Ministria e shëndetësisë
AUV	Agjencia për ushqim dhe veterineri
QRM	Qeveria e Republikës së Maqedonisë
NJVL	Njësi të vetëqeverisjes lokale
QSHP	Qendra për shëndet publik
NPFU	Ndërmarrja publike për furnizim me ujë
ISHP	Institut për shëndet publik
LU	Ligji për ujërat
LMJ	Ligji për mjedisin jetësor
LMK	Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve
LVK	Ligji për veprimtaritë komunale
OKM	Organizata e konsumatorëve të Maqedonisë

Projekti “Qytetarët – partner aktiv në reformat e politikave për ujë”

“Analizë e gjendjes së menaxhimit me ujërat në Republikën e Maqedonisë dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve”

1 PASQYRË E TË DREJTËS SË BE-së NË FUSHËN E UJËRAVE

1.1 Të dhëna të përgjithshme për të drejtën e BE-së në fushën e ujërave

Sfera e mjedisit jetësor është një prej fushave më komplekse në Bashkimin Evropian që është rregulluar me numër të madh të akteve juridike, me të cilat janë rregulluar mediat dhe fushat e mjedisit jetësor. Si pjesë nga fusha e mjedisit jetësor përkatësisht si medium i mjedisit jetësor, sfera e ujërave është rregulluar me numër të madh aktesh juridike të cilat rregullojnë aspekte të ndryshme të ujërave.

Aktet kryesore juridike të BE-së me të cilat rregullohet menaxhimi me ujërat janë:

- Direktiva kornizë për ujëra 2000/60/KE;
- Direktiva e Këshillit 91/271/EEC për trajtimin e ujërave të zeza urbane;
- Direktiva e Këshillit 98/83/EC për cilësi të ujit të pijshëm;
- Direktiva e Këshillit 2006/7/EC për cilësi të ujit për larje;
- Direktiva 2007/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për vlerësim dhe menaxhim me rrezikun nga vërshimet;
- Direktiva 2006/11/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për ndotjen e shkaktuar prej substancave të caktuara të rrezikshme të cilat shkarkohen në mjedis ujor dhe
- Direktiva e Këshillit 2006/118/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe cenimi i cilësisë.

Përkrah akteve specifike juridike me të cilat rregullohet menaxhimi me ujërat, duhet të përmendet se menaxhimi me ujërat është rregulluar edhe me akte tjera juridike të cilat plotësojnë njëra tjetrën, e me të cilat rregullohet fushat tjera nga mjedisi jetësor. Ato do të analizohen më poshtë në këtë analizë ¹.

Në këtë kapitull do të prezantohen aktet juridike në BE me të cilat rregullohet menaxhimi me ujërat. Më shumë vëmendje u është përkushtuar akteve juridike të cilat drejtpërdrejtë rregullojnë çështje të caktuara prej të cilave drejtpërdrejtë rezultojnë të drejtat dhe obligimet për pjesëmarrësit kryesor në menaxhimin me ujërat siç janë aktet me të cilat rregullohet menaxhimi i integruar me ujërat (DKU), uji i dedikuar për konsum nga njeriu, ujërat për larje, ujërat e zeza urbane dhe vlerësimi dhe mbrojtja nga vërshimet.


1.2. Direktiva kornizë për ujëra

Akti kryesor juridik i Bashkimit Evropian që e rregullon fushën e ujërave është Direktiva kornizë për ujëra 2000/60/KE (DKU). DKU-ja i vendos qëllimet dhe udhëzimet kryesore të politikës për menaxhim me ujërat, me të cilat vendoset menaxhim i integruar me ujërat në BE si dhe theksohet nevoja për integrimin e mëtejshëm të mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm me ujin edhe në politikat tjera nga fusha e energjisë, komunikacionit, bujqësisë, vivarëve, politikës rajonale dhe turizmit. Me këtë Direktivë veçanërisht promovohet bashkëpunimi dhe veprimtaria e përbashkët në nivel të Bashkësisë dhe në nivel lokal si dhe shkalla e informimit, konsultimit dhe inkuadrimit të publikut, duke i përfshirë edhe shfrytëzuesit.

Vendosja e menaxhimit të integruar me ujërat në suazat e Bashkimit Evropian bëhet me qëllim që të:

- parandalohet shkatërrimi i mëtejshëm, të mbrohet dhe të përmirësohet gjendja e ekosistemeve ujore, si dhe ekosistemeve tokësore dhe moçaleve të cilat sa i përket nevojave të tyre për ujë drejtpërdrejtë varen nga ekosistemet ujore;
- promovohet shfrytëzimi i qëndrueshëm i ujit, i bazuar në mbrojtjen afatgjatë të resurseve ujore në dispozicion;
- ndërmerren masa për mbrojtje të përforcuar dhe përmirësim të mjedisit jetësor, ndër tjerash, edhe përmes masave të veçanta për reduktim progresiv ose për përjashtim gradual të shkarkimeve, emitimeve dhe humbjeve të substancave prioritare dhe
- kontribuohet në zbutjen e efekteve nga vërshimet dhe nga thatësit, me çka do të kontribuohet për: sigurim të furnizimit të mjaftueshëm me ujë me cilësi të mirë dhe shfrytëzim i qëndrueshëm, i baraspeshuar dhe i drejtë i ujit.

¹ Të analizuar në kapitullin e njëjtë pika 1.9 – Rregulloret tjera të BE nga fusha e mjedisit jetësor relevante për menaxhimin me ujërat



Obligimet kryesore të cilat vendet anëtare (VA) duhet t'i ndërmarrin, e me të cilat duhet të mundësohet zbatim i qëllimeve të hartuara nga Direktiva janë këto:

- të përcaktojnë pellgjet e veçanta lumore në suazat e territorit të tyre shtetëror dhe gjatë kësaj për çdo rajon të pellgut lumor të sigurojnë organizim përkatës administrativ dhe të përcaktojnë organ kompetent për zbatim të rregullave të Direktivës;
- për çdo rajon të pellgut lumore ose për pjesën e rajonit të pellgut lumor ndërkombëtar në territorin e tyre, të përgatisin analizë të karakteristikave të secilit pellg, të ndikimit të veprimeve të njeriut mbi gjendjen e ujërave dhe analizë ekonomike për shfrytëzimin e ujit të cilat do të bëhen në përputhje me specifikacione teknike;²
- të përgatisin Plan për menaxhim me çdo rajon të pellgut lumor që tërësisht gjendet në territorin e tyre;
- të stimulojnë përfshirje aktive të të gjithë palëve të interesuara në zbatimin e Direktivës, veçanërisht gjatë përpilimit, revizionit dhe azhurnimit të PMPL. Veçanërisht i rëndësishëm është obligimi për publikimin e PMPL për çdo rajon të pellgut lumor dhe të njëjtat të jepen në shqyrtim të opinionit publik, duke përfshirë edhe shfrytëzuesit që të mund pranojnë komente prej tyre;
- në kuadër të secilit rajon të pellgut lumor i përcaktojnë të gjithë trupat ujqor që përdoren për eksplrim të ujit të dedikuar për konsum nga njeriu, e që sigurojnë mesatarisht më tepër se 10m³ në nivel ditë ose shërbejnë më tepër se 50 persona dhe ato trupa ujqor që në të ardhmen duhet të shfrytëzohen për atë qëllim. E sigurojnë mbrojtjen e domosdoshme të trupave të identifikuar ujqor, për të shmangur dobësimin e cilësisë së tyre, për të reduktuar trajtimin për trajtimin e nevojshëm për sigurimin e ujit të pijshëm. VA mund të vendosin zona të mbrojtura për ato trupa ujqor;
- të përpilojnë programe për përcjelljen e gjendjes së ujërave, me qëllim të vendosin pasqyrë koherente dhe gjithëpërfshirëse të gjendjes së ujërave në suazat e secilit rajon të pellgut lumor dhe
- obligohen që për çdo rajon të pellgut lumor ose për pjesë të rajonit të pellgut lumor ndërkombëtar, që gjendet në territorin e tyre, të përgatisin Program të masave ku do të përfshihen masat “themelore” që janë kërkesat minimale që duhet të respektohen dhe masat “shitesë” të cilat janë të projektuara dhe realizohen si plotësim i masave themelore.

Ekzemplarët e PMPL dhe të gjitha azhurnimet e planeve në vazhdim parashtrihen deri te Komisioni Evropian (KE) dhe të gjitha VA tjera të prekura, në afat prej tre muajsh pas publikimit të tyre.

VA kanë për obligim të parashtrojnë raporte përmbledhëse të analizave për ndikimin ekonomik dhe programet për përcjellje në afat prej tre muajsh pas përfundimit të tyre.


Në afat prej tre viteshe pas publikimit të çdo PMPL ose azhurnimit të tij, VA janë të obliguara, në ndërkohë, të parashtrojnë raport në të cilin do të përshkruhet progresi në lidhje me zbatimin e Programit të masave.

VA do të vendosin regjistër ose regjistra në të gjitha zonat që gjenden në kuadër të secilit nga rajonet e pellgjeve lumore të cilat janë përcaktuar si zona që kërkojnë mbrojtje të veçantë.

KE në përputhje me dispozitat e Direktivës ka për obligim të publikojë:

- raport për zbatimin e Direktivës më së shumti 12 vite pasi të hyj në fuqi, në të cilin do të përfshihen këto dokumente: revizion i progresit për zbatimin e Direktivës, revizion i gjendjes së ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore në Bashkimin (Evropian), shqyrtim të PMPL, duke përfshirë edhe propozimet për përmirësimin e planeve të ardhshme, përmbledhje të të gjitha propozimeve, masa dhe strategji kontrolluese.
- raport për përparimin gjatë zbatimit, i bazuar në raportet e përmbledhura të cilat VA si dhe raporti i ndërkohshëm në të cilin përshkruhet përparimi në zbatimin, që bazohet në raportet e ndërkohshme të VA në pajtim me afatet e përcaktuara në Direktivë.
- në pajtim me ciklin e parashtrimit të raporteve, të organizojë konferencë të palëve të interesuara nga secili VA për politikën ujore të Bashkimit, në të cilën do të shqyrtohen raportet e Komisionit në mënyrë që VA t'i këmbëjnë përvojat e tyre. Veçanërisht theksohet që në mesin e pjesëmarrësve duhet të inkuadrohen përfaqësues të organeve kompetente, përfaqësues të Parlamentit Evropian, të organizatave joqeveritare, partnerët social dhe ekonomik, trupat e konsumatorëve, qytetarët akademik dhe ekspert tjerë.

² janë paraqitur në Shtojcat II dhe III të DKU



Gjatë plotësimin të qëllimeve të DKU-së, VA mbajnë llogari për parimin “mbulim i shpenzimeve për shërbimet ujore”, duke përfshirë shpenzimet për mjedis jetësor dhe për resursin, në pajtim me analizën e zbatuar ekonomike³ dhe për parimin “ndotësi paguan”.

VA duhet të sigurojnë që politika për çmim të shërbimeve ujore në do t'i nxit mënyrë adekuate shfrytëzuesit që ta shfrytëzojnë resursin ujor në mënyrë efikase me çka do të kontribuojnë për plotësimin e qëllimeve për mjedisin jetësor dhe do të sigurohet kontribut përkatës për shfrytëzimet e ndryshme të ujit (të ndara së paku në industri, ekonomitë familare dhe bujqësi), për mbulimin e shpenzimeve për ujë në pajtim me parimin “ndotësi paguan” dhe gjatë kësaj mund të merren parasysh efektet sociale, ekologjike dhe ekonomike të rimëkëmbjes, si dhe kushtet gjeografike e klimatike të rajonit ose rajoneve të godtura. Nuk konsiderohet si shkelje e Direktivës nëse VA vendosin që, në pajtim me praktikatat e vendosura, të mos i aplikojnë tërësisht dispozitat (neni 9 paragrafi (1) fjalia e dytë), duke i prezantuar në atë rast edhe arsyet për aplikimin e pjesshëm të dispozitave në planet për menaxhim me pellgjet lumore.

Parimi i mbulimit të shpenzimeve aplikohet për të siguruar financim të mjaftueshëm të aktivitetit, ose të zvogëlohet nevoja për subvencionim. Nga ajo perspektivë, kthimi i shpenzimeve është çështje e qëndrueshmërisë dhe barazisë ekonomike (ose financiare). Në shumë raste, kur matet kuantiteti i shërbimit, sigurohet stimulim që me shpenzimin për arkëtim të bëhet ndryshimi i konsumit që pasqyrohet edhe në arkëtimin. Për shërbimet ujore, ky nuk është gjithmonë rasti, por ekzistojnë shumë raste kur shërbime për furnizim me ujë dhe shërbime për ujërat e zeza janë paguar duke e përdorë parimin e normave (d.m.th. konsum i mesatar supozuar). Në raste të tilla kur konsumatori paguan në bazë të normës dhe konsumi i tij real nuk ndikon në pagesën, atëherë nuk ekziston stimul për t'u optimizuar shfrytëzimi i ujit. Është e rëndësishme të theksohet se mbulimi i shpenzimeve dhe çmimeve stimuloese janë dy koncepte të ndryshme. Kur bëhet fjalë për mbulimin e shpenzimit për shërbim, në mënyrë implicite supozohet se shpenzimi për mbulim gjithashtu gjeneron stimul për shfrytëzim racional të shërbimit. Megjithatë, mbulimi i shpenzimit vetvetiu nuk e përkrah realizimin e qëllimeve të DKU-së. Në rast të çmimit volumetrik të ujit (për shembull, kur konsumi i ujit matet) arkëtimi i plotë i shpenzimeve do të nënkuptojë stimul më të madh.

Koncepti i parimit “ndotësi paguan” bazohet në idenë se pagesa varet nga shkalla e shkaktuar e ndotjes. Ndërkohë që çmimet e ujit që sigurojnë mbulim të shpenzimit mund të mos varen nga shuma e vërtetë e ujit të shfrytëzuar ose ngarkesa e ndotjes së emituar. Parimi “ndotësi paguan” donë të thotë se pagimi duhet të ndërlihet me shfrytëzimin faktik të ujit, ose me ndotjen e ujërave që ndodh nga shkarkimi i ujërave ose që ekziston kontribut i të gjithë shfrytëzuesve në raport me konsumin ose ndotjen. Parimi “ndotësi paguan” është elementi kritik në DKU⁴, për shkak se mbulimi i shpenzimit duhet të zhvillohet veçanërisht në pajtim me këtë parim dhe duhet të sigurohet kontribut i përshtatshëm nga shfrytëzimi i ndryshëm i ujërave duke marrë parasysh parimin “ndotësi paguan”. Ekziston numër i madh i çështjeve të pazgjdhura në lidhje me atë se si ky parim aplikohet në praktikë veçanërisht në lidhje me:

- identifikim të “ndotësit” dhe “viktims” si dhe mundësia për të vendosur lidhje (të drejtpërdrejtë) shkak-pasojë ndërmjet aktiviteteve të “ndotësit” dhe dëmit që ka pësuar “viktima”.

Kjo kërkon shqyrtim të detajuar të mekanizmave të përfshirë të cilët “e përkthejnë” efektin konkret (për shembull, çlirim të sasisë së ndotësit X në trupin konkret ujor) në dëmtim specifik (për shembull, zvogëlim ose dëmtim të popullatës specifike të peshkut). Kjo në masë të madhe përkon me vështrimet e nevojshme për llogaritjen e shpenzimeve për mjedisin jetësor dhe resurset, mirëpo ekzistojnë sfida shtesë për shembull, në lidhje me kontributin e secilit ndotës në dëmin e përgjithshëm. Kjo në veçanti është e rëndësishme në rastin për ndotje difuzive. Këto çështje problematike të cilat rezultojnë nga aplikimi i parimit “ndotësi paguan” nuk janë të kufizuara me DKU, ato janë relevante për të gjitha fushat e politikës për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Nevojiten hulumtime specifike për aplikimin e parimit “ndotësi paguan” në politikën për ujëra për t'u siguruar shqyrtime në sfidat konkrete që rezultojnë nga kjo fushë.

Është e mundur të sigurohet mbulim i plotë i kthimit të shpenzimeve në mënyrë që nuk siguron stimul për shfrytëzimin efikas të resursit dhe prandaj nuk ka ndikim mbi, për shembull, ruajtjen e ujit. Gjithashtu është e mundur të bëhen nxitje/stimulime pa u arritur mbulim i shpenzimeve. Stimulimet kërkojnë që çmimi të jetë i lidhur me parametër me të cilin dëshirohet të ndikohet. Çmimet e caktuara në bazë të vëllimit të ujërave të caktuar në pajtim me konsumin e matur janë të domosdoshme për përfshirje të stimulit për kursim të ujit.

³ Në pajtim me Shtojcën 3 të DKU

⁴ Neni 9 nga DKU



Prandaj parakusht për çdo skemë për stimulimin e çmimeve është se konsumi i ujit është matur ose matet në një mënyrë ose tjetër.

Përgjithësisht, mund të konstatohet se stimuluesit drejtpërdrejtë ndikojnë në realizimin e qëllimeve të DKU-së, nëpërmjet sigurimit të nxitjes, përkatësisht stimulimit të shfrytëzimit efikas të ujërave. Megjithatë, sido që të jetë, aplikimi i parimit për “mbulim të shpenzimeve” dhe i parimit “ndotësi paguan” do të kontribuojnë drejt realizimit të qëllimeve të DKU-së me sigurimin se ata të cilët shkaktajnë harxhime (duke përfshirë edhe shpenzimet për mjedisin jetësor) në lidhje me konsumin dhe shfrytëzimin e ujit kontribuojnë në ato.

Në aspekt më të gjerë, mund të vlerësohet që nëse strategjia për çmimet ka të bëjë me sasinë e resursit që përdoret ose me nivelin e ndotjes (çmime stimuluese për shfrytëzim racional të ujërave), atëherë dy parimet tjera duhet të sigurojnë shpërndarjen e drejtë të shpenzimeve ndërmjet shfrytëzuesve të ujit (parimi - ndotësi paguan) dhe mes sektorit ekonomik me zvogëlimin ose eliminimin e subvencioneve për shërbimet ujore (mbulim i shpenzimit).

Është e qartë se dizajni i çmimeve të nevojshme për realizimin e qëllimeve të DKU-së gjithashtu do të varet nga interpretimi dhe operacionalizimi i këtyre qëllimeve nga VA. Krahas asaj, çmimet e ujit duhet t'i marrin parasysh rrethanat specifike të VA, veçanërisht instrumente tjera të politikës që përdoren për (ose mund të kontribuojnë për) arritjen e qëllimeve të DKU-së. Tre nën-objektivat e cekura sipër janë kompatible ndërmjet tyre në esencë, për arsye se është e mundur të dizajnohet strukturë e çmimeve e cila siguron stimulim, i mbulon shpenzimet dhe bazohet në shfrytëzimin/kontributin faktik nga secili shfrytëzues i shërbimeve ujore.

Përveç kësaj, parimi i mbulimit të shpenzimeve dhe çmimet stimuluese kanë potencial të konsiderueshëm të ndihmojnë në plotësimin e qëllimeve të hartuara në suazat e politikave tjera. Veçanërisht mund të ndihmojnë në zbutjen e ndikimeve dhe rastet e mungesës së ujit dhe dukurive të thatësirave nëpër mbarë Evropën (nëpërmjet zvogëlimit të kërkesës për ujë dhe promovimit potencial të burimeve alternative për furnizim me ujë), si dhe të luajnë rol në adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, për shkak se ndikimi i çmimeve stimuluese për ujë në lidhje me zbutjen e mungesës së ujit dhe thatësirave, si dhe në parandalimin dhe zbutjen e vërshimeve, gjithashtu janë pjesë e mbështetjes për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike.

Duke pasur parasysh qasjen e ndryshme në zbatimin e politikës së çmimeve për shërbimet ujore në pajtim me DKU-në, nuk është e mundur të bëhet vlerësim absolut për kontributin në sferat tjera të politikës. Për shembull, qasjen që e zgjedhin VA në përkufizimin e shfrytëzimit të ujit dhe shërbimeve, kurse me atë edhe sektorët për të cilët vlejnë DKU-të do të kenë rol të rëndësishëm në përcaktimin e kontributit të saj në sferat tjera të politikës. Implementimi i plotë i këtyre parimeve (përkufizimi i parimit ndotësi paguan etj.) ka potencial të maksimizojë kontributin drejt plotësimit të qëllimeve tjera të politikave të sferave të ndryshme.

Politika të cilat janë identifikuar, ku çmimet e ujit mund të sigurojnë ndërveprim në lidhje me arritjen e rezultateve nga politika janë:

- mungesa e ujit dhe thatësira, zbutje të vërshimeve
- adaptim ndaj ndryshimeve klimatike dhe
- zhvillim i qëndrueshëm.

1.3. Direktiva për ujin e dedikuar për konsum nga njeriu

Uji i dedikuar për konsum nga njeriu është rregulluar me Direktivën 98/83/BE i Këshillit për cilësi të ujit i dedikuar për konsum nga njeriu nga 3 nëntori i vitit 1998. Direktiva është ndryshuar dhe plotësuar me:

- Rregulloren (KE) nr. 1882/2003 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit nga 29 shtator 2003;
- Rregulloren (KE) nr. 596/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit nga 18 qershor 2009 dhe
- Direktivën e Komisionit (BE) 2015/1787 nga 6 tetori 2015.

Qëllimi i Direktivës është mbrojtja e shëndetit të njerëzve prej ndikimeve negative të cilat mund të shfaqen nga çdo lloj ndotje e ujit të dedikuar për konsum nga njeriu, duke siguruar gjatë kësaj se uji është i pastër dhe i sigurtë.

Zbatimi i Direktivës do të mundësojë:

- Parandalim të ndikimit negativ mbi shëndetin e njeriut në rast të ndotjes së ujit të pijshëm;
- sigurim të ujit të pastër dhe të sigurt të pijshëm për shfrytëzuesit;
- realizim të mbikëqyrjes së cilësisë së ujit të pijshëm dhe
- ndërmarrje adekuate dhe me kohë të masave në rastet kur do të vjen deri te devijimi sa i përket cilësisë së ujit të pijshëm.

Direktiva përcakton obligim për sigurim të kontrollimit të ujit të pijshëm nëpërmjet instalimit të standardeve në pajtim me zbulimet më të reja shkencore, kontroll përkatës, vlerësim dhe aplikim të cilësisë së ujit të pijshëm.

VA në pajtim me Direktivën, kanë për obligim:

- t'i ndërmarrin masat e duhura me qëllim që uji të mos përmban koncentracione të mikroorganizmave, parazita ose substanca të dëmshme të cilat mund të jenë të rrezikshme për shëndetin e njerëzve, si dhe për të plotësuar standardet minimale gjatë shfrytëzimit të ujit nga sistemet publike për furnizim me ujë ose nga autobotet.
- të realizojnë kontroll të rregullt të ujit në pika paraprakisht të caktuara të matjes me qëllim të verifikimit nëse uji i plotëson vlerat e parametrave mikrobiologjike, kimike dhe indikative.
- t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme me të cilat do të mundësohet monitorim i rregullt i cilësisë së ujit të dedikuar për konsum nga njeriu në pajtim me kërkesat në Direktivë, me qëllim që uji në dispozicion të konsumatorëve të jetë konform vlerave të parametrave të përcaktuar.
- organet kompetente të përgatisin programe përkatëse për monitorimin e të gjitha ujërave të dedikuara për konsum nga njeriu në pajtim me kërkesat minimale ⁵.
- në rastet e mospërbushjes së standardeve menjëherë duhet të zbatohet hetim dhe të ndërmerren masa adekuate korigjuese, kurse në ndërkohë duhet të ndalohet ose kufizohet furnizimi me ujë në qoftë se konstatohet se konsumi i ujit është kërcënim për shëndetin publik.
- në të gjitha rastet e mospërbushjes së standardeve të përkufizuara do të duhet të hetohet shkaku për atë dhe menjëherë të veprohet në drejtim të ndërmarrjes së aktiviteteve për mënjanimin e arsyes për të cilën nuk janë plotësuar standardet. Në atë rast VA duhet të sigurohen që uji për pije që paraqet rrezik potencial për shëndetin e njerëzve të ndalohet ose përdorimi i tij të kufizohet ose të ndërmarret veprim tjetër për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve. Në situatat e përmendura, konsumatorët duhet të njoftohen me kohë dhe t'u jepet këshilla e domosdoshme. Organi kompetent do të vendosë çfarë veprimi do të ndërmerr, duke mbajtur gjatë kësaj llogari për rrezikun mbi shëndetin e njerëzve që mund të shfaqet si rezultat i ndërprerjes së furnizimit ose kufizimit të shfrytëzimit të ujit të dedikuar për pije.
- Në rast të mos harmonizimit me vlerat e parametrave ose me specifikacionet e caktuara në Direktivë⁶, VA kanë për obligim të përcaktojnë nëse ajo mungesë harmonizimi paraqet rrezik për shëndetin e njerëzve. Për shkak të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, VA kanë për obligim të ndërmarrin masa ndihmëse për të kthyer cilësinë e ujit dhe atë:

⁵ Kërkesat minimale janë caktuar në Aneksin II të Direktivës 98/83/UE të Këshillit për cilësi të ujit të dedikuar për konsum nga njeriu

⁶ Shtojca I, Pjesa V e Direktivës 98/83/UE të Këshillit për cilësinë e ujit të dedikuar për konsum nga ana e njeriut

- kur ndërmerren masa korigjuese, për çka konsumatorët informohen, përveç në rastet kur organet kompetente vlerësojnë se mos harmonizimi me vlerën e parametrave është i parëndësishëm;
- në çdo 3 vite, të publikojnë raport për cilësinë e ujit. Informatën e këtillë për publikun ta dërgojnë në KE;
- rregullisht të sigurojnë të dhëna të azhurnuara për cilësinë e ujit të pijshëm për konsumatorët e tyre dhe
- të përpilojnë raport trevjeçar për cilësi të ujit të pijshëm për shkak të informimit të konsumatorëve.

Në vitin 2015, me Direktivën e Komisionit (BE) 2015/1787 nga 6 tetori 2015 ndryshohen Shtojcat II dhe III të Direktivës 98/83/UE së Këshillit për cilësi të ujit të dedikuar për konsum nga njeriu. Për të përmirësuar kontrollin e ujit të pijshëm, me këtë direktivë VA u jepet fleksibilitet më i madh në lidhje me kontrollin e ujit në suazat e BE-së që është në pajtim me kërkesat e qytetarëve të BE-së për furnizim më të sigurt, më të drejtë dhe më gjithëpërfshirës me ujë. Përcaktohen standardet thelbësore për cilësi të ujit në nivel të BE-së dhe përcaktohet obligimi për monitorim të rregullt të gjithsej 48 parametrave mikrobiologjik, kimik dhe indikativ.

Në pajtim me këtë Direktivë, KE obligohet në çdo 3 vite të publikojë raport në të cilin do të jenë sintetizuar të dhënat nacionale për cilësinë e ujit të pijshëm dhe në çdo 5 vite bëhet revidim i parametrave mikrobiologjik, kimik dhe indikativ dhe i specifikacioneve për kontroll, duke pasur parasysh përparimin e teknologjisë dhe shkencës.

1.4. Direktiva për menaxhim me cilësinë e ujit për larje

Ujërat për larje janë rregulluar me Direktivën për menaxhim me cilësinë e ujit për larje 2006/7. Direktiva e rregullon monitorimin, klasifikimin dhe menaxhimin me cilësinë e ujërave për larje si dhe përmban dispozita për informim të publikut për cilësinë e ujërave për larje.

Qëllimi i Direktivës është mbrojtja, përmirësimi dhe ruajtja e cilësisë së mjedisit jetësor dhe shëndetit të njerëzve nëpërmjet plotësimit të Direktivës Kornizë për Ujëra.

Direktiva aplikohet për ujërat sipërfaqësore të dedikuara për larje dhe e njëjta nuk vlen për pishinat për rekreacion dhe banjat termale, ujërat e rrethuara të cilat janë objekt trajtimi ose shfrytëzohen për qëllime terapeutike dhe ujërat e rrethuara artificiale të ndara prej ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Kriteret kryesore të Direktivës janë këto:


- vendosje të kalendarit për monitorim të secilës zonë të ujërave për larje para çdo sezoni për larje;
- vlerësim i ujërave për larje;
- klasifikim i ujërave për larje në bazë të kriterëve të vendosura sipas të cilave uji për larje mund të klasifikohet si i pasigurt, mjaft i sigurt, i mirë dhe i shkëlqyeshëm;
- përcaktim i masave konkrete për menaxhim, ndalesë për larje ose vendosje të shënimeve kundër kësaj, sigurim të informatave për publikun ose masa përkatëse ku cilësia është e vlerësuar si e ulët;
- përcaktim të profilit të ujërave për larje dhe
- sigurim të informatave të duhura për publikun në lidhje me klasifikimin dhe përshkrimin e ujërave për larje si dhe informata për masat mbrojtëse.

VA kanë për obligim që publikut t'i sigurojnë pjesëmarrje në zbatimin e Direktivës dhe t'i sigurojë mënyrat me të cilat publiku mund të merr pjesë dhe atë:

- të gjej mënyrë të merr pjesë;
- për formulimin e propozimeve, vërejtjeve dhe ankesave. Kjo veçanërisht ka të bëjë me vendosjen, kontrollimin dhe azhurnimin e listës së ujërave për larje. Organet kompetente janë të obliguara t'i marrin parasysh informatat e pranuar.

Në këtë Direktivë janë përmendur informatat të cilat duhet të publikohen në vende të arritshme afër secilës zonë ujore për larje me të cilat në kohë do të informohet publiku gjatë sezonit të larjes.

Lista e ujërave për larje duhet të jetë në dispozicion çdo vit para fillimit të sezonit veror. Rezultatet nga klasifikimi i secilës zonë ujore duhet të publikohen në internet pas përfundimit të analizës.



VA dhe KE, nëse është e mundur, sigurojnë informata për opinionin duke përdorur teknologji adekuate dhe i paraqesin në mënyrë të qartë dhe koherente, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të shenjave dhe simboleve.

1.5. Direktiva për ujërat e zeza urbane

Direktiva për ujërat e zeza urbane 91/271 prej 21 maj 1991, është ndryshuar dhe plotësuar me Direktivën e Komisionit 98/15/UE nga 27 shkurt 1998, për ndryshim të Direktivës që ka të bëjë me kërkesat e caktuara në Shtojcën 1 të Direktivës. Qëllimi kryesor i direktivës është mbrojtja e mjedisit ujqor prej ndikimeve negative të ujërave të zeza urbane.

VA e kanë për obligim të:

- grumbullojnë ujërat e zeza në vendbanime urbane me së paku 2 000 ekuivalent banor (Neni 3)
- sigurojnë trajtimin e ujërave të zeza për të gjitha aglomeratet dhe atë:
 1. Aplikim të trajtimit sekondar të ujërave të zeza të grumbulluara (Neni 4 dhe Aneks IB Tabela 1);
 2. Aplikim të trajtimit më të rreptë për aglomeratet me ekuivalent prej mbi 10.000 banorëve në rajonet sensitive dhe zonat e pellgjeve të tyre (Neni 5 dhe Aneksi IB Tabela 2) dhe
 3. Sigurim të trajtimit adekuat të emitimeve nga sistemet (ekzistuese) për grumbullim prej aglomerateve me ekuivalent prej më pak se 2.000 banorë në ujëra të ëmbla (Neni 7).
- garantojnë se pikat e trajtimit mirëmbahen në mënyrë adekuate, për shkak të funksionimit të tyre të drejtë dhe se mund të punojnë në të gjitha kushtet normale kohore (Neni 10);
- kërkojnë leje për shkarkime nga industria në sistemet për grumbullimin e ujërave të zeza urbane dhe pikat e trajtimit të ujërave të zeza urbane (Neni 11);
- kërkojnë leje për shkarkim nga pikat e trajtimit të ujërave të zeza urbane (Neni 12);
- kërkojnë licenca për shkarkim të ujërave të zeza për ekuivalent prej më tepër se 4.000 banorë prej industrive të posaçme në recipientët (Neni 13);
- ndërmarrin masa për kufizimin e ndotjes së recipientëve nga kullimi e ujërave atmosferike;
- kërkojnë licenca për mënjanimin e llumit nga pikat e trajtimit për ujërat e zeza urbane (Neni 14);
- stimulojnë shfrytëzimin e sërishëm të llumit që rezulton me trajtimin e ujërave të zeza urbane (Neni 14)
- bëjnë monitorim të punës së pikave të trajtimit dhe të recipientëve të ujërave (Neni 15);
- bëjnë monitorim në mënjanimin e llumit dhe shfrytëzimin e sërishëm (Neni 15) dhe
- janë të obliguar të sigurohen që në çdo dy vite organet kompetente do të publikojnë raporte për gjendjen me ujërat e zeza urbane dhe llumin në zonat e tyre. Këto raporte do të dërgohen në Komisionin menjëherë pasi të publikohen.

1.6. Direktiva për vlerësim dhe menaxhim me rrezikun ngaj vërshimet

Qëllimi i Direktivës 2007/60/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për vlerësim dhe menaxhim me rrezikun prej vërshimeve është vendosja e kornizës për vlerësim dhe menaxhim me rrezikun prej vërshimeve me qëllim të reduktimit të pasojave të dëmshme nga vërshimet mbi shëndetin e njerëzve, mjedisin jetësor, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetet ekonomike.

Për të zbatuar Direktivën, VA mund të caktojë organ kompetent për ndërmarrjen e obligimeve nga Direktiva si dhe të identifikojnë zona konkrete të bregut ose pellgje të caktuara lumore dhe të njëjtat t'ua ndajë për menaxhim njëjësive tjera të menaxhimit, kurse jo atyre që janë kompetent për menaxhim me pellgjet lumore nga DKU-ja. VA kanë për obligim:

- për çdo pellg lumor ose njësi menaxhimi ose pjesë të pellgut ndërkombëtar lumor që gjendet në territorin e tyre të bëjnë vlerësim preliminar të rrezikut prej vërshimeve që të mund të bëhet vlerësimi i rrezikut të mundshëm prej vërshimeve;
- të përpilojnë harta për rrezik prej vërshimeve dhe harta për rrishtin prej vërshimeve;

- të përgatisin plane për menaxhim me rreziqet prej vërshimeve në të cilat duhet të shënohen të gjitha aspektet e menaxhimit me rreziqet prej vërshimeve me theks të veçantë në parandalimin, mbrojtjen e gatishmërinë duke përfshirë parashikime të vërshimeve dhe paralajmërim të hershëm. Direktiva gjatë përgatitjes së planeve për menaxhim me vërshime udhëzon në DKU përkatësisht sugjeron që përgatitja e planit të parë mund të bëhet në koordinim me PMPL ose të integrohet në PMPL.
- inkuadrim i të gjitha palëve të interesuara në pajtim me dispozitat e DKU-së.
- të vihen në dispozicion të publikut të gjitha vlerësimet bazë për rreziqet prej vërshimeve, hartat për rrezik prej vërshimeve, hartat për rrisht prej vërshimeve dhe planet për rrezik prej vërshimeve dhe VA t'i inkurajojnë palët e interesuara për pjesëmarrje aktive në përgatitjen, ndryshimin dhe azhurnimin e planeve për menaxhim me rrezikun prej vërshimeve.

1.7. Direktiva për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja

Ujërat nëntokësore si resurse natyrore janë të rëndësishme për ekosistemet që varen nga ujërat nëntokësore si dhe për furnizimin me ujë të pijshëm. Ujërat nëntokësor në trupat uhor që përdoren për absorbimin e ujit të pijshëm ose të dedikuara për atë qëllim në të ardhmen duhet të jenë të mbrojtur në mënyrë që do të parandalojnë përkeqësimin e cilësisë së atyre trupave uhor me qëllim të reduktohet trajtimi i tyre në të ardhmen. Për t'u mbrojtur mjedisi jetësor si tërësi, e në veçanti shëndeti i njerëzve, koncentracionet e dëmshme të materieve ndotëse në ujërat nëntokësor duhet të shmangen, të parandalohen dhe të zvogëlohen.

Direktiva e Këshillit 2006/118/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe cenimi i cilësisë cakton masa konkrete për parandalim dhe kontroll të ndotjes së ujërave nëntokësore, në pajtim me përcaktimet në DKU-së. Masat përfshijnë në veçanti kritere për vlerësim të statusit kimik të ujërave nëntokësore dhe kritere për identifikim dhe ridrejtim të tendencave të rëndësishme dhe intensive e që janë në rritje të dipër dhe për përcaktim të pikënisjeve për ridrejtim të tendencave.

Me këtë Direktivë plotësohen dispozitat me të cilat parandalohen ose kufizohen përmbajtjet e hyrëse të materieve ndotëse në ujërat nëntokësor, e të cilat gjithashtu janë të rregulluara në DKU dhe e kanë për qëllim të parandalohet përkeqësimi i statusit të të gjithë trupave të ujërave nëntokësor.

1.8. Direktiva për ndotje të shkaktuar prej substancave të caktuara të rrezikshme që shkarkohen në mjedisin uhor

Direktiva 2006/11 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit nga 15 shkurt 2006 për ndotjen e shkaktuar prej substancave të caktuara të rrezikshme që shkarkohen në mjedisin uhor janë në lidhje me obligimin e VA të ndërmarrin aktivitete për eliminim të substancave të rrezikshme të përmendura në Direktivë⁷ si dhe të reduktohet ndotja e ujërave me substanca të rrezikshme⁸ në pajtim me dispozitat e Direktivës. Për të gjitha shkarkimet në ujërat që mund të përmbajnë substanca nga Shtojca 1 të Direktivës duhet të merret leje paraprake nga organi kompetent i VA. Leja duhet të përmbajë standarde emitimi për shkarkim të cilësdo nga ato substanca në ujërat si dhe shkarkim në rrjetin e kanalizimit. Lejet lëshohen në periudhë të kufizuar.

Gjithashtu për zvogëlimin e ndotjes së ujërave që përmbajnë substanca të rrezikshme nga Shtojca 2 organet kompetente janë të obliguara të shkarkojnë leje me të cilën rregullohet zvogëlimi i ndotjes në të cilën do të përkufizohen standardet e përckatuara të emitimit.

1.9. Rregullore tjera të BE-së nga sfera e mjedisit jetësor të rëndësishme për menaxhim me ujërat

Krahas akteve juridike me të cilat drejtpërdrejtë rregullohen çështjet për ujërat duhet të përmendet se sfera e ujërave ndërlihet edhe me fushat tjera nga sfera e mjedisit jetësor.

Veçanërisht janë të rëndësishme aktet juridike të legjisllacionit horizontal me të cilat rregullohen çështje të përgjithshme nga fusha e mjedisit jetësor të cilat vlejnë për të gjitha sferat e mjedisit jetësor. Veçanërisht vlen të përmenden aktet juridike në vijim:

7 Në Shtojcën 1 të Direktivës

8 Në Shtojcën 2 të Direktivës


- Direktiva 2011/92/EU për vlerësim të ndikimit të projekteve të caktuara publike dhe private mbi mjedisin jetësor të plotësuar me Direktivën 2014/52/BE me të cilat është rregulluar procedura për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor nga implementimi i projekteve me çka rregullohet procedura për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin jetësor që në fazën e projektit. Gjatë zbatimit të kësaj procedure, pjesëmarrja e publikut është obligative, ndërkaq një prej çështjeve që shqyrtohen është gjithsesi ndikimi i projektit mbi ujërat.
- Direktiva 2003/4/BE për qasje të informata nga fusha e mjedisit jetësor, me të cilën rregullohet qasja tek informata, nga fusha e mjedisit jetësor, të cilat i posedojnë organet publike ose personat juridik e të cilët i posedojnë informata për ata. Aspekti i ujërave është i rëndësishëm për shkak se ekziston numër i madh informatash të cilat organet publike në pajtim me dispozitat për ujëra janë të obliguar t'i grumbullojnë e që kanë të bëjnë me shkarkimin e lejeve, me çka të gjitha këto të dhëna nga sfera e ujërave duhet të jenë në dispozicion në pajtim me kërkesat e Direktivës.
- Direktiva 2001/42/EC për vlerësim strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor prej planeve dhe programeve me të cilat u imponon obligim organeve publike ta identifikojnë dhe vlerësojnë ndikimin e konsiderueshëm të cilat dokumentet e planit do ta kenë mbi mjedisin jetësor. Ndikimi duhet të vlerësohet qysh në procedurën e përgatitjes së dokumentit të planit para miratimit të tij, me qëllim të shqyrtohet ndikimi të cilin dokumenti i planit do ta ketë mbi mjedisin jetësor. Gjatë zbatimit të kësaj procedure detyrimisht vlerësohet edhe ndikimi nga aspekti i ujërave.
- Direktiva për informim 91/692/CEE dhe pyetësorë për ujëra (92/446/CEE dhe 95/337/CEE) me të cilat rregullohet dërgimi i informatave për ujëra nga VA në BE.

Dispozitat nga fusha e mbeurinave gjithashtu kanë të bëjnë me mbrojtjen e ujërave veçanërisht Direktiva për mbeturina 2008/98/UE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit prej 19 nëntor 2008 ku gjatë veprimit me dhe themelimin e infrastrukturës për mbeturinat duhet të merret parasysh edhe ndikimi mbi ujërat.

Dispozitat për ndotjen industriale dhe menaxhimi me rrezik është sferë e rëndësishme për menaxhimin me ujërat dhe atë:

- Direktiva për emitime industriale 2010/75/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit është instrumenti kryesor i BE-së për rregullimin e emitimeve nga impiantet industriale. Kjo Direktivë integron shtatë direktiva paraprakisht ekzistuese. Qëllimi i Direktivës është të arrihet nivel i lartë i mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe mjedisit jetësor, që janë marrë si tërësi, me reduktimin e emitimeve të dëmshme industriale në BE, veçanërisht nëpërmjet aplikimit të teknologjive më të mira në dispozicion (VAT). Instalacionet që e kanë për obligim të marrin leje, në pajtim me standardet e lejes, janë paraqitur në Shtojcën 1 të Direktivës. Leja përmban kushte të caktuara në pajtim me parimet dhe dispozitat e Direktivës dhe ajo bazohet në disa shtylla dhe atë: 1. qasja e integruar, 2. aplikimi i teknikave më të mira në dispozicion, 3. fleksibiliteti, 4. inspeksione dhe 5. pjesëmarrja e publikut. Qasja e integruar donë të thotë se lejet duhet t'i përfshijnë të gjitha mediat dhe sferat e mjedisit jetësor, përkatësisht të mbahet llogari për menaxhimin e integruar me mjedisin jetësor dhe atë për: emitimet në ajër, ujë dhe tokë, krijimin e mbeurinave, përdorimin e lëndëve të para, efikasitetin energjetik, zhurmën, parandalimin e aksidenteve dhe rehabilitimin e lokacionit gjatë mbylljes. Kushtet e përkufizuara në leje, duke përfshirë edhe vlerat e limiteve për emitim, duhet përcaktohen në pajtim me teknikat më të mira në dispozicion (VAT). Komisioni miraton konkluzione për NDT të cilat duhet të jenë referencë për caktimin e kushteve në leje.

Seveso-III (Direktiva 2012/18 / BE), BE e miratoi në vitin 2012 duke i marrë parasysh, ndër tjerash, ndryshimet në legjislacionin e Bashkimit Evropian për klasifikimin e kimikateve dhe të drejtat e shtuara të qytetarëve për qasje në informata dhe drejtësinë. Në pajtim me dispozitat e kësaj Direktive, katastrofat e mëdha të cilat përfshijnë përdorim të kimikateve të rrezikshme paraqesin kërcënim të madh për njerëzit dhe mjedisin jetësor në tërësi. Fatkeqësitë e këtilla shkaktojnë humbje të mëdha ekonomike dhe ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm. Përdorimi i sasive të mëdha të kimikateve të rrezikshme në disa sektorë industrial, që janë me rëndësi vitale për shoqëri moderne të industrializuar, është i pashmangshëm. Me miratimin e Direktivës ofrohen masa për parandalimin e fatkeqësive më të mëdha dhe sigurohet gatishmëri e mjaftueshme dhe reagim nëse vjen deri në fatkeqësi të tilla.



Në lidhje me natyrën duhet të përmenden Habitat Direktiva 92/43/CEE dhe Direktiva për shpezët 79/409/CEE me të cilat rregullohet mbrojtja e vendbanimeve të mbrojtura dhe speciet e shpezëve. Cilësia e ujërave është faktor posaçërisht i rëndësishëm për mbijetesën e këtyre mjediseve dhe specieve. Këto mjedise duhet të identifikohen në PMPL dhe në pajtim me atë të parashihen masa në programin e masave.

Domosdo duhet të përmendet edhe Konventa e Arhus-it e cila është po aq relevante për mjedisin jetësor, duke përfshirë përgjithësisht edhe menaxhimin me ujërat për shkak se çështjet për qasje të informatat, pjesëmarrjen e publikut në sjelljen e vendimeve dhe qasjen në drejtën janë në lidhje edhe me ujërat e në veçanti në pjesën e lëshiimit të lejeve dhe përgatitjes së dokumenteve të planit si dhe çështjet tjera.

Regjistri evropian për çlirim dhe transfer të ndotësve (E-PRTR) është regjistër në Evropë, që siguron të dhëna thelbësore për mjedisin jetësor me qasje të lehtë nga kapacitetet industriale në vendet-anëtare të Bashkimit Evropian. Regjistri kontribuon për transparencë dhe pjesëmarrje të publikut në sjelljen e vendimeve lidhur me mjedisin jetësor. I njëjti është themeluar në pajtim me PRTR protokollin ndaj Konventës Arhus-it për qasje në informata, pjesëmarrje të publikut në miratimin e vendimeve dhe qasje në drejtësi për çështje të mjedisit jetësor. Ai është themeluar në pajtim me protokollin PRTR

Konventa e Aarhus-it është për qasje deri te informatat. Pjesëmarrje të publikut në marrjen e vendimeve dhe qasja në drejtësi për çështje të mjedisit jetësor.

Ndryshimet klimatike kanë ndikim të madh dhe në masë të madhe ndërlidhen me menaxhimin me ujërat për shkak se ndikojnë mbi cilësinë dhe dispozicionin e resurseve ujore që sipas të gjitha parashikimeve edhe në të ardhmen do të rritet për shkak të ngrohjes globale dhe për shkak të mungesës së ujit.

Për t'u zmadhuar dispozicioni i ujit, duhet të zmadhohet edhe nevoja për sistem efikas për shpërndarje të ujit.

1.10. Shkalla e transponimit të legjislacionit të BE-së për ujëra në legjislacionin nacional për ujërat

Duke u nisur nga përcaktimi strategjik i Republikës së Maqedonisë për anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian, vendi viteve të kaluara vazhdimisht punon në harmonizimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e BE-së.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes për stabilizim dhe asocim nga ana e VA dhe hyrjen e saj në fuqi më 1 prill të vitit 2004 dhe marrjen e statusit të kandidatit për anëtarësim në Bashkimin e Evropian në vitin 2005, Komisioni Evropian vazhdimisht e përcjell përparimin e Republikës së Maqedonisë si vend kandidat për anëtarësim në BE.

Në raportin e fundit të Komisionit Evropian për vitin 2016, për progresin e Republikës së Maqedonisë, në pjesën e ujërave është shënuar me sa vijon:

“Sa për cilësinë e ujit, vendi ka arritur nivel të caktuar të përgatitjes. Janë përgatitur plane për pellgjet lumore, janë identifikuar aglomerate dhe janë përkufizuar zonat e ndjeshme. Në janar 2016 është miratuar Ligji i ri për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve për ujë. Ujëra të zeza urbane të patrajuara ngelin të jenë burimi kryesor i ndotjes. Në rrjedhë është përgatitja e planeve konkrete për zbatimin e Direktivave për trajtimin e ujërave të zeza urbane dhe ujit të pijshëm. Është duke u ndërtuar infrastruktura e re, ndërsa infrastruktura ekzistuese po mbindërtohet, megjithëse financimi nacional nuk mjafton. Kapacitetet administrative nuk janë të mjaftueshme për të zbatuar të gjitha masat që kërkohen në direktivat të cilat kanë të bëjnë me ujin. Duhet të zhvillohen plane për mbrojtje nga rreziqet prej vërshimeve dhe risqet kërcënuese për të gjitha pellgjet lumore.”

KE e përcjell procesin e transponimit dhe zbatimit të legjislacionit të BE-së për mjedisin jetësor dhe klimën përmes përgatitjes së raportit për shkallën e transponimit dhe implementimit të legjislacionit të BE-së nga fusha e mjedisit jetësor në legjislacionin nacional.

Në Raportin e fundit për monitorimin e përparimit të transponimit dhe zbatimit të legjislacionit për mjedis jetësor dhe klimë, nga viti 2016 në lidhje me transponimin është konstatuar se Direktiva për ujëra të zeza urbane është transponuar tërësisht në legjislacionin nacional, derisa për transponimin e DKU-së nevojitet të ndërmerren veprime të mëtutjeshme për miratim të akteve tjera nënligjore të cilat rezultojnë nga LU. Sa i

përket Direktivës për ujin e pijshëm në legjislacionin nacional duhet të transponohen ndryshimet e Direktivës 2015/1878.

Transponimi i Direktivës për ujin për larje, Direktivës për ujëra nëntokësor dhe Direktivës për vërshime duhet të vazhdojë në vitet në vijim me miratimin e akteve nënligjore që rezultojnë nga LU si dhe ndryshime përkatëse në LU për shkak të harmonizimit plotësues të tij me rregulloret e përmendura për ujëra.

Më poshtë në tabelën është dhënë paraqitje e shkallës së transponimit të rregollres nacionale me rregulloren e BE-së për ujëra.

Pasqyrë e shkallës së transponimit të legjislacionit për ujëra në legjislacionin nacional⁹

Titulli i aktit të BE-së	10%	20%	30%	40%	50%	60%	70%	80%	90%	100%
CILËSIA E UJËRAVE										
2000/60 /KE Direktiva Kornizë për ujëra									88%	
91/271/KEE Direktiva për trajtimin e ujërave të zeza urbane										100%
98/83/KE Direktiva për cilësi të ujit të pijshëm										97%
2006/7/KE Direktiva për cilësi të ujit për larje		11%								
2006/118/KE Direktiva për mbrojtjen e ujërave nëntokësore prej ndotjes dhe cenimi i cilësisë					48%					
2007/60/KE Direktiva për vlerësim dhe menaxhim me rrezikun prej vërshimeve		16%								

⁹ Tabela është marrë nga Raporti për progres monitorimin e transponimit dhe zbatimit të legjislacionit për mjedisin jetësor dhe klimë, viti 2016

Projekti “Qytetarët – partner aktiv në reformat e politikave për ujë”

“Analizë e gjendjes së menaxhimit me ujërat në Republikën e Maqedonisë dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve”

2 MENAXHIMI ME UJËRAT NË LEGJISLACIONIN NACIONAL

2.1. Statusi i ujërave në Republikën e Maqedonisë

Statusi dhe mirëqenia e mjedisit jetësor dhe habitateve në të janë të garantuara edhe në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, duke u nisur nga parimi se çdo njeri ka të drejtë për mjedis të shëndosh jetësor dhe është i obliguar ta avancojë dhe mbrojë mjedisin jetësor dhe natyrën. Republika siguron kushte për realizimin e të drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndosh jetësor.

Rregullimi dhe humanizimi i hapësirës si dhe mbrojtja e avancimi i mjedisit jetësor dhe natyrës është vlerë themelore e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë¹⁰.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë i përcakton të gjitha pasuritë natyrore të Republikës së Maqedonisë, botën bimore dhe shtazore, të mirat në përdorim të përgjithshëm, si dhe sendet dhe objektet me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike të caktuara me ligj janë të mira të interesit të përgjithshëm për Republikën dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë. Me ligj rregullohen mënyra dhe kushtet me të cilat, të mira të caktuara të interesit të përgjithshëm për Republikën e mund të jepen në përdorim. Ujërat si resurs i interesit të përgjithshëm janë në pronësi të Republikës së Maqedonisë. Ujërat nuk janë subjekt i të drejtës së pronësisë së personave fizik dhe juridik, pavarësisht regjimit juridik që e ka toka në të cilën gjenden.

Ujërat i përfshijnë të gjitha ujërat sipërfaqësore (të gjitha ujërat që rrjedhin ose nuk rrjedhin në sipërfaqen e tokës), duke përfshirë rrjedhat ujore ekzistuese ose ato në të cilat përkohësisht rrjedh ujë, liqenet, akumulimet, burimet dhe ujërat nëntokësore (ujërat që gjenden nën sipërfaqen e tokës në zonën e saturimit dhe janë në kontakt të drejtpërdrejtë me sipërfaqen ose me nënshtresat).¹¹

Sfera e ujërave në Republikën e Maqedonisë është e rregulluar me më tepër dispozita dhe atë:

- Ligji për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 129/15, 192/1 dhe 39/16);
- Ligji për ujërat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13, 180/14, 146/15, 52/16);
- Ligji për furnizim me ujë të pijshëm dhe shkarkimin e ujërave të zeza urbane ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 68/04, 28/06, 103/08, 17/11, 54/11, 163/13);
- Ligji për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve ujore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/16);
- Ligji për ekonomi ujore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/15, 93/15) dhe
- Ligji për siguri të ushqimit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 157/10, 53/11, 1/12, 164/13, 187/13, 43/14, 72/15, 84/15, 129/15, 213/15 dhe 39/16).

2.2. Dispozita me të cilat rregullohet menaxhimi me ujërat në Republikën e Maqedonisë

Menaxhimi me ujërat është rregulluar në më tepër dispozita. Në këto dispozita është rregulluar aspekt tjetër i veprimit me ujërat. Më poshtë në raport janë analizuar dispozitat nacionale me të cilat rregullohet menaxhimi me ujërat dhe atë: Ligji për mjedisin jetësor, Ligji për ujërat, Ligji për furnizim me ujë të pijshëm dhe shkarkim të ujërave të zeza urbane, Ligji për ekonominë ujore, Ligji për siguri të ushqimit dhe Ligji për përcaktimin e tarifave për shërbime ujore.

Ligj themelore i cili e rregullon menaxhimin me ujërat është Ligji për ujërat (LU). LU është miratuar në vitin 2008 dhe i njëjti ka filluar të zbatohen në vitin 2010.

2.3. Ligji për mjedisin jetësor

LMJ është ligj kornizë që rregullon çështje të përgjithshme të rëndësishme për të gjitha fushat e mjedisit jetësor. Ligji i rregullon të ashtuquajturat çështje horizontale, të cilat janë po aq të rëndësishme dhe të zbatueshme në të gjitha sferat tjera të mjedisit jetësor si dhe në sferën e ujërave. Ligji i rregullon çështjet në vijim: qasje të informatat nga sfera e mjedisit jetësor, procedura për vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin

¹⁰ Neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë

¹¹ Neni 4 nga Ligji për ujërat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16)

jetësor nga zbatimi i projekteve të caktuara publike dhe private, vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor nga përgatitja e planeve dhe programeve, çështjet për dëme mbi mjedisin jetësor dhe procedura për lëshimin e licencave të integruara ekologjike .

Në kapitullin 8 të Ligjit për mjedisin jetësor përgjithësisht është rregulluar çështja për qasje tek informatat nga sfera e mjedisit jetësor në të cilin janë përkufizuar obligimet, kushtet dhe mënyra e dhënies së informatave që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor.

Ligjit në përgjithësi e rregullon edhe monitorimin e habitateve dhe zonave të mjedisit jetësor në një kapitull të veçantë - V. Monitorim i mjedisit jetësor. Për të zbatuar monitorimin e habitateve dhe zonave të mjedisit jetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë themelohet rrjet shtetëror për monitorim të mjedisit jetësor që do të përbëhet prej rrjeteve shtetërore për monitorim të habitateve dhe zonave të veçuara në mjedisin jetësor, të cilin e formon Qeveria e Republikës së Maqedonisë (QRM). Për monitorim të habitateve dhe zonave të veçanta të mjedisit jetësor, njësitë e vetëqeverisjes lokale në pajtim me ligjet e veçanta, mund të formojnë rrjete lokale për monitorim.

Në Kapitullin VI Sistemi nacional informativ për mjedisin jetësor është rregulluar për menaxhim me të dhënat për gjendjen e mjedisit jetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë, MMJPH vendos, zhvillon, mban dhe koordinon Sistem nacional informativ për mjedisin jetësor. Sistemi informativ vendoset, zhvillohet, mbahet dhe koordinohet në mënyrë që siguron bazë të të dhënave relevante – gjithëpërfshirëse, të sakta dhe që janë në dispozicion për publikun dhe informata për gjendjen, cilësinë dhe tendencat e të gjitha habitateve dhe zonave në mjedisin jetësor. Sistemi informativ përfshin grumbullimin, përpunimin, sistematizimin, ruajtjen, shfrytëzimin, distribuimin dhe prezantimin e të dhënave dhe informatave të pranuar nga rrjeti shtetor për monitorim, rrjeti lokal për monitorim dhe monitorimi që e bën vet, në habitatet dhe zonat e caktuara të mjedisit jetësor, si dhe të dhënat nga Regjistri për shkarkim dhe transferim të ndotësve, Kadastri për mjedis jetësor dhe Lista nacionale e indikatorëve.

Regjistrin për shkarkim dhe transferim të ndotësve e themelon dhe mban MMJPH. Personat juridik dhe fizik janë të obliguar të parashirojnë të dhëna për përpilimin dhe mbajtjen e Regjistrit të ndotësve.

Kadastri i ndotësve të ujërave është i inkorporuar në Kadastrin për mjedis jetësor të cilin e mban dhe themelon MMJPH.

Kadastri përmban të dhëna për aktivitetet dhe për instalacionet të cilat e rrezikojnë ose mund ta rrezikojnë mjedisin jetësor. Personat juridik dhe fizik janë të obliguar të parashirojnë të dhëna për krijimin dhe mirëmbajtjen e kadastrave përkatës.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale për rajonet e tyre, mund të themelojnë dhe mbajnë Regjistër dhe Kadastër për mjedisin jetësor.

Themelimi i monitorimit të habitateve dhe zonave të caktuara, themelim i sistemit informativ për habitat ose zonë të caktuar është i rregulluar me ligjet e veçanta (mbeturinat, natyra etj). Konkretisht, monitorimi i ujërave dhe sistemit informativ për ujërat është rregulluar më detajisht në Ligjin për ujërat.

Pjesëmarrja e publikut në miratimin e vendimeve nga sfera e mjedisit jetësor është rregulluar në LMJ. Në procedurat për zbatimin e vlerësimit strategjik të planeve dhe vlerësimeve, procedura për vlerësimin e ndikimit prej projekteve të caktuara dhe procedura për menaxhim të integruar me mjedisin jetësor është rregulluar mënyra dhe procedura për pjesëmarrjen e publikut.

Pjesëmarrja e publikut në miratimin e vendimeve nga fusha e ujërave si dhe miratimi i dokumenteve të planit nga fusha e ujërave është rregulluar më detajisht edhe në LU.

Është e rëndësishme të thuhet se shfrytëzimi i resursit mund të bëhet nëpërmjet lejeve ekologjike të integruara me të cilat gjithashtu rregullohet çështja për punë të kapaciteteve të mëdha industriale që duhet të punojnë në pajtim me teknikat më të mira në dispozicion. Këto leje e rregullojnë çështjen e shfrytëzimit të ujërave si dhe shkarkimin e ujërave të zeza.

LMJ e rregullon edhe procedurën për vlerësim strategjik të ndikimit të dokumenteve të planit mbi mjedisin jetësor si dhe procedurën për vlerësimin e ndikimit të cilin projektet e kanë mbi mjedisin jetësor.



2.4. Ligji për ujërat

Dispozitë themelore ligjore me të cilën rregullohet menaxhimi me ujëra është Ligji për ujërat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13, 52/16) dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të LU. LU është ligj kornizë që i rregullon principet dhe parimet themelore për menaxhim me resurset ujore. Me këtë ligj vendoset një kornizë e përgjithshme juridike për rregullim të fushës së menaxhimit me ujërat në mënyrë të integruar dhe gjithëpërfshirëse. Gjatë kësaj menaxhimi me ujërat i përfshin të gjitha masat dhe aktivitetet për shfrytëzim racional dhe efikas të ujërave, zhvillim të qëndrueshëm të resurseve ujore, mbrojtje të ujërave dhe mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave, objektet dhe impiantet për ekonomi ujore, vendosja organizative dhe financimi i menaxhimit me ujërat, si dhe mënyra e shfrytëzimit ose shkarkimit të ujërave.

Nevoja për qasje të integruar gjatë përpilimit të Ligjit për ujërat, rezulton nga fakti se aspektet e mbrojtjes janë rrënjësisht të lidhura dhe të njëjtat nuk mund të rregullohen veçmas pa mbajtur llogari për lidhshmërinë e tyre të ndërsjellë. Prandaj, kjo materie fokusohet në tre fusha dhe atë: shfrytëzimi i ujërave, mbrojtja e ujërave dhe kontrolli i ndotjes dhe mbrojtja nga ndikimi i dëmshëm i ujërave.

Në LU dhe aktet nënligjore janë transponuar numër i madh i akteve juridike të BE-së me të cilat rregullohet menaxhimi me ujërat në nivel të BE-së dhe atë:

- Direktiva Kornizë për ujëra (DKU) 2000/60/BE;
- Direktiva 98/83/BE për cilësi të ujit të dedikuar për konsum nga njeriu;
- Direktiva 76/160/BEE që ka të bëjë me cilësinë e ujit për rekreacion;
- Direktiva 91/676/BE për mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar prej nitrateve në bujqësi;
- Direktiva 91/271/BEE që ka të bëjë me trajtimin e ujërave të zeza urbane;
- Direktiva 2006/118/KE për ujëra nëntokësore;
- Direktiva 2008/105/KE për standarde të cilësisë së mjedisit jetësor në sferën e ujërave;
- Direktiva 76/464/BE për shkarkimin e substancave të rrezikshme në mjedis ujor në bashkësi.

Qëllimet që duhet t'i arrijë LU janë:

- sigurim të qasjes në sasi të mjaftueshme të ujit cilësor, në pajtim me parimet për menaxhim të qëndrueshëm me ujërat e pijshëm dhe prodhim të ushqimit, për nevojat e bujqësisë, industrisë, nevojat hidroenergjetike, për nevojat e parqeve dhe sipërfaqet tjera publike, turizmi, lundrimi dhe për nevoja tjera;
- mbrojtje, ruajtje dhe përmirësim i vazhdueshëm i resurseve ujore që janë në dispozicion, përmirësim të gjendjes së truallit bregdetar, ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve që varen prej ujit, mbrojtje dhe avancim të mjedisit ujor nëpërmjet shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm të ujërave, si dhe reduktim të emitimeve të dëmshme dhe eliminim gradual të emitimit të materieve, substancave të rrezikshme në ujëra;
- zbutje të pasojave nga ndikimi i dëmshëm i ujërave dhe nga mungesa e ujërave dhe
- mbrojtje e avancim të mjedisit jetësor dhe natyrës, të eko sistemeve ujore dhe biodiversitetit dhe mbrojtje të shëndetit të njerëzve.

Parimet për menaxhim të qëndrueshëm me ujërat në të cilat bazohet LU janë: parimi për pjesëmarrje të publikut dhe qasje tek informatat, parimi për pjesëmarrje të palëve të interesuara dhe parimi i universalitetit të shërbimeve të ekonomisë ujore.

Menaxhimi me ujërat është përkufizuar si veprimtari e interesit publik dhe nënkupton ndërmarrje të të gjitha masave dhe aktivitetëve dhe arritje të qëllimeve të përkufizuara në LU, kurse gjatë kësaj të sigurohet shfrytëzim racional dhe efikas i ujërave, zhvillim i qëndrueshëm i resurseve ujore, mbrojtje e ujërave dhe mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave. Masat, standardet dhe qëllimet e mjedisit jetësor aplikohen si kërkesa minimale që duhet të plotësohen gjatë menaxhimit me ujërat.

2.4.1. Planifikim i zhvillimit dhe menaxhimi me ujërat

Menaxhimi me ujërat paraqet prioritet që pasqyrohet në më shumë dokumente strategjike të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor (MMJPH). Ujërat janë resurs i rëndësishëm që duhet të mbrohet mirë dhe të menaxhohet edhe më mirë.

Planifikimi i zhvillimit dhe menaxhimit me ujërat bëhet nëpërmjet miratimit të dokumenteve të planit me të cilat rregullohet menaxhimi me ujërat edhe atë:

1. Strategji nacionale për ujërat
2. Baza e ekonomisë ujore
3. Plane për menaxhim me pellg lumore (PMPL)

1. **Strategjia nacionale për ujërat (SNU)** është dokument plani 30 vjeçar të cilin e përpilon MMJPH në bashkëpunim me organet relevante, e të cilën e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. SNU e përkufizon politikën afatgjate për ujëra me të cilën sigurohet zhvillim i qëndrueshëm i ujërave nëpërmjet plotësimit të nevojave për të gjithë shfrytëzuesit me ujë cilësor në sasi të mjaftueshme, shfrytëzim racional dhe ekonomik i ujërave, mbrojtje e ujërave nga ndotja dhe kontroll i ndotjes, mbrojtje dhe përmirësim të tokës bregore dhe habitateve ujore dhe mbrojtje dhe zbutje të pasojave nga ndikimi i dëmshëm i ujërave dhe mungesa e ujit.

SNU e Republikës së Maqedonisë është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në vitin 2010 dhe e njëjta vlen për periudhën prej vitit 2011 - 2041.

2. Për realizim të SNU si dhe të planifikimit të integruar dhe implementim programeve e masave për zhvillim të ujërave në pajtim me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm nacional miratohet Baza për ekonomi ujore e Republikës së Maqedonisë. Baza për ekonomi ujore e Republikës së Maqedonisë është miratuar në vitin 1972.

Bazën për ekonomi ujore me propozim të QRM e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për periudhë prej 20 vitesh. Baza për ekonomi ujore e rregullon gjendjen ekzistuese të ujërave, nevojat aktuale dhe të ardhshme për ujë, bilansin e ujërave, zgjidhjet teknike dhe ekonomike për shfrytëzim racional të ujërave, mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave në pajtim me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm si dhe qëllimet afatgjate për mjedisin jetësor dhe programin e masave për realizimin e tyre.

Qeveria e RM duhet të mbajë llogari për harmonizimin e Bazës për ekonomi ujore me Planin hapësinor të Republikës së Maqedonisë, si dhe gjatë përpilimit të dokumenteve afatgjate të planit me të cilat rregullohet zhvillimi i degëve të ndara ekonomike dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore, detyrimisht të bëhet nëpërmjet harmonizimit të tyre me Bazën për ekonomi ujore.

Procedura për përpilimin, revidimin dhe azhurnimin e Bazës për ekonomi ujore është rregulluar me Rregulloren për metodologjinë për përmbajtjen, mënyrën dhe procedurën për përpilim, revidim dhe azhurnim të bazës për ekonomi ujore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 148/09). Baza për ekonomi ujore e Republikës së Maqedonisë revidohet, ndryshohet dhe/ose plotësohet së paku në çdo dhjetë vite, ndërsa sipas nevojës edhe më herët. Gjatë përgatitjes përkatësisht revidimit, ndryshimit dhe plotësimit detyrimisht duhet të sigurohet pjesëmarrje e publikut në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

Gjatë përgatitjes së Bazës për ekonomi ujore detyrimisht duhet të sigurohet mbajtje e debatit profesional si dhe të sigurohen kushte për publikun e ekspertëve që në mënyrë përkatëse të njoftohet me Draft-bazën për ekonomi ujore dhe t'i shpreh mendimet dhe qëndrimet që ka. Në bazë të mendimeve dhe qëndrimeve të pranuar nga debati profesional për Draft-bazën për ekonomi ujore përpilohet propozim i Bazës për ekonomi ujore, të cilin me propozim të MMJPH e përcakton QRM. QRM e parashtron propozimin e Bazës për ekonomi ujore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për miratim.

3. **Planet për menaxhim me pellgjet lumore (PMPL)** janë dokumente kryesore në të cilat bazohet menaxhimi i integruar me ujërat. Në pajtim me kërkesa e DKU-së, menaxhimi me ujërat vlerësohet dhe menaxhohet në

nivel të pellgjeve lumore, e jo në bazë të kufijve gjeografik dhe politik. Për çdo zonë të pellgut lumor, QRM miraton PMPL. Territorin e

Republikës së Maqedonisë e përbëjnë katër zona të pellgjeve lumore dhe atë zonat e pellgjeve lumore të lumenjve Vardar, Drini i Zi, Strumica dhe Morava Jugore (Foto 1). Kufijtë e zonave të pellgjeve lumore janë përkufizuar me Vendim për përcaktimin e kufijve të zonave të pellgjeve lumore të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 107/12).

Pellgu i Vardarit e përfshin pellgun e lumit Vardar me degët e veta në territorin e Republikës së Maqedonisë deri në kufirin maqedono-grek, duke e përfshirë edhe pellgun e Liqenit të Dojranit në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe përfshin 80% të ujërave në shtet.

Pellgu i Drinit të Zi i përfshin pellgjet e Liqenit të Prespës dhe Ohrit dhe grykën e lumit Drin i Zi me degët e veta në territorin e Republikës së Maqedonisë, deri në kufirin shtetëror maqedono-shqiptar.

Pellgu i Strumicës i përfshin pellgjet e lumenjve Strumicë, Cironska dhe Lebnicë, deri në kufirin shtetëror maqedono-bullgar.

Pellgu i Moravës jugore e përfshin pellgun e Moravës jugore në territorin e Republikës së Maqedonisë, deri në kufirin shtetëror maqedono-serb





Foto 1 Ilustrim me foto të pellgjeve lumore në Maqedoni

Periudha kohore për të cilën miratohen PMPL është gjashtë vite. Përgatitja e PMPL është rregulluar me Rregulloren për përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së PMPL (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 148/09).

Për çdo zonë të pellgut lumor së paku në çdo gjashtë vite MMJPH bën analizë të karakteristikave të tij, ndikimet dhe efektet e konsiderueshme të aktiviteteve të njeriut mbi ujërat dhe analizë ekonomike të shfrytëzimit të



ujërave në pajtim me Rregulloren për metodologjinë për vlerësimin e pellgjeve lumore ("Gazeta zyrtare e RM"148/09).

Gjatë përgatitjes së PMPL, është e detyrueshme pjesëmarrja e Këshillit për menaxhim me zonën e pellgut lumor dhe e Këshillave për menaxhim me pjesë të zonave të pellgut lumor, realizimi i bashkëpunimit me organet tjera shtetërore, institucionet dhe entet shkencore dhe sigurim i pjesëmarrjes së publikut në procedurën e miratimit të planit që nënkupton sigurimin e pjesëmarrjes së tyre në faza të ndryshme të procedurës për përpilimin e Planit.

Për përpilimin dhe përcjelljen e zbatimit të Planit për menaxhim me pellg lumor, si dhe për dhënie të mendimeve dhe propozimeve rreth prioriteteve për menaxhimin me ujërat, QRM për çdo zonë të pellgut lumor, formon Këshill për menaxhim me zonën e pellgut lumor. Formimi i Këshillit për menaxhim me zonën e pellgut lumor është rregulluar dhe Urdhëresën për përbërjen, mënyrën e pjesëmarrjes si dhe mënyrën e nominimit të përfaqësuesve në këshillat për menaxhim me zonat e pellgjeve lumore dhe këshillin për menaxhim me pjesët e zonave të pellgut lumor, si dhe mënyrën e punës është miratuar nga Qeveria e RM ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 106/13). Në pajtim me Urdhëresën është paraparë formim i tre këshillave për menaxhim me zona të veçanta të pellgut lumor.

Këshilli për menaxhim me zonën e pellgut lumor të Lumit Vardar përbëhet prej 45 anëtarëve, Këshillit për menaxhim me zonën e pellgut lumor të lumit Drini i Zi përbëhet prej më së shumti 35 anëtarëve dhe Këshilli për menaxhim me zonën e pellgut lumor të Lumit Strumica përbëhet prej më së shumti 35 anëtarëve. Në lidhje me zonën e katërt të pellgut lumor të lumit Strumicë për shkak të madhësisë së zonës së pellgut lumor të Moravës jugore, menaxhimi me pellgun lumor të Moravës jugore do të bëhet nëpërmjet Këshillit për menaxhim me zonën e pellgut lumor të Lumit Vardar.

Në Këshill anëtarë janë përfaqësues të: organeve të administratës shtetërore (mjedisi jetësor, bujqësia, shëndetësia, transport dhe lidhje), njërive të vetëqeverisjes lokale, shoqatave të konsumatorëve, ekonomive ujore dhe përfaqësues të bashkësive ujore, ofruesve të shërbimeve për furnizim me ujë dhe shkarkim të ujërave dhe trajtim të ujërave të zeza dhe shfrytëzuesve tjerë të ujit, industrisë, organizatave joqeveritare, këshillit për menaxhim me pjesët e zonës së pellgut lumor dhe palëve tjera të prekura.

Numri i anëtarëve të Këshillit përcaktohet në varësi nga madhësia e zonës së pellgut lumor, si dhe nga vëllimi i aktiviteteve, në lidhje me ujërat, që zhvillohen në zonën e pellgut lumor. Për zonën e ndonjë pellgu lumor që shtrihet në sipërfaqe më të madhe ose aktivitetet e të cilit janë më të mëdha dhe/ose janë shpërndarë në mënyrë që të mund të grupohen, mund të formohet këshill për menaxhim me pjesë të zonës së pellgut lumor, mund të formohet këshill për menaxhim me zonë të pellgut lumor. Këshilli merr vendime me shumicë prej dy të tretës së votave.

Shpenzimet dhe kompensimi për punën e Këshillit dhe këshillit për menaxhim me pjesë të zonës së pellgut lumor paguhen nga buxheti i MMJPH. Anëtari i nominuar i cili merr pjesë në punën e Këshillit ka për obligim para mbajtjes së takimit të Këshillit të konsultohet me subjektet që e kanë propozuar dhe interesat e të cilëve i përfaqëson, prej tyre të kërkojë qëndrime dhe mendime në lidhje me temat për të cilat do të diskutohet në takimin e caktuar të Këshillit. Kur nuk është e mundur të merr mendime dhe qëndrime për çështje të caktuara që shqyrtohen në mbledhjen e Këshillit, anëtari duhet të veprojë në interesin më të mirë të subjekteve interesat e të cilëve i përfaqëson, si dhe qartë t'i parashtrijë problemet me të cilat ballafaqohen subjektet në lidhje me menaxhimin me ujërat. Kur çështje të caktuara janë me rëndësi të veçantë për subjektet interesat e të cilëve i përfaqëson, anëtari mund të kërkojë prolongim të mbledhjes së Këshillit për më së shumti shtatë ditë, afat në të cilin duhet të sigurojë mendime dhe qëndrime të subjekteve lidhur me çështjet. Mbledhjet e Këshillit janë publike, përveç në raste kur mirret vendim që mbledhja të jetë e mbyllur për publikun.

MMJPH është e obliguar që së paku në çdo tre vite ta njoftojë QRM për zbatimin e PMPL dhe së paku një herë në vit ta informojë QRM për zbatimin e Programit të masave.

Për dokumentet e planit për menaxhim me ujërat detyrimisht zbatohet procedurë për vlerësim strategjik të ndikimit mbi mjedisin jetësor nga dokumentet e planit për menaxhim me ujërat në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor..

2.4.2. Shfrytëzimi i ujërave

Shfrytëzim i përgjithshëm i ujërave donë të thotë shfrytëzim i ujërave për nevoja personale dhe nevoja të ekonomisë shtëpiake, kur për atë nuk nevojiten objekte të veçanta dhe impiante për shfrytëzimin e ujërave. Për shfrytëzim të përgjithshëm nuk nevojiten leje për shfrytëzimin e ujërave. Shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave përfshin shfrytëzimin e ujërave të pijshëm, larje dhe për nevoja tjera sanitare të ekonomisë shtëpiake, për sport dhe rekreacion dhe për lundrim me mjete lundrimi pa motor ose për plotësimin e nevojave tjera personale, nëse për këtë nuk kërkohet ndërtim i objekteve dhe impianteve të posaçme për të cilat parashihet leje për shfrytëzimin e ujërave. Shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave përfshin edhe shfrytëzimin e ujit për fikje të zjarreve dhe për ndërmarrjen e masave të domosdoshme sanitare dhe tjera në rast të gjendjes së jashtëzakonshme ose katastrofës elementare ose të aktiviteteve tjera me interes publik.

Aktivitete të shfrytëzimit të ujërave janë:

1. konsum nga njeriu, vaditje, për nevoja industriale, teknologjike, ekonomike dhe për dedikime tjera;
2. prodhim i energjisë elektrike dhe dedikime tjera për energji;
3. kultivim të peshkut;
4. lundrim;
5. sport, rekreacion, not dhe
6. akumulim, zgjerim, absorbim, shfrytëzim, ridedikim dhe për dedikime tjera.


Shfrytëzimi i ujërave i përfshin edhe aktivitetet e kullimit dhe shkarkimit, si dhe veprimet tjera mbi ujërat.

Secili e ka për obligim të shfrytëzojë ujin në vëllim, nën kushte dhe në pajtim me ligjin dhe në mënyrë racionale, ekonomike, të balancuar dhe të drejtë në pajtim me parimet për menaxhim të qëndrueshëm të ujit.

Prioritete të shfrytëzimit të ujërave janë:

1. furnizimi me ujë nëpërmjet sistemit publik të ujësjellësit i popullatës, i institucioneve shëndetësore dhe i personave juridik nga fusha e veterinarisë, për nevojat e mbrojtjes, për industrinë për prodhimtari dhe përpunimin e ushqimit dhe për ushqim të bagëtisë;
2. vaditja e tokës bujqësore;
3. furnizimi me ujë i industrisë dhe për nevojat ekonomike;
4. nevojat hidroenergjetike dhe për prodhimtari tjera;
5. nevojat e parqeve dhe sipërfaqeve tjera publike;
6. mbushjen e ujit në shishe për nevoja komerciale dhe
7. nevoja tjera.

Shfrytëzimi i ujërave është i rregulluar me legjislacionin për ujëra. Legjislacioni për ujëra ka leje për shfrytëzim të ujërave dhe leje për shkarkim të ujërave. Leja është e nevojshme për kryerje të aktiviteteve të cilat mund të ndikojnë në regjimin e ujërave. Lejet lëshohen në pajtim me PMPL. Lejen e lëshon MMJPH në bazë të kërkesës së parashtruar për periudhë jo më të gjatë se 10 vite varësisht nga lloji i objektit të ekonomisë ujore. MMJPH gjatë lëshimit të lejes, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor, është e obliguar t'i sigurojë publikut qasje në informatat e nevojshme për formimin e mendimeve dhe qëndrimeve. Publiku mund të shpreh mendimet dhe vërejtjet në lidhje me ndonjë kërkesë për marrje të lejes në afat prej 15 ditëve nga publikimi i kërkesës. Organet dhe publiku mund, në formë të shkruar, në afat prej 15 ditëve nga pranimi i kërkesës, t'i parashtrojnë mendimet dhe qëndrimet e tyre në lidhje me kërkesën. Gjatë përpilimit të lejes, MMJPH nuk do t'i merr parasysh mendimet e parashtruara pas skadimit të afatit. Gjatë përgatitjes së lejes MMJPH duhet t'i arsyetojë shkaqet për refuzimin e mendimeve dhe qëndrimeve nga publiku dhe organet. Nëse organet nuk e parashtrojnë mendimin me shkrim, llogaritet se nuk kanë vërejtje për kërkesën. MMJPH me aktvendim e refuzon kërkesën nëse konstaton se lëshimi i lejes nuk është në pajtim me PMPL, se rrezikohet interesi publik, ose që shkelen dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Maqedonisë. Legjislacioni për ujëra, që buron dhe realizohet në kushte dhe në mënyrë të caktuar në lejen, përkohësisht kufizohet, nëse me realizimin e të njëjtit cenohet shëndeti i njerëzve dhe kufizohet shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave.



Forma dhe përmbajtja e lejes për shfrytëzim të ujit janë rregulluar me Rregulloren për përmbajtjen dhe formën e formularit të kërkesës për shfrytëzim të ujit dhe dokumentacionin e nevojshëm që parashtrohet me kërkesën për lëshim të lejes për shfrytëzim të ujit (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 98/17) dhe Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e formularit të lejes për shfrytëzimin e ujit (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 37/17)..

2.4.3. Mbrojtja e ujërave

2.4.3.1. Qëllime të mjedisit jetësor

Me qëllim të menaxhimit me çdo trup ujqor për zonën e pellgut lumor përcaktohen qëllime të sferës së mjedisit jetësor për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, kontroll mbi shkarkimet dhe emitimet, qëllimet për cilësi të ujërave dhe klasifikim e kategorizim të ujërave. Për të arritur qëllimet e mjedisit jetësor të caktuar në PMPL, QRM për çdo zonë të pellgut lumor në territorin e RM miraton Program të masave. MMJPH e përpunon Programin e masave. Programi i masave është pjesë e PMPL. Përmbajtja e Programit të masave është përkufizuar me Rregulloren për përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes së Programit të masave (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 148/09). Programi i masave përmban masa themelore dhe shtesë dhe i njëjti azhurnohet në së paku gjashtë vite.

Për mirëmbajtje dhe përmirësim të cilësisë së ujërave QRM bën klasifikimin e ujërave. Në vitin 2016, QRM e ka miratuar Urdhëresën për klasifikimin e ujërave sipërfaqësore (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 99/16) aplikimi i saj është paraparë të fillojë me datë 01.01.2019, kurse deri atëherë në zbatim është Urdhëresa për kategorizimin e rrjedhave ujore, liqejve, akumulimet dhe ujërat nëntokësore (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 18/99) dhe Urdhëresa për klasifikimin e ujërave (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 18/99). Qëllimet e sferës së mjedisit jetësor për ujërat nëntokësore i cakton QRM me miratim të Urdhëresës për klasifikimin e ujërave nëntokësore. Kjo urdhëresë ende nuk është miratuar.¹² Nëse realizimi i qëllimeve të mjedisit jetësor për ndonjë trup të caktuar ujqor nuk është i mundur ose me kosto të papranueshme, për atë trup ujqor mund të parashtrihen qëllime pak më të rrepta të mjedisit jetësor. QRM i përcakton kushtet për shmangie prej qëllimeve të mjedisit jetësor. Ky akt nënligjor ende nuk është miratuar.¹³

2.4.3.2. Shkarkime në ujëra

Ndalohen veprimet me të cilat bëhet ndotje e ujërave. Shkarkimi në ujëra bëhet në bazë të lejes për shkarkim në ujëra. Kërkesa për shkarkim në ujëra dhe leja për shkarkim janë të përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës, si dhe dokumentacionin e nevojshëm që i bashkëngjitet kërkesës për leje për shkarkim (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 35/17).

Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e formularit të lejes për shkarkim në ujëra (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 35/17). MMJPH lëshon leje në pajtim me kriteret ekzistues për cilësi të ujit dhe qëllimet e mjedisit jetësor. Me atë leje përcaktohen vlerat e limiteve për emitim të substancave dhe sasitë e tyre dhe standardet për mjedisin jetësor duke përfshirë edhe emitimet dhe standardet e caktuara me dispozitat nga fusha që e rregullon lëshimin e lejes ekologjike të integruar, për shkak të arritjes së qëllimeve të mjedisit jetësor të trupit ujqor. Personat juridik dhe fizik, duke i përfshirë edhe organet e administratës shtetërore, komunat, komunat në qytetin e Shkupit mund të shkarkojnë ujëra të zeza ose të shkarkojnë ose hedhin materie dhe substanca në recipientët vetëm me leje që paraprakisht e kanë marrë për shkarkim në ujëra,¹ me kushte dhe në mënyrë të caktuar me ligj. Për të zbatuar PMPL, leja për shkarkim jepet në pajtim me PMPL.

2.4.3.3 Zona të mbrojtura

Në pajtim me Ligjin për ujërat, QRM përcakton zona të mbrojtura për:

- trupa ujqor të dedikuar për konsum nga njeriu (me propozim të MSH dhe MMJPH);
- trupa ujqor të dedikuar për qëllime rekreative, duke përfshirë edhe ujin për not (me propozim të MSH dhe MMJPH);

¹² Neni 92 i Ligjit për ujërat

¹³ Nen nga Ligji për ujërat

- zona sensitive ndaj nitrateve (me propozim të MMJPH, MBPEU dhe MSH);
- trupa uhor sensitiv ndaj shkarkimit të ujërave të zeza urbane (me propozim të MMJPH, MBPEU dhe MSH);
- zonat e caktuara si trashëgimi natyrore e mbrojtur ku mirëmbajtja dhe përmirësimi i gjendjes së ujërave është faktor i rëndësishëm, (MMJPH) dhe
- zonat e dedikuara për mbrojtjen e specieve bimore dhe shtazore që jetojnë ose varen nga uji, ndërsa kanë rëndësi ekonomike (MMJPH dhe MBPEU).

Komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe Qytetit i Shkupit mund t'i sugjerojnë MMJPH nevojën për përcaktim të zonës së mbrojtur. Vendimin për përcaktim të zonës së mbrojtur e miratojnë komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

Zonat e mbrojtura shënohen në vend konkret me ndihmë të shenjave paralajmëruese dhe tabela informative. Shënimin e zonave të mbrojtura e siguron MMJPH.

QRM, me propozim të MMJPH përcakton masa të nevojshme për mbrojtjen e zonave të mbrojtura duke siguruar realizimin e qëllimeve të mjedisit jetësor.

Zonat e mbrojtura dhe trupat uhor në kuadër të çdo pellgu lumor që kërkojnë mbrojtje të veçantë, regjistrohen dhe azhurnohen në vazhdimësi në regjistër të zonave të mbrojtura të cilin e mban MMJPH.

Të dhënat dhe pasqyra hartografike e zonave të mbrojtura dhe të dhënat nga regjistri i zonave të mbrojtura, janë pjesë përbërëse e PMPL.

QRM i cakton kushtet dhe mënyrën për themelimin e zonave të mbrojtura për pasqyrën hartografike të zonave të mbrojtura).


2.4.4 Ujë i dedikuar për konsum nga njeriu

Uji i dedikuar për konsum nga njeriu është rregulluar në LU, Ligjin për siguri të ushqimit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 157/10, 53/11, 1/12, 164/13, 187/13, 43/14, 72/15, 84/15, 129/15, 213/15 dhe 39/16), në Rregulloren për siguri të ujit të dedikuar për konsum nga njeriu ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 46/08), në Urdhëresën për klasifikim të ujërave ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 18/99), në Urdhëresën për kategorizim të ujërave ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 18/99), në Rregulloren për siguri të ujit të pijshëm, dhe ujit të burimit dhe ujit të ambalazhuar ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 46/08), në Rregulloren për llojin e përgatitjes profesionale, pajisjes dhe kushteve hapësinore që duhet t'i plotësojë edhe personi juridik profesional për përpilimin e elaboratit për përcaktim të kufijve të zonave të mbrojtura, masat mbrojtëse dhe kushtet tjera për ujërat e dedikuara për konsum nga njeriu ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 29/14).

Derisa Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e Regjistrit për zonat e mbrojtura për trupa uhor të dedikuara për konsum nga njeriu, zonat e mbrojtura për trupat uhor të përkufizuar si ujëra për rekreacion, duke i përfshirë edhe ujërat për not, trupat uhor sensitiv ndaj shkarkimit të ujërave të zeza urbane si zona të mbrojtura si dhe Rregullorja për mënyrën e përcaktimit dhe mirëmbajtjes së zonave më të ngushta dhe më të gjera të mbrojtura dhe mënyrën e përpunimit të tokës, ndërtimin dhe shfrytëzimin e objekteve dhe kryerjen e punëve tjera mund të ndikojnë në mënyrë negative mbi gjendjen cilësore dhe kuantitative të trupit uhor të dedikuara për konsum nga njeriu ende nuk janë miratuar.

Direktiva (BE) 2015/1787 me të cilën ndryshohet dhe plotësohet Direktiva 98/83/BE ende nuk është transponuar në legjislacionin nacional, përkatësisht Shtojcat II dhe III nga e njëjta dhe nevojitet të transponohet në mënyrë adekuate derisa Direktiva bazë 98/83/UE është transponuar në përqindje të madhe.

Në LU "ujë i dedikuar për konsum nga njeriu" është çdo ujë, në gjendjen e vet origjinale ose pas trajtimit, i dedikuara për pije, gatim, përgatitje të ushqimit ose për nevoja tjera shtëpiake, pa marrë parasysh prej nga buron dhe nëse furnizohen nga rrjeti i ujësjellësit, prej tankut, prej shisheve ose në enë si dhe ujë që shfrytëzohet për prodhim të ushqimit, ripërpunim, konservim ose për shitje të produkteve ose materieve dhe substancave për konsum nga njeriu, përveç nëse konstatohet se cilësia e ujit nuk mund të ndikojë mbi sigurinë e produktit të gatshëm ushqimor.



Në pajtim me LU në kuadër të çdo pellgu lumor nevojitet të përcaktohen trupat ujorë prej të cilëve përfshihen ose mund të përfshihen më shumë se 10m³ ujë në ditë të dedikuar për konsum nga njeriu, ose të bëhet furnizim me ujë për më shumë se 20 njerëz. Ministri nga sfera e mjedisit jetësor në marrëveshje me ministrin e shëndetësisë i caktojnë trupat ujorë dhe i parashtrajnë në QRM për të përcaktuar zonat e mbrojtura. Me qëllim të mbrojtjes së trupit ujor që shfrytëzohet për furnizim me ujë të dedikuar për konsum nga njeriu nevojitet të vendoset dhe mbahet zonë më e ngushtë ose zonë e rreptë sanitare dhe një ose më shumë zona të mbrojtura më të gjera.

Uji i dedikuar për konsum nga njeriu, duhet gjithmonë të jetë i sigurtë dhe i pastër dhe:

- të mos përmbaj mikro-organizma ose parazita e materie dhe substanca të cilat në numër të caktuar ose në koncentracione të caktuara mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve; dhe
- t'i plotësojë vlerat dhe standardet minimale si dhe parametrat për cilësi të ujit (parametrat mikrobiologjike, fizike, kimike dhe parametrat radiologjike) dhe
- indikatorë biologjike (fito dhe zooplankton) për furnizim me ujë prej ujërave sipërfaqësore dhe prej ujërave nëntokësore si dhe nga puse të caktuara.

Ndalohet çdo furnizim me ujë të dedikuar për konsum nga njeriu që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ose që mund të paraqet rrezik për shëndetin e njerëzve. MSH i cakton vlerat minimale, standardet dhe parametrat për cilësi të ujit si dhe masat të cilat janë të domosdoshme për realizimin e qëllimit për cilësi.

MSH, AUV dhe ISHP bashkë me QSHP janë përgjegjës për informim të publikut për cilësinë e ujit të pijshëm. NPEU, gjithashtu kanë përgjegjësi të informojnë publikun dhe kryetarin e komunës.

2.4.5 Ligji për siguri të ushqimit

Ligji për siguri të ushqimit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 157/10, 53/11,1/12, 64/13, 187/13, 43/14, 72/15 dhe 84/15) ujin e përfshin në nocionin "ushqim" dhe atë: a) uji i pijshëm prej sistemeve për furnizim publik me ujë të pijshëm dhe ujë që përdoret dhe/ose futet në ushqim gjatë prodhimtarisë së vet, përgatitjes ose trajtimit.

Qëllim kryesor i këtij ligji është shkallë e lartë e mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe mbrojtjes së lartë të interesave të konsumatorëve, duke përfshirë edhe praktikën gjatë tregtisë me ushqim, duke marrë parasysh, aty ku nevojitet, mbrojtjen shëndetësore të kafshëve dhe mirëqenien e tyre, shëndetin e bimëve dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Drejtori i AUV në bashkëpunim me ministrin për shëndetësi, i cakton kërkesat për siguri dhe cilësi të ujit të pijshëm, pas pëlqimit që parapakisht e ka marrë QRM (neni 27 paragrafi (12)).


Klontrrolletet inspektuese mbi këtë ligj i kryen AUV nëpërmjet inspektorëve shtetëror për ushqim dhe veterinerëve zyrtar dhe Inspektoratit shtetëror për bujqësi, nëpërmjet inspektorëve shtetëror për bujqësi dhe inspektorëve shtetëror fitosanitar.

2.4.6 Uji për larje

Direktiva 2006/7 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga 15 shkurt 2006 për cilësi të ujërave për larje është transponuar në LU dhe dispozitat që rezultojnë nga ligji. Në lidhje me shkallën e transponimit të Ligjit me LU duhet të miratohen aktet nënligjore që rezultojnë nga Ligji për t'u arritur harmonizim me kërkesat nga Direktiva.

Në LU "uji për larje" është pjesë e çdo uji sipërfaqësor që rrjedh ose nuk rrjedh në të cilin nga ana e organit kompetent lejohet larja ose në të cilin larja nuk është e ndaluar dhe këtë tradicionalisht e praktikon numër i madh individësh. Uji për larje nuk konsiderohen ujërat në pishina dhe basene me ujë burimi, ujërat në banja që shfrytëzohen për qëllime terapeutike dhe ujëra të rrethuara në mënyrë artificiale të ndara prej ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore.

Mënyra dhe masat e menaxhimit me ujërat për larje, kriteret teknike dhe qëllimet për cilësinë e ujit për larje janë përcaktuar në Rregulloren për mënyrën dhe masat e menaxhimit me ujërat për larje, kriteret teknike



dhe qëllimet e cilësisë së ujit për larje, si dhe mënyra e procedura e informimit të publikut për rezultatet nga monitorimi i ujit për larje (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 129/16).

Kryetari i komunës e informon publikun për ndryshimin e cilësisë së ujit për larje si dhe masat që duhet të ndërmerren.

2.4.7. Ujërat e zeza urbane

Ujërat e zeza urbane në LU janë ujërat e zeza të ekonomive shtëpiake ose përzjerje e ujërave të zeza të ekonomive shtëpiake dhe ujërave të zeza industriale dhe/ose ujit prej rreshjeve.

Direktiva për ujëra të zeza urbane është transponuar në LU dhe në aktet nënligjore që rezultojnë nga ligji. Akte nënligjore me të cilat rregullohet kjo fushë janë:

- Rregullorja për materiet dhe substancat e rrezikshme dhe të dëmshme dhe standardet e tyre të emitimit që mund të shkarkohen në kanalizim ose në sistem për kullim, në trupa ujqorë sipërfaqësor ose nëntokësor, si dhe në tokat e bregjeve dhe habitate ujqore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 108/11);
- Rregullorja për kushtet më të afërta për grumbullim, kullim dhe trajtim, mënyrën dhe kushtet e projektimit, ndërtimit dhe eksploatimit të sistemeve dhe stacioneve për trajtim të ujërave të zeza urbane, si dhe standardet teknike, parametrat, stranderdet e emitimit dhe normat për cilësi dhe para-trajtim, mënjanim dhe trajtim të ujërave të zeza, duke pasur parasysh ngarkimin dhe metodën për trajtimin e ujërave të zeza urbane të cilat lëshohen në zonat sensitive ndaj shkarkimit të ujërave të zeza urbane (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 73/11);
- Rregullorja për kushtet, mënyrën dhe vlerat e limiteve të emitimit për shkarkim të ujërave të zeza pas trajtimit të tyre, mënyrën e llogaritjes së tyre, duke pasur parasysh kërkesat e posaçme për mbrojtjen e zonave të mbrojtura (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 81/11);
- Rregullorja për kushtet më të afërta, mënyrën dhe vlerat maksimale të lejuara dhe koncentracionet e parametrave të ujërave të zeza të trajtuara për përdorim të tyre të sërishëm (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 73/11);
- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe të lejes për shfrytëzim të sërishëm të ujërave të zeza të pastruara, si dhe mënyrën e lëshimit të lejes (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/11);
- Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e përdorimit të llumit, vlerat maksimale të koncentracioneve të metaleve të rënda në tokë në të cilën përdoret llumi, në pajtim me dedikimin e tij dhe sasi të maksimale vjetore të metaleve të rënda që mund të futen në tokë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 73/11);
- Rregullorja për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e dërgimit të të dhënave dhe llojin e informatave për përdorim të llumit nga trajtimi i ujërave të zeza urbane në pajtim me dedikimin, trajtimin, përbërjen dhe vendin e përdorimit të saj (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” 60/11) dhe
- Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe të lejes për përdorim të llumit si dhe mënyrën e lëshimit të lejes për përdorim të llumit (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/11).

Komunat në Republikën e Maqedonisë janë të obliguara t’i grumbullojnë, derdhin dhe pastrojnë ujërat e zeza që dalin prej territorit të tyre ose krijohen në territorin e tyre, duke përfshirë edhe mënjanimin e llumit. QRM, kryetarët e komunave, janë të obliguar të sigurojnë:

1. ekzistim të sistemit për grumbullim të ujërave të zeza në çdo vend të banuar me më tepër se 2.000 banor;
2. trajtim adekuat të të gjitha ujërave të zeza që shkarohen prej sistemeve për grumbullim të ujërave të zeza nga vendet e banuara prej më pak se 2.000 ekuivalent banorë;
3. trajtim dytësor (biologjik) ose përkatëse i ujërave të zeza nga sistemet për grumbullimin e ujërave të zeza prej vendbanimeve prej më shumë se 2000 ekuivalent banorë dhe
4. ujërat e zeza që shkarkohen në zona sensitive ndaj shkarkimit të ujërave të zeza urbane që do t’i nënshtrohen trajtimit më të ashpër.

Nëse ekzistimi i sistemit për grumbullim dhe kullim të ujërave të zeza nuk është i arsyeshëm për shkak të shpenzimeve të larta ose për arsye se sistemi nuk do të kontribuojë për përmirësimin e mjedisit jetësor, përdoren sisteme individuale ose sisteme tjera përkatëse me të cilat arrihet niveli i njëjtë i mbrojtjes së mjedisit jetësor.

MMJPH në bashkëpunim me MTL janë përgjegjës për zhvillimin e programit për shkarkim, trajtim dhe grumbullim të ujërave të zeza urbane. QRM miraton Program për kullim, grumbullim dhe trajtim të ujërave të zeza urbane. Propozim i programit për shkarkim, grumbullim dhe trajtim të ujërave të zeza urbane përgatitet në bazë të propozimit të programeve të këshillave të komunave.


Për momentin në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë 19 pika trajtim të ujërave të zeza që janë në funksion dhe janë me kapacitet të përgjithshëm prej 292.250 ekuivalent banorë. Ekzistojnë edhe pika më të vogla trajtimi që janë ndërtuar, por që nuk janë në funksion. Më poshtë janë paraqitur pikat e trajtimit në RM që janë funksionale.

Pika për trajtim të ujërave të zeza - funksionale

Emri i PPUZ	Emri i komunës	I projektuar për e. b.	Viti i ndërtimit
Dojran i Ri	Dojran	12.000	1988
Miravcë, Gjevgjeli	Gjevgjeli	3.000	2000
Bogorodica, Gjevgjeli	Gjevgjeli	2.500	2005
Llozovë	Llozovë	2.200	2006
Argulicë, Karbincë	Karbincë		2016
Tarincë, Karbincë	Karbincë	600	2005
Kukureçan	Manastir		2008
Krivogashtani	Krivogashtani	3.200	2007
Berovë	Berovë	14.000	2010
Kumanovë	Kumanovë	91.000	2006
Çuçer-Sandevë	Çuçer-Sandevë	3.000	2007
Ilinden	Ilinden	1.250	2016
Marino, Ilinden	Ilinden	1.250	2011
Kadino, Ilinden	Ilinden	1.250	2015
Makedonski Brod	Makedonski Brod	5.000	2000
Vollkovë	Gjorçe Petrov	19.500	2016
Ezerani, Resnjë	Resnjë	12.000	2004
Vranishtë, Strugë	Strugë	120.000	1988
Bellçishtë, Debarcë	Debarcë	500	2006
		271.950	

Ka filluar ndërtimi i pesë pikave të trajtimit që duhet të përfundohen dhe të lëshohen në përdorim në vitin 2018 në komunat në vijim: Gjevgjeli, Kërçovë, Prilep, Radovish dhe Strumicë. Me ndërtimin e këtyre pikave të trajtimit do të shërbehen ekuivalencë prej 235.491 banorë.

Me përfundimin e këtyre pesë pikave për trajtim të ujërave të zeza, kapaciteti i përgjithshëm për trajtim do të arrijë përafërsisht 525.000 ekuivalent banorë përkatësisht 24.5% të kapacitetit të nevojshëm.



Në të ardhmen është planifikuar ndërtim i pikave të trajtimit në Manastir dhe Tetovë me çka kapaciteti për trajtim në vend do të rritet për ekuivalencë prej 210.000 banor shtesë, me çka kapaciteti i përgjithshëm do të jetë për 735.000 ekuivalen banorë, rose reth 34.3% të kapacitetit të përgjithshëm të nevojshëm.

2.4.8. Zona sensitive ndaj nitrateve

Për shkak të mbrojtjes së ujërave nga depërtimi i nitrateve nga aktivitetet bujqësore MBPEU bashkë me MMJPH i caktojnë kriteret për përcaktimin e zonave sensitive ndaj nitrateve. Kriteret janë caktuar në Rregullore për përcaktimin e kriterëve për përcaktimin e zonave sensitive ndaj nitrateve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 131/11). Për shkak të mbrojtjes së ujërave, MMJPH bashkërisht në marrëveshje me MBPEU miraton plan operativ për mbrojtjen e ujërave prej nitrateve për periudhë prej katër viteshe.

2.4.9. Mbrojtje nga ndikimi ndikimi i dëmshëm i ujërave

Mbrojtja prej ndikimit të dëmshëm të ujërave përfshin aktivitete dhe masa për mbrojtje prej vërshimeve, erozioni dhe rrëketë, mbrojtje nga ngrirja e ujërave sipërfaqësore dhe mënjanim të pasojave prej ndikimit të dëmshëm.

Mbrojtja prej ndikimit të dëmshëm është kompetencë e njësive të vetëqeverisjes lokale në territorin e tyre.

Me qëllim të mbrojtjes prej ndikimeve të dëmshme të ujërave, MMJPH në bashkëpunim me MBPEU përgatit Program për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave në kuadër të pellgut lumor përkatës, si pjesë përbërëse e PMPL. Për shkak të zbatimit të Programit, MMJPH, këshilli i komunave si dhe ekonomia e ujërave, miratojnë plane operative për siguri dhe mbrojtje prej vërshimeve të zonave të rrezikuara.

MMJPH, njësiti e vetëqeverisjes lokale dhe ekonomitë ujore, përgatisin, miratojnë dhe publikojnë raporte për aktivitetet për vitin paraprak dhe aktivitetet e parapara për vitin e ardhshëm. Raportet janë në dispozicion të publikut. MMJPH në rast të rrezikut e informon publikun e prekur dhe siguron informata për masat e ndërmarra dhe jep këshilla për masat që duhet të ndërmerren për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe qëllimet e mjedisit jetësor.

2.4.9.1. Vërshime

Direktiva 2007/60/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit prej 23 tetorit 2007 për menaxhim dhe vlerësim të rrezikut prej vërshimeve është transponuar në LU.


Siguria dhe mbrojtja nga vërshimet dhe ndikim tjetër të dëmshëm të ujërave në zonat urbane është kompetencë e komunave në territorin e tyre, si dhe personat juridik që menaxhojnë me ekonomitë ujore janë kompetente për siguri dhe mbrojtje nga vërshimet dhe ndikimet tjera të dëmshme të ujërave në territorin e veprimit të tyre, duke përfshirë edhe rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtretërve dhe kanaleve në territorin e tyre.

Këshillat komunalë miratojnë plane operative për siguri dhe mbrojtje prej vërshimeve për zonat e rrezikuara me propozim të kryetarëve të komunave. Në rast të rrezikut nga rrënimi i pendave, depërtimi i argjinaturave mbrojtëse, si dhe shkarkim ose derdhje të sasive më të mëdha të ujit prej akumulimeve që mund të shkaktojnë vërshime, ekonomia ujore dhe persona tjerë juridik janë të obliguar të sigurojnë informata dhe të alarmojnë popullatën në territorin e rrezikuar.

MMJPH menjëherë e informon publikun e prekur në rast të rrezikut dhe siguron informata përkatëse për masat e ndërmarra dhe jep këshillapër masat që duhet të ndërmerren që të mbrohet jeta dhe shëndeti i njerëzve dhe të plotësohen qëllimet e mjedisit jetësor.

2.4.9.2. Mbrojtje nga erozioni dhe rregullim i rrëkeve

Njësiti e vetëqeverisjes lokale më saktësisht Këshillat komunalë janë të obliguar t'i caktojnë kufijtë e zonës erozive dhe territorin e rrezikuar nga erozioni. MJPH në bashkëpunim me MBPEU i caktojnë masa për mbrojtje nga erozioni dhe i përcakton masat për mbrojtje prej rrëkeve.



Masat për mbrojtje nga erozioni ja pyllëzimi, gjelbërim dhe ndërtim të tarracave, ndalim të gërmimit të dheut, rërës, çakallit dhe gurit, ndalim të shkurtimit, prerjes dhe gërryerjen e drunjve dhe shkorreve dhe ndalesë për kullosje.

Masat për mbrojtje prej rrëkeve janë kompetencë e njërive të vetëqeverisjes lokale përkatësisht personit juridik që menaxhon me përruat ose me objektet.

Persona juridik dhe fizik të cilët me veprimin e tyre krijojnë erozion janë të obliguar që, në llogari të tyre, t'i ndërmarrin masat mbrojtëse për parandalimin e erozionit, t'i mënjanojnë pasojat dhe ta kompensojnë dëmin.

2.4.10. Monitorimi i ujërave

MMJPH është përgjegjës për monitorimin e përgjithshëm të trupave ujour të përfshirë me rrjetin shtetëror. MMJPH e themelon, mirëmban dhe e zhvillon rrjetin shtetëror. Kryetari i komunës është përgjegjës për monitorim të trupave ujour të përfshirë me rrjetin lokal dhe për punën e vet, mirëmbajtjen dhe zhvillimin.

Monitorimin e shkarkimit të ujërave të zeza e bën MMJPH. Monitorimi është përkufizuar në Rregulloren për metodologjinë, metodat referente matëse, mënyrën dhe parametrat e monitorimit të ujërave të zeza, duke përfshirë edhe llumin nga trajtimi i ujërave të zeza urbane ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 108/11) dhe Rregulloren për mënyrën e transferimit të informatave nga monitorimi i ujërave të zeza të shkarkuara, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit me të cilën dërgohen të dhënat ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 108/11).

Monitorimin e ujërave të dedikuara për konsum nga njeriu e bën MSH me Institutin për shëndet publik (ISHP) dhe Qendrat për shëndet publik (QSHP) në pajtim me dispozitat për ujë dhe siguri të ushqimit. Në programin për monitorim detyrimisht përfshihet pjesë e veçantë për zbatimin e monitorimit të sigurisë së ujit për konsum nga njeriu. Programi është pjesë përbërëse e PMPL. MSH i grumbullon, përpunon dhe i ruan të gjitha të dhënat dhe informatat e pranuar nga monitorimi i ujërave, të dedikuara për konsum nga njeriu, dhe i dërgon në MMJPH dhe AUV. MSH është përgjegjëse të publikojë raporte për gjendjen e ujit të dedikuar për konsum nga njeriu në çdo tre vite.

Monitorimin e ujërave në zonat për larje e bëjnë kryetarët e komunave në territorin e të cilave gjendet zona për larje. Kryetari i komunës në territorin e të cilës gjendet zona për larje dhe të dhënat për atë i dërgon në MSH, Inspektoratin shtetëror sanitar dhe shëndetësor dhe në MMJPH. Kryetari i komunës i dërgon të dhënat e pranuar nga rrjeti lokal për monitorim si dhe të dhënat e pranuar nga monitorimi i ujit për larje te MMJPH.

MMJPH i grumbullon, përpunon dhe i ruan të gjitha informatat e pranuar nga monitorimi i trupave ujour.


Grumbullimi, përpunimi, ruajtja dhe dërgimi i informatave të prodhuara nga monitorimi bëhet pa kompensim. Informatat e prodhuara dhe të përpunuara, në pajtim me obligimet dhe kompetencat e caktuara me ligj, janë në dispozicion të publikut pa kompensim për të gjitha organet kompetente.

2.4.11. Sistemi i informimit për ujërat

MMJPH hap dhe mban libër për ujourat i cili përmban të dhëna për menaxhim me ujëra.

MMJPH themelon, përpilon dhe mban Kadastër të ndotësve si pjesë e Kadastrit të ndotësve të caktuar në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor. Në Kadastër përcaktohet shkalla e ndotjes së ujërave të zeza industriale, ujërat atmosferike dhe urbane, ujërat nga deponitë, si dhe ndikimi i tyre i dëmshëm mbi cilësinë e ujërave në recipientin dhe për të konstatuar burimet tjera të ndotjes së ujërave në zonën e pellgut.

Qasja e publikut deri te të dhënat dhe informatat lidhur me monitorimin e ujërave bëhet në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor. MMJPH dhe MSH me qëllim të mundësimit të qasjes së publikut te të dhënat dhe informatat në lidhje me monitorimin e ujërave i publikojnë të dhënat dhe rezultatet e prodhuara nga monitorimi i trupave ujour dhe ujërat e dedikuara për shfrytëzim, në raporte periodike dhe/ose raporte vjetore. Të dhënat nga Kadastru janë në dispozicion për publikun në vëllim, formë dhe mënyrë të caktuar me Ligjin për mjedisin jetësor.



Për të informuar publikun, organet kompetente të administratës shtetërore përpilojnë raporte periodike për zbatimin e obligimeve që rezultojnë nga LU, duke i përfshirë edhe të dhënat e prodhuara nga monitorimi i ujërave për QRM.

2.4.12. Shërbime dhe objekte të ekonomive ujore

Objektet dhe impiantet për ekonomi ujore janë objekte të dedikuara për rregullim të regjimit të ujërave, sigurimin, zgjerimin, grumbullim dhe përgatitje të ujit për furnizim të popullatës, nevojat industriale dhe të tjera ekonomike dhe komunale (objekte për furnizim me ujë), ujit për vaditje të tokës bujqësore dhe pranim dhe grumbullim të ujërave tepricë (sisteme për vaditje dhe sisteme për kullim të ujërave), ujit për prodhimtari të energjisë elektrike (objekt hidroenergjetik), zgjerim, grumbullim dhe trajtim të ujërave të zeza të ndotura dhe për kullimin e tyre deri te një recipient (objekt për mbrojtje të ujërave) dhe plotësim të nevojave të veçanta të dedikuara për mbrojtje, nevoja ekologjike (objekte të posaçme).

Ndërtimi, puna, menaxhimi dhe mirëmbajtja e objekteve dhe impianteve të ekonomive ujore me qëllim të realizimit të veprimtarive dhe shërbimeve të ekonomive ujore janë me interesit publik.

Veprimtaritë dhe shërbimet të ekonomisë ujore janë: furnizim publik me ujë për konsum nga njeriu dhe për nevoja teknologjike, prodhim të energjisë elektrike, vaditje të tokës dhe kullim të ujërave, mbrojtje dhe ruajtje të ujërave, grumbullim, kullim, trajtim dhe shkarkim të ujërave të zeza, mbrojtje prej ndikimit të dëmshëm të ujërave, eksploatim i ujërave nëntokësore, nxjerrje të rërës, çakallit dhe gurit dhe sigurim të rezervave të ujit me të cilat sigurohet regjim i unifikuar ujërave në një pellg ose në një pjesë të tij.

2.4.13 Furnizimi me ujë

Në lidhje me furnizimin me ujë në LU janë përcaktuar të drejta dhe obligime të personit juridik që menaxhom me objekte dhe impiante të ekonomisë ujore.

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemit efikas dhe ekonomik për furnizim me ujë të pijshëm, në sasi të mjaftueshme dhe sipas kërkesave për të gjithë shfrytëzuesit ligjor dhe ndërmarrja e

masave të veçanta është në kompetence të kryetarit të komunës. Për të arritur standardet dhe vlerat për cilësi, personat juridik të cilët kryejnë furnizimin me ujë të dedikuar për konsum nga njeriu janë të obliguar të bëjnë dezinfektim të ujit.

Në rast të mosrespektimit të vlerave dhe standardeve për cilësi, personi juridik dhe organet kompetente për mbrojtje shëndetësore i hulumtojnë dhe identifikojnë shkaqet të cilat janë arsye për mosrespektimin.


Shfrytëzuesi e ka për obligim të shfrytëzojë dhe mirëmbajë sistemin e furnizimit me ujë të vendit, në mënyrë që nuk do të shpie në reduktimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe do të sigurojë ujë në sasi të mjaftueshme, si dhe në mënyrë me të cilën humbja e ujit zvogëlohet në minimum.

Kryetarët e komunave në bashkëpunim me personin juridik për furnizim me ujë janë të obliguar, në rast të mosrespektimit, menjëherë dhe pa vonesë t'i ndërmarrin masat e nevojshme për sanim, si dhe të përcaktojnë kufizime dhe restriksione për shfrytëzimin e ujit sipas nevojës, për të siguruar mbrojtje të ujit, si dhe ta informojnë AUV.

Në rast kur masat për sanim kanë ndikim mbi popullatën, kryetarët e komunave e kanë për obligim që menjëherë ta informojnë popullatën për masat e ndërmarrja dhe për masat të cilat do të ndërmerren, kohëzgjatjen e masave dhe të japin këshilla e rekomandime adekuate për aktivitete të cilat duhet të ndërmerren me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të tyre.

Personi juridik i cili bën furnizimin publik me ujë është i obliguar që humbjet në sistemin e ujësjellësit t'i ulë në minimum, si dhe t'i ndërmerren masat e nevojshme për atë. Të gjitha informatat dhe të dhënat për cilësinë e ujit të pijshëm janë publike në pajtim me ligj.

Secili e ka për obligim ta përdor ujin me kujdes dhe në mënyrë racionale dhe vetëm për dedikimin për të cilin është paraparë. Shfrytëzuesi i ujit është i obliguar t'i paguajë harxhimet e krijuara nëse, me qëllim ose nga



neglizhenca, shkakton dëmtim ose mosfunksionim të sistemit për çka nevojitet rregullim ose me atë shkakton ndotje ose shfrytëzim të padedikuar të ujit.

Për të informuar publikun, MSH në çdo tre vite përpilon dhe lëshon raport për ujin e dedikuar për konsum nga njeriu për gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë. Raporti vlen për tre vite kalendarike dhe publikohet në afat prej një viti kalendarik nga fundi i periudhës paraprake ose fillimi i periudhës vijuese për raportim.

Raporti përmban informata për masat e ndërmarrja, për standardet e cilësisë, për shmangiet prej vlerave të caktuara dhe standardeve për cilësi, programet për monitorim dhe rezultatet e monitorimit të sigurisë së ujit të dedikuar për konsum nga njeriu, si dhe të dhëna për të gjithë personat juridik që furnizojnë me ujë më tepër se 5.000 banorë ose furnizojnë më tepër se 1.000 metra kub ujë në nivel ditor.

2.4.14. Furnizim me ujë të pijshëm dhe kullimi i ujërave të zeza urbane

Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kullimi e ujërave të zeza urbane është rregulluar me Ligjin për furnizim me ujë të pijshëm dhe kullimin e ujërave të zeza urbane ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 68/04, 28/06, 103/08, 17/11, 54/11, 163/13, 10/15, 147/15 dhe 31/16) dhe LU.

Ligji për me ujë të pijshëm dhe kullimin e ujërave të zeza urbane i rregullon kushtet dhe mënyrën e furnizimit me ujë të pijshëm, ndërprerjen e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kullimin e ujërave të zeza urbane në recipient nëpërmjet sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërtimin, mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe lidhjen e sistemeve të ujësjellësve dhe të kanalizimit, raportet mes dhënësit dhe shfrytëzuesit të shërbimit, si dhe mbikëqyrje në zbatimin e ligjit.

Qëllim i ligjit është:

- të ketë në dispozicion sasi të mjaftueshme të ujit cilësor dhe të pastër, në aspekt shëndetësor, për pije dhe për nevojat e shfrytëzuesve të shërbimit;
- furnizim me ujë të pijshëm i rregullt, në aspekt shëndetësor, kurse në rast të kontaminimit të tij, ndalim ose kufizim të shfrytëzimit;
- informim përkatës i shfrytëzuesve të shërbimit për cilësinë e ujit të pijshëm dhe ndërmarrje të masave për siguri të cilësisë së ujit të pijshëm;
- trajtim adekuat i ujërave të zeza industriale para shkarkimit të tyre në recipient dhe
- nëpërmjet kullimit të ujërave të zeza urbane të sigurojë mbrojtje prej efekteve negative nga shkarkimi i tyre (Neni 2);

Në Ligjin për furnizim me ujë të pijshëm dhe kullimin e ujërave të zeza urbane, dhënës i shërbimit është ndërmarrje publike e themeluar nga komuna, nga qyteti i Shupit, nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë ose person juridik që i plotëson kushtet për kryerjen e veprimtarisë së caktuar me ligj dhe në të cilin kapital dominues ka komuna, Qyteti i Shkupit ose Republika (neni 3 pika 16).

Dhënësi i shërbimit për furnizim me ujë dhe kullim të ujërave të zeza urbane është i obliguar të menaxhojë dhe të mirëmbajë sistemin e furnizimit me ujë dhe sistemin e kanalizimit me të cilin menaxhon (neni 4);

Dhënësi i shërbimit është përgjegjës për furnizim me ujë të pijshëm me grumbullim, përpunim dhe distribuim të ujit nëpërmjet sistemit të ujësjellësit në matësin kryesor të ujit të shfrytëzuesit të shërbimit, i kullon ujërat e zeza urbane në recipient, të grumbullojë ato prej shfrytëzuesve të shërbimit nëpërmjet rrjetit të kanalizimit, trajtim dhe shkarkim në recipient, kullim të ujërave atmosferik dhe kullimin në recipient me grumbullimin e tyre nga sipërfaqet urbane, me kullim nëpërmjet rrjetit të kanalizimit dhe rrjetit atmosferik t'i shkarkojnë në recipient (neni 5);

Dhënësi i shërbimit siguron furnizim permanent dhe të pandërprerë me ujë të pijshëm në gjendje të rregullt dhe të pastër nga aspekti shëndetësor nëpërmjet sistemit të ndërtuar të ujësjellësit si dhe për kullimin e ujërave të zeza urbane nëpërmjet sistemit të ndërtuar për kanalizim (neni 8) dhe bën testim të gjendjes së rregullt të ujit të pijshëm në aspektin shëndetësor në mënyrë dhe procedurë të caktuar me ligj (neni 9);

Në lidhje me shfrytëzuesit, dhënësi i shërbimit është i obliguar t'i informojë shfrytëzuesit e shërbimit për çrregullimin ose ndërprerjen në dhënie të shërbimit (neni 8 paragrafi 4). Dhënësi i shërbimit e përcakton kompensimin për lidhjen e shfrytëzuesit të shërbimit në sistemin e ujësjellësit dhe të kanalizimit (neni 7),



e mirëmban edhe lidhjen e shfrytëzuesit të shërbimit me ujësjellësin (neni 14), në llogari të shfrytëzuesit të shërbimit vendos matës funksional të ujit, ndërsa në të kundërtën shfrytëzuesi i shërbimit mund të parashtrojë kundërshtim në afat prej 15 ditëve nga dita e konstatimit të defektit deri te organi mbikëqyrës i dhënësit të shërbimit (neni 30), e cakton llojin dhe dimensionin e matësve të ujit (neni 27 paragrafi 4), e bën verifikimin e matësve të ujit (neni 27), e menaxhon me sistem të furnizimit me ujë ose të kanalizimit të ndërtuar me mjete të qytetarëve, prej donatorëve vendas dhe të huaj ose shfrytëzues tjerë, që me marrëveshje i jepet për menaxhim atij dhe paraqet tërësi të sistemit të unifikuar të ujësjellësit ose të kanalizimit (neni 32).

Kontrollin inspektues për zbatimin e këtij ligji dhe të dispozitave të miratuara në bazë të tij, e bën inspektori i autorizuar komunal i komunës dhe inspektori i autorizuar komunal i Qytetit të Shkupit, Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor, Inspektorati shtetëror komunal, Agjencia për ushqim dhe veterineri përmes inspektorëve shtetëror për ushqim dhe Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor.

2.4.15. Vadtja dhe kullim i ujërave

Shfrytëzimi i ujërave dhe kullimi e ujërave në tokë bëhet me hidrosisteme ose sisteme për vaditje ose kullim të ujërave.

Mirëmbajtja e hidrosistemeve ose sistemeve për vaditje dhe kullim të ujërave rregullohet me Ligjin për ekonomi të ujërave

2.4.16. Ekonomi të ujërave

Ligji për ekonomi të ujërave ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 51/15, 93/15) e rregullon ekonomizimin, shfrytëzimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e hidrosistemeve, sistemeve për vaditje dhe sistemeve për kullim të ujërave.

Qëllimet e ligjit janë:

- sigurim i ekonomizimit racional, shfrytëzimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së hidrosistemeve, sistemeve për vaditje dhe sistemeve për kullim të ujërave;
- përcaktimi i vëllimit të shërbimeve që u jepen shfrytëzuesve të ujit nga ana e ushtruesit të veprimtarisë së ekonomisë ujore;
- vendosja e kushteve për punë normale dhe të suksesshme të ushtruesit të veprimtarisë për ekonomi ujore dhe shfrytëzimin e shërbimeve të tij nga shfrytëzuesit e ujit dhe
- themelim i shoqërisë aksionare në pronësi shtetërore SHA Ekonomi ujore e Republikës së Maqedonisë.


Veprimtaritë e ekonomisë ujore janë veprimtari me interes publik. Për kryerje të veprimtarive të ekonomisë ujore, QRM ka themeluar Shoqëri aksionare për Ekonomi ujore të Republikës së Maqedonisë.

Përveç SHA Ekonomi ujore, veprimtari të ekonomisë ujore kryejnë edhe ndërmarrjet publike Hidrosistemi Zletovicë, Strezhevë dhe Hidrosistemi Lisiçe të themeluara nga QRM, të cilat në suazat e punës së tyre për veprimtaritë e ekonomisë ujore dhe në kryerjen e punës së tyre i aplikojnë edhe dispozitat nga LU.

SHA Ekonomi ujore i përdor, i mirëmban dhe ekonomizon me sistemet për vaditje dhe kullim të ujërave në tërësi, me qëllim të:

- furnizimit me ujë për vaditje;
- furnizimit me ujë të ndërmarrjeve komunale për furnizim me ujë për konsum nga njeriu (ujë të pijshëm dhe tjera nevoja);
- furnizimit me ujë për nevoja industriale dhe teknologjike (ekonomike), duke përfshirë edhe prodhimtarinë e energjisë elektrike;
- rregullimit të shtretërve lumor;
- kullimit të ujërave në tokë dhe
- kullimit të ujërave të shkarkuara

SHA Ekonomi ujore në suazat e territorit të veprimtari mund të kryen furnizim me ujë të ndërmarrjes komunale për furnizim me ujë, të personave juridik për nevoja industriale dhe teknologjike, duke përfshirë edhe



prodhimtarinç e energjisë elektrike, vetëm kur sistemi e mundëson këtë, në pajtim me dokumentacionin e planit sipas të cilit është ndërtuar, me kushtet dhe mënyrën sipas këtij ligji (neni 7).

Për të siguruar punë efikase të sistemit, të mbrojtë ose të sigurojë mbrojtje të objekteve që i përkasin sistemit dhe kryejnë sigurim dhe mbrojtje prej vërshimeve në pajtim me LU, SHA Ekonomi ujore me mjete prej programeve të MMJPH: ndërton dhe mirëmban objekte për siguri dhe mbrojtje prej vërshimeve, ndërton dhe mirëmban objekte për parandalim dhe mbrojtje prej erozionit, ndërton dhe mirëmban objekte për rregullimin e lumenjve dhe rrëqeve dhe kryen punë tjera në pajtim me ligj (neni 10).

2.4.17. Çmime të shërbimeve ujore

Mënyra e përcaktimit të çmimit të shërbimeve ujore është e rregulluar me Ligjin për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve ujore ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 7/16).

Qëllim i Ligjit është themelim i sistemit të vetqëndrueshëm financiar të shërbimeve ujore, me të cilin do të sigurohet standard i lartë i shërbimeve me çmime të pranueshme në pajtim me SNU dhe PMPL.

Ligji duhet ta sigurojë që çmimi i përgjithshëm i shërbimeve ujore për ekonomi shtëpiake mesatare të jetë i pranueshëm në pajtim me të hyrat e përgjithshme të ekonomive shtëpiake, krijimin e kushteve me investimet e domosdoshme në sistemet e furnizimit me ujë të sigurohet shfrytëzim i qëndrueshëm i infrastrukturës për realizimin e shërbimeve ujore me qëllim të arritjes së kthimit të plotë të shpenzimeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ujore në pajtim me praktikat më të mira në dispozicion dhe aplikimin e parimit ndotësi paguan, shfrytëzuesi paguan dhe parimin e harxhimeve të resursit.

- përmirësim të efikasitetit të shërbimeve ujore me qëllim të sigurimit të cilësisë më të mirë të shërbimeve ujore me minimumin e shpenzimeve dhe

- kushte stabile dhe të parashikueshme për punë të dhënësve të shërbimeve ujore dhe për mbrojtje të konsumatorëve e shfrytëzuesve nga keqpërdorimi i pozitës dominuese të dhënësve të shërbimeve ujore.




Projekti “Qytetarët – partner aktiv në reformat e politikave për ujë”

“Analizë e gjendjes së menaxhimit me ujërat në Republikën e Maqedonisë dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve”

3

SHPËRNDARJA E INGERENCAVE NË MENAXHIMIN ME UJËRAT NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL



Duke qenë se uji paraqet pasuri nacionale, resurs i cili është i dobishëm përgjithësisht, organet dhe institucionet në Republika e Maqedonisë kanë për obligim ta menaxhojnë dhe ta mbrojnë cilësinë e ujërave në çdo aspekt, ashtu që në tekstin më poshtë është dhënë pasqyrë e organizimit institucional në sektorin/fushën e ujërave në R. e Maqedonisë në nivel qendror dhe lokal.

3.1. Kompetenca në nivel qendror në menaxhimin me ujërat

Menaxhimi me ujërat në Republikën e Maqedonisë në pajtim me rregulloren ekzistuese ligjore është ndarë ndërmjet më tepër organeve.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është kompetent për miratimin e SNU dhe BU.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në pajtim me LU është përgjegjëse për:

- miratimin e PMPL;
- përcaktimin e qëllimeve ekologjike;
- përpilimin dhe miratimin e programit për masa për menaxhim me çdo pellg lumor veçmas;
- përcaktimin e standardeve për cilësi të ujit dhe
- identifikimin e zonave për mbrojtje të ujërave.

MMJPH është organ kompetent për:

- përpilim të dokumenteve themelore të planit dhe zhvillimit të përgjithshëm të politikës për menaxhim me ujëra si dhe për koordinim të aktiviteteve menaxhuese;
- grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e të gjitha informatave të prodhuara nga monitorimi i trupave ujqor si dhe mbajtjen e bazës zyrtare të të dhënave për menaxhim me resurset ujore, zhvillim dhe kontroll të menaxhimit me ujëra dhe mbrojtje si dhe këmbim të të dhënave relevante me të gjithë trupat kompetent, me kërkesë të tyre dhe pa kompensim;
- për të siguruar qasje për publikun në të dhënat dhe informatat që kanë të bëjnë me monitorimin e ujërave, MMJPH dhe organi kompetent për mbrojtje shëndetësor janë të obliguar t'i publikojnë të dhënat dhe rezultatet e prodhuara nga monitorimi i trupave ujqor dhe ujërave të parapara për shfrytëzim në raportet periodike dhe/ose vjetore;
- themelim të Librit për ujëra që paraqet regjistër të plotë dhe vazhdimisht të azhurnuar të: lejeve për shfrytëzim të ujit; lejeve për shkarkim, lejeve për gjerim të rërës, çakallit dhe gurit prej shtretërve lumorë dhe pjesë bregore të trupave ujqor sipërfaqësor; zonave të mbrojtura; zonave të vërshimit; të drejtave dhe obligimeve të vjetra; licencave për menaxhim me resurse ujore; kërkesave për lëshimin e lejeve; drejtori e përkohshme e detyruar dhe të dhëna tjera që janë relevante për vendimet administrative që kanë të bëjnë me ujërat dhe
- themelim dhe mbajtje të Kadastrës së ndotësve të ujit (si pjesë e Kadastrës të mjedisit jetësor) me qëllim të përcaktimit të nivelit të ndotjes së ujërave të zeza industriale, ujërave atmosferike dhe urbane, ujërat në deponi, si dhe ndikimi i tyre i dëmshëm.

Punët profesionale në fushën e ujërave në pajtim me LU i bën DMJ dhe e njëjta është kompetente të:


- kryej punët profesionale dhe të ndërmer masa dhe aktivitete relevante për menaxhim me ujërat, në zonën e çdo pellgu lumor;
- merr të dhëna dhe i zbaton testimet e nevojshme për përcaktim të shtretërve, sasive dhe cilësive të ujërave dhe kërkon ndërmarrje të masave të nevojshme për mbrojtje të ujërave nëntokësore të zbuluara gjatë hulumtimeve gjeologjike ose gjatë eksplotimit të lëndëve të para minerale, gjerim të tuneleve dhe aktivitete tjera të gjerimit ose shpimit të tokës;
- përpunojë vlerësim bazik të karakteristikave të çdo pellgu lumor;
- sigurojë menaxhim me pjesën e zonës së pellgut ndërkombëtar lumor që gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligj dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifkuar nga Republika e Maqedonisë;
- kryejë punë profesionale në lëshimin e lejeve dhe pëlqim për ekonominë ujore pajtim me LU;
- mbajë dhe azhurnojë librin e ujërave;

- mbajë dhe azhurnojë regjistër të zonave të mbrojtura;
- koordinojë aktivitete dhe të merr pjesë në përpunimin e Strategjisë nacionale për ujëra;
- koordinojë aktivitete dhe të merr pjesë në përpunimin e Bazës për ekonomi ujore të Republikës së Maqedonisë;
- përpunojë dhe zbatojë Plane për menaxhim me pellgjet lumore;
- përpunojë Program të masave;
- zbatojë Programe të masave;
- grumbullojë, përpunojë dhe ruajë të dhënat nga monitorimi i ujërave;
- sigurojë menaxhim me pjesën e zonës së pellgut ndërkombëtar lumor që gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë, në pajtim me ligjin dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Maqedonisë;
- grumbullojë, ruajë dhe përpunojë të dhënat nga evidenca e objekteve dhe impianteve të ekonomisë ujore;
- vendos, përgatit dhe mbajë kadastra të ndotësve për pelgun përkatës lumor;
- kujdeset për zbatimin e masave për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm të ujërave në pelgun përkatës lumor;
- propozojë eksproprijimin e tokës në të cilën gjenden ujëra nëntokësore të nevojshme për furnizim publik me ujë;
- kryejë veprimtari shkencore-hulumtuese në fushën e ujërave;
- bën promovimin e teknikave dhe metodologjive për mbrojtjen e ujit dhe të kryejë punë tjera të caktuara me këtë ose ligj tjetër.

Këshilli nacional për ujëra është trup këshillëdhënës i formuar në pajtim me LU i formuar me Vendim për formim të Këshillit nacional për ujëra ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 149/09) të miratuar nga QRM dhe anëtarë në të janë përfaqësues të MMJPH, MSH, ME, MTB, MBPEU, MVL, BNJL, ASHAM, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të Këshillit për menaxhim me pellgjet lumore. Këshilli nacional është kompetent për shqyrtimin e çështjeve për menaxhim me ujërat, harmonizim dhe koordinim të nevojave dhe interesave të ndryshme. Këshilli nacional për ujëra përbëhet prej nëntë anëtarëve të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë për periudhë prej tre viteve pa të drejtën për zgjedhje të sërishme, përveç për përfaqësuesin e pellgut lumor mandati i të cilit zgjat një vit. Anëtarët e Këshillit nacional për ujëra zgjedhen nga radhët e personave të shquar shkencor dhe profesional nga sfera e menaxhimit të ujërave dhe fushave të ngjashme dhe nga shoqata e shfrytëzuesve të ujit. Përkrah përfaqësuesve të organeve të administratës shtetërore (mjedisi jetësor; shëndetësi; transport dhe lidhje; ekonomi; bujqësi) anëtarë janë edhe përfaqësues të BNJVL, Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, organizatë joqeveritare që vepron në mbrojtjen e ujërave me propozim të organizatave joqeveritare që gjatë tre viteve të fundit kanë punuar në këtë sferë dhe të Këshillit për menaxhim me zonën e pellgut lumor me nga një mandat në mënyrë të alternative prej secili këshill. Këshilli nacional për ujëra shqyrton dhe jep mendime, përcakton propozime dhe propozon miratim të dispozitave dhe ndërmarrje të masave për: propozim të ligjeve dhe akteve tjera me të cilat rregullohen çështjet nga fusha e menaxhimit me ujëra, zbatim të ligjeve dhe akteve tjera me të cilat rregullohen çështje të menaxhimit me ujëra, draft strategjinë nacionale për menaxhim me ujëra, draft-Bazën për ekonomi ujore të Republikës së Maqedonisë, draft-planet për menaxhim me pellg lumor, për nevojën për ndryshime dhe plotësime të Bazës për ekonomi ujore të Republikës së Maqedonisë dhe të planeve për menaxhim me pellg lumor, për plane tjera, masa dhe programe të caktuara në pajtim me këtë ligj dhe çështje tjera në pajtim me Rregulloren për punë.

MSH është përgjegjëse për:

- përgatitjen e legjisllacionit për ujë të pijshëm, të standardeve, kritereve për përcjelljen e cilësisë së ujit të pijshëm (me MMJPH, QRM);
- përcaktimin e zonave të mbrojtura për ujë të pijshëm (bashkë me MMJPH dhe ISHP);
- identifikim të trupave ujor të përshtatshëm për ujë të pijshëm dhe ujë për larje;
- përkujdesje për rregullsinë dhe sigurinë e ujit të pijshëm dhe ujërave për larje;
- informim dhe njoftim të publikut për cilësinë e ujit të pijshëm dhe
- informim të konsumatorëve për masat e ndërmarra kur ekziston shmangie nga cilësia e ujit të pijshëm.



AUV ndërmerr aktivitete për sigurinë dhe rregullsinë e ujit me të cilin furnizohen konsumatorët. AUV është përgjegjëse për themelimin e bazës për siguri të ujit të pijshëm dhe bën vlerësimin e rreziqeve për burimet e ndotjes.

Punën profesionale në lidhje me përcjelljen e cilësisë së ujërave e bëjnë **ISHP** dhe **QSHP** të cilat nëpërmjet laboratorëve të tyre në territorin e Republikës së Maqedonisë zbatojnë monitorim të rregullt të cilësisë së ujit të pijshëm (marrje të mostrave dhe analiza themelore). ISHP përpilon raporte vjetore për monitorim të ujit të pijshëm në bazë të raporteve të parashtruara nga QSHP.

Ndërmarrjet publike për furnizim me ujë janë të obliguara të sigurojnë cilësi të mirë të ujit të pijshëm dhe ta mbikëqyrin cilësinë e tij. NPFU dhe QSHP menjëherë e alarmojnë AUV, MSH dhe publikun nëse cilësia e ujit nuk është në pajtim me standardet e përcaktuara, i detektojnë shkaqet e ndotjes dhe e kanë për obligim të ndërmarrin masa për ndërprerje dhe kufizim të shfrytëzimit të ujit.

MTL është përgjegjëse për infrastrukturë komunale dhe çështje për furnizim me ujë dhe grumbullim, kullim të ujërave dhe trajtim të ujërave të zeza, e në veçanti për ndërtim dhe menaxhim me kapacitete për menaxhim me ujërat. MTL është organi përgjegjës për infrastrukturën e furnizim me ujë të pijshëm.

ME është kompetent për shfrytëzimin e resurseve të mineraleve dhe termo minerale si dhe krijimin e energjisë prej hidrocentraleve.

MBPEU në bashkëpunim me MMJPH mbetet trupi kompetent për transponim dhe zbatim të funksioneve lidhur me vaditje dhe mbrojtje të ujërave për ndotje nga resurset bujqësore (ndotje prej nitrateve) dhe proceset reale që i zbatojnë ekonomitë ujore.

Ekonomitë ujore janë përgjegjëse për menaxhim operativ me ujërat e dedikuara për vaditje (furnizim me ujë dhe kullim të ujërave për qëllime bujqësore).

DPHM është kompetente për monitorim real të regjimit të ujërave si pjesë e rrjetit shtetëror të MMJPH për monitorin. MMJPH duhet të përkufizojë dhe financojë zbatimin e programeve për përcjellje, grumbullon të dhëna, raporte për gjendjen e ujërave dhe bën kontroll të zbatimit të dispozitave nga LU për monitorim të ujërave. Krahas kësaj, Instituti Hidrometeorologjik i përcell tre liqenet natyrore në Republikën e Maqedonisë.

KRE i cakton tarifatat për shërbimet ujore.

Kontroll inspektues – Sa i përket kontrollit inspektues në sferën e mjedisit jetësor, kompetenca është e ndarë në nivel qendror dhe lokal. Në nivel qendror organi kompetent për kontroll inspektues është Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor, kurse në nivel lokal, kompetent janë inspektorët e autorizuar për mjedis jetësor. Kontrollin inspektues mbi dispozitat nga sfera e ujërave e kryen Inspektorati shtetëror i mjedisit jetësor dhe inspektorët për furnizim me ujë dhe inspektorët e mjedisit jetësor.

Kontrollin inspektues për zbatimin e pjesës së ujërave për larje dhe ujërave dedikuara për konsum nga njeriu i bën Inspektoratit shtetëror sanitar dhe shëndetësor dhe inspektorët për ushqim nga AUV.


Kontrollin inspektues që ka të bëjë me kontrollim e zonave sensitive ndaj nitrateve, vaditjen dhe kullimin e ujërave e bëjnë inspektorët e Inspektoratit shtetëror për bujqësi.

Kontrollet inspektuese mbi zbatimin e kompetencave të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit të caktuara me LU i bëjnë inspektorët e autorizuar të komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe në Qytetin e Shkupit.

Në pajtim me LU, inspektorët shtetëror sanitar dhe shëndetësor të janë përgjegjës për të kryer kontroll mbi cilësinë e ujit për larje dhe ujërat rekreative, ndërsa inspektorët për mjedis jetësor e kontrollojnë mbrojtjen nga ndotja të zonave për larje.

Instutet hulumtuese nuk kanë role dhe përgjegjësi konstante në sektorin për menaxhim me ujërat. Përrjashtim është Instituti Hidrobiologjik (IHB), që ka mandat për përcjellje.

Instituti hidrobiologjik është organizatë hulumtuese qeveritare publike, e arsimit të lartë me interes nacional që i përfshin subjektet hulumtuese limnologjike (kryesisht) të liqeneve natyrore dhe liqeneve artificiale dhe lumenjve. Fokus kryesor i tij është limnologjia e liqeneve natyrore në Maqedoni (Liqeni i Ohrit, Prespës dhe Dojranit). Tradicionalisht, hulumtimet e Institutit Hidrobiologjik janë të fokusuar në çështjet fundamentale



lidhur me hidrobiologjinë, duke përfshirë materiet nutritive, temperaturën (përzjerja dhe rryma), tejdukshmëria e ujit, prodhimtaria primare, kloforilet, flora dhe fauna, endemizmi, speciet.

3.2. Kompetenca të njësive të vetëqeverisjes lokale në menaxhimin me ujërat

Në pajtim me nenin 22 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 5/02) njësitë e vetëqeverisjes lokale janë kompetente për:

- mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës-masa për mbrojtje dhe parandalim të ndotjes së ujit, ajrit, tokës, mbrojtjes së natyrës, mbrojtjes nga zhurma dhe rrezatimit jo-jonizues dhe
- veprimtaritë komunale – ndër të tjerat furnizim me ujë të pijshëm, furnizim me ujë teknologjik, kullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza, kullimi dhe trajtimi i ujërave atmosferik. Grumbullimi, kullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza si veprimtari komunale dhe sipas Ligjit për veprimtari komunale paraqet kompetencë eksplicite të njësive të vetëqeverisjes lokale.

Komunat janë kompetente për mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe parandalim të ndotjes së ujit, furnizim me ujë të pijshëm, kullim të ujërave, grumbullim dhe trajtim të ujërave të zeza. Ato kryejnë aktivitete nëpërmjet infrastrukturës së tyre lokale si dhe infrastrukturave të ndërmarrjeve komunale (të komunës), të cilat praktikisht funksionojnë si ndërmarrje publike komunale. Komunat kanë për obligim furnizimin me ujë të pijshëm dhe janë përgjegjës të ndërmarrjes publike për furnizim me ujë të cilat menaxhojnë me infrastrukturën për furnizim me ujë të pijshëm.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë përgjegjësi për funksionim të rrjetit lokal për përcjelljen e trupave lokal ujqor në suazat e territoreve të tyre, funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit lokal monitorues.

Në lidhje me ujërat për larje, komunat janë përgjegjëse për përkufizimin e zonave për larje në kuadër territoreve të tyre, të ndërmarrin masa për mbrojtje nga ndotja, të përcaktojnë periudhën e kohëzgjatjes së sezonit për larje dhe të miratojnë Program të masave me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ujërave për larje.

Komunat janë përgjegjëse për miratimin dhe realizimin e planeve operative për siguri dhe mbrojtje prej vërshimeve si dhe të përpilojnë, miratojnë dhe publikojnë raporte për aktivitete të realizuara për mbrojtjen nga ndikimi i dëmshëm i ujërave.

NJVL-të janë kompetente për grumbullimin, kullim dhe trajtimin e ujërave të zeza të cilat janë rezultat nga, ose krijohen në territorin e tyre, duke përfshirë edhe mënjanimin e llumit. NJVL-të janë gjithashtu kompetente për të siguruar që ujërat e zeza urbane që futen në sistemet për grumbullim trajtohen në mënyrë përkatëse para kullimit të tyre në pajtim me dispozitat e LU. Ato duhet t'i sigurojnë, përmirësojnë dhe t'i zgjerojnë sistemet e kanalizimit, si dhe t'i pastrojnë e mirëmbajnë sistemet e kullimit.

Inspektorët e autorizuar për mjedis jetësor janë kompetent për kontroll të shkarkimit të ujërave të zeza, si dhe vajrave të zeza në kanalizim si dhe për të konstatuar nëse këto veprime realizohen në pajtim me ligjin, për kontroll të shkarkimeve prej instilacioneve me B-LEI dhe kontroll të sistemeve të kanalizimit të kullimit, duke përfshirë pusetat septike në territorin e tyre që shkarkohen në sistemet e kanalizimit.

Inspektorët e autorizur komunal janë kompetent për të kryer inspektim të dhënësve të shërbimeve komunale të cilët janë të formuar nga komunat dhe shfrytëzuesit e atyre shërbimeve komunale, si dhe zbatimin e vendimeve relevante të komunës për rregull komunal.

Ndërmarrjet komunale – Puna dhe mirëmbajtja e sistemeve për grumbullim, kullim dhe trajtim është përgjegjësi e Ndërmarrjeve publike komunale (NPK), të cilat formohen, kontrollohen dhe janë në pronësi të NJVL. NPK janë të obliguara të miratojnë programe vjetore për zhvillim, për sigurim të shërbimeve komunale pas marrjes së pëlqimit paraprak nga NJVL.


Në pajtim me Ligjin për përcaktimin e çmimeve për shërbimet ujore, të njëjtat janë të obliguara të përpilojnë Biznes plane dhe Plane për adaptimin e tarifave.



Projekti “Qytetarët – partner aktiv në reformat e politikave për ujë”

“Analizë e gjendjes së menaxhimit me ujërat në Republikën e Maqedonisë dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve”

4 FINANCIMI I MENAXHIMIT ME UJËRAT DHE INVESTIMET NË SEKTORIN E UJËRAVE



BUji si resurs është i domosdoshëm dhe përdoret për qëllime ekologjike, ekonomike dhe shëndetësore, siç janë furnizimi me ujë, vaditja si dhe në shumë procese tjera industriale. Në pajtim me parimin shfrytëzuesi paguan, lartësia e çmimit që e paguajnë shfrytëzuesit për ujin duhet t'i nxitë, që ujin ta përdorin në mënyrë efikase që do të kontribuojë drejt realizimit të qëllimeve në sektorin e mjedisit jetësor me atë që shfrytëzuesit e ndryshëm të ujit duhet të paguajnë kompensim përkatës.

4.1 Investime në Sektorin e ujërave

Kërkesat për plotësim të standardeve të mjedisit jetësor janë të mëdha dhe ato kërkojnë investime të mëdha mjeteve financiare. Në sferën e ujërave, plotësimet e kërkesave rezultojnë nga Direktiva për ujëra të zeza urbane dhe Direktiva për ujë të pijshëm, imponojnë nevojën për investimet të mëdha.

Në periudhën e kaluar në Republikën e Maqedonisë në sektorin për ujëra janë siguruar investimet të konsiderueshme veçanërisht në trajtimin e ujërave të zeza, më së shumti nëpërmjet shfrytëzimit të mjeteve nga donacionet (kryesisht nga BE), por edhe burime vendase e më së shumti nga buxheti i RM.

Në kuadër të zbatimit të Programit operativ 2007 – 2013, është përgatitur dokumentacion i projektit për ndërtim të pikave të trajtimit për rehabilitim, mbindërtim të rrjetit të kanalizimit për komunat Prilep, Tetovë, Strumicë, Kavadarci, Manastir, Gostivar, Radovish, Kërçovë dhe Dibër.

Ka filluar ndërtimi i disa pikave të trajtimit që duhet të përfundohen dhe të lëshohen në përdorim në vitin 2018 në këto komuna: Gjevgjeli, Kërçovë (në përdorim), Prilep, Radovish dhe Strumicë (në përdorim). Mjetet për ndërtimin në Kërçovë, Radovish dhe Strumicë janë nga Programi Operativ i BE-së për IPA 2007 -2013.

Ndërtimi i pikës së trajtimit të ujërave të zeza në Gjevgjeli, me mjete të siguruar nga Agjencia e Zvicrës për zhvillim dhe bashkëpunim dhe nga Republika e Greqisë;

Përgatitja e dokumentacionit teknik për ndërtim në fazë të parë të kolektorit për pikë trajtimi të ujërave të zeza në Koçani, mbështetja nga Agjencia Zvicrane për zhvillim dhe bashkëpunim;

Zgjerim dhe rehabilitim i rrjeteve të kanalizimit në Kumanovë dhe Berovë;

Përgatitje e dokumentacionit të planit për Veles dhe Shtip, rehabilitim dhe zgjerim i rrjetit të kanalizimit në Shkup dhe në Kërçovë.

Përgatitje të studimeve për fizibilitet për përmirësim të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza në Ohër, trajtimin e ujërave të zeza në Veles, trajtimin e ujërave të zeza në Shtip dhe trajtimin e ujërave të zeza në Shkup.

Në të ardhmen sipas Programit operativ të BE-së për IPA II 2014 – 2020, propozohet ndërtim i së paku dy projekteve më të mëdha shtesë: në Manastir, rajoni i Pellagonisë dhe në Tetovë, rajoni i Pollogut gjithashtu pritet që të vazhdojnë aktivitetet e ndarjes së mjeteve nga buxheti qendror si dhe buxhetet e dhënësve të shërbimeve ujore.

Krahas mjeteve të donatorëve të huaj dhe IPA, aktivitete të caktuara do të financohen nga buxheti vendas me çka do të sigurohen mjete për financim ose bashkë-financim të: projektimit dhe ndërtimit të pikave për trajtim siç janë (Vollkova, Gllumova dhe Shisheva, Komuna Demir Hisar); ndërtim i ujësjellësit (komuna Likovë dhe Tetovë) si dhe të sistemit rajonal për furnizim me ujë (Zajaz); ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe pikës për trajtim të ujërave të zeza në fshatin Tërpejcë, Ohër, ndërtim i kanalit për grumbullimin e ujërave të zeza dhe atmosferike (Komuna Haraçinë), ndërtim i pjesës së rrjetit të kanalizimit të zeza (në vendbanimin Singjeliq); projektim dhe ndërtim i pikës së filtrimit të ujësjellësit në Gostivar, ndërtim i pikës për filtrim të ujit të pijshëm (fshati Dobridoll, komuna Vrapçishtë dhe ndërtim i stacionit për filtrim në ujësjellësin në Gostivar.

4.2 Programi për menaxhim me ujëra

Mjetet për menaxhim dhe zhvillim të sektorit të ujërave sigurohen prej:

- Buxhetit të Republikës së Maqedonisë
- buxheteve të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit dhe
- kompensim për shfrytëzim të ujit;
- fonde ndërkombëtare dhe evropiane.

Mjete për ndërtim dhe mirëmbajtje të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit sigurohen nga çmimi i shërbimit për furnizim me ujë dhe kullim të ujërave si dhe kompensimi për kyçje në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Në LU në nenin 213 janë përcaktuar kompensimet në vijim: kompensimi për shfrytëzim të ujit të dedikuar për konsum nga njeriu; kompensimi për shfrytëzim të ujit për vaditje, kompensimi për shfrytëzim të ujit kullim në tokë; kompensimi për shfrytëzim të ujit gjatë prodhimit të energjisë elektrike; kompensimi për shfrytëzim të ujit për energji termale prej ujërave gjeotermale; kompensimi për shfrytëzim të ujit për kultivim të peshkut, në vivarë dhe në kafaze dhe për shpendët ujore; kompensimi për shfrytëzim të ujit për trajtim dhe ndarje të rërës, çakallit dhe gurit; kompensimi për shfrytëzim të ujit për prodhim dhe përpunim të ushqimit dhe pijeve, nevoja industriale dhe teknologjike dhe kompensimi për shkarkim në ujëra dhe kompensimi për nxerrje të rërës, çakallit dhe gurit.

Mjetet e arkëtuara nga kompensimet përdoren në bazë të Programit për menaxhim me ujërat, të cilin me propozim të MMJPH, kurse në marrëveshje me MSH, MBPEU dhe MTL e miraton QRM.

MMJPH çdo vit parashtron raport në QRM për realizimin e mjeteve prej kompensimeve të caktuara në Programin për menaxhim me ujëra.

Me programin për menaxhim me ujëra financohet dhe/ose bashkë-financohet:

- Realizimi i projekteve shumëvjeçare, programe, aktivitete dhe/ose masa të cilat janë masa të inkorporuara në dokumentet e programeve dhe planeve të miratuara në pajtim me LU;
- Përpunimi i dokumenteve të programit dhe planit të caktuara me ligj;
- Realizimi i projekteve, programeve, aktiviteteve dhe/ose masave të dedikuara për komunitat, nëpërmjet buxheteve të organeve të administratës shtetërore.

Në Programin për ujëra për vitin 2018 është paraparë alokim i gjithsej 71.100.000,00 denarë për dedikimet në vijim:

Program për menaxhim me ujëra për vitin 2018			
Dedikimi i mjeteve		%	Mjete të planifikuar në (denarë)
1.	- Projektim dhe ndërtim të objekteve të reja dhe mirëmbajtje e avancim të objekteve ekzistuese për furnizim publik me ujë, - Rregullim dhe rikonstruktim të rrjedhave ujore,	79,2	46.000.000,00 10.300.000,00
2.	- Përpunim i Planit për menaxhim dhe mbrojtje nga rreziku prej vërshimeve në pellgun e lumit Lepenc - Përpunim i Planit për menaxhim dhe mbrojtje nga rreziku prej vërshimeve në pellgun e lumit Treska - metodologji për përcaktimin e rrjedhës minimumale të pranueshme	6,3	1.500.000,00 1.500.000,00 1.500.000,00
3.	Blerje të kimikateve për zbatimin e monitorimit të Jugohrom	11,1	7.900.000,00
4.	Shpenzime për zbatim të programit	3,4	2.400.000,00
GJITHSEJ		100	71.100.000,00

4.3. Programe tjera me të cilat financohen aktivitete në sektorin e ujërave

Mjetet për financim të aktiviteteve në fushën e ujërave sigurohen edhe nëpërmjet Programit për investim në mjedisin jetësor. Programe, projekte dhe aktivitete tjera të përshtatshme për financim me mjetet e programit për investime në mjedisin jetësor janë: blerje të pajisjeve për mbrojtje të drejtpërdrejtë të mjedisit jetësor dhe mbrojtje e avancim të shëndetit të njerëzve; përpilim të dokumentacionit të investimeve dhe studimeve për fizibilitet dhe realizimin e tyre; përpunimin e planeve operative dhe realizim të fazave të veçanta të planeve operative nga leja për harmonizim; realizimi i punëve ndërtimore për mbrojtje të drejtpërdrejtë të mjedisit jetësor; stimulim të selektimit, riciklimit dhe mënjanimin të mbeturinave; harmonizim me normat dhe standardet për mjedis jetësor; përpunim të studimeve dhe dokumenteve të planit për mbrojtjen dhe avancimin e biodiversitetit; edukim dhe trajnim të kuadrove dhe aktivitete tjera të ngjashme për mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor.


Mjetet nga programi shfrytëzohen për financim të përgatitjes dhe zbatimit të programeve, projekteve dhe aktivitete tjera si dhe për ndërmarrje të masave parandaluese dhe masa për stimulim, ruajtje, shfrytëzim të qëndrueshëm, mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetësor.

Mjetet për realizimin e Programit për investim në mjedisin jetësor për vitin 2017 në shumë prej 122.800.000,00 denarë janë ndarë për dedikimet në vijim:

1. Përpunim të dokumentacionit teknik dhe realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtje, ruajtje dhe përmirësim të cilësisë së ujërave në vlerë prej 43.000.000,00 denarë;
2. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në vlerë prej 3.000.000,00 denarë;
3. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes publike, edukim dhe trajnim në sektorin e mjedisit jetësor në vlerë prej 8.000.000,00 denarë;
4. Stimulim të studimeve, programeve dhe projekteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore, për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe të natyrës në shumë prej 5.000.000,00 denarë;
5. Bashkë-financim të Projektit për organizata të fuqizuara qytetare për transponim participues dhe zbatim të pakos BE 2020, për klimë dhe energji në shumë prej 1.000.000,00 denarë;
6. Bashkë-financim të projekteve aktuale nga sfera e mjedisit jetësor në shumë prej 29.000.000,00 denarë;
7. Realizim të projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në pajtim me Programin për investim për vitet 2015 dhe 2016 në shumë prej 30.000.000,00 denarë dhe
8. Shpenzime për zbatim të programit në shumë prej 3.800.000, 00 denarë.

Me Programin për investim në mjedisin jetësor për vitin 2017 janë ndarë mjete financiare për vetëqeverisjet lokale për përpunim të dokumentacionit teknik për ndërtim të sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe për rregullim të shtretërve lumor. 43 milion denarë të paraparë për përmirësimin e cilësisë së ujërave janë ndarë për 12 komuna, për 14 projekte dhe atë:

- Komuna Zhelinë për ndërtim të rrjetit të kanalizimit fekal në vendbanimin Zhelinë;
- Komuna Tearcë për përpunim të dokumentacionit për kullim të ujërave të zeza;
- Komuna Dibër për kanalizim atmosferik (gyp përçues për praninë të ujërave nga Lumi i Vakëfit), Dibër;
- Komuna Vasilevë për përpunim të dokumentacionit teknik për kanalizim në fsh. Dobrashinci;
- Komuna Kumanovë për përpunim të dokumentacionit teknik për rrjetin e kanalizimit për fsh. Tabanovcë, Sopot dhe Çetirce;
- Komuna Gostivar për vazhdim të ndërtimit të kanalizimit fekale në vendbanimin Debresh;
- Komuna Bërvenicë për projekt themelor për kolektor kryesor për rrjetin e kanalizimit fekale për vendbanimin Çellopek i Poshtëm;
- Komuna Likovë për rregullim të shtratit lumor të lumit të Sllupçanit;
- Komuna Pllasnicë për kanalizim fekal për pjesë të vendbanimit Pllasnicë e Poshtme, ndërmjet lumit Treska dhe rrugës rajonale Prilep-Kërçovë;
- Komuna Kriva Pallankë për ndërtim shtesë të rregullimit të Luginë Skërljava;

- 
- Komuna Strumicë për rregullim të përroit Shën Iliski në afërsi të rrethojës bazike afër derdhjes në lumin Vodoçnicë;
 - Komuna Strumicë për rregullim të përroit Republika e Krushevës në afërsi të rr. Kliment Ohridski afërt derdhjes në lumin Tërkajna me rregullim të parterit rreth kanalit;
 - Komuna Strumicë për përpunim të dokumentacionit teknik për projektin Kolektori Kryesor fekale për blloqet urbane të sapo-urbanizuara në Strumicë nr. 35-42;
 - Komuna Rankovcë për përpunimin e projektit infrastrukturor për rrjet kanalizimi për ujëra të zeza në vendbanimin Opillë.

Në Programin për investim në mjedisin jetësor për vitin 2018 janë paraparë mjete në shumë prej 98.000.000,00 denarë të shpërndara për dedikimet në vijim:

1. Përgatitje e dokumentacionit teknik dhe ndërtim të sistemeve të kanalizimit dhe sisteme për kullim të ujërave dhe trajtimin e ujërave të zeza në shumë prej 45.000.000,00 denarë;
2. Realizim i projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në shumë prej 4.000.000,00 denarë;
3. Realizim i projekteve dhe aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes publike, edukim dhe trajnim në fushën e mjedisit jetësor në shumë prej 8.000.000,00 denarë;
4. Stimulim të studimeve, programeve dhe projekteve arsimore, hulumtuese dhe zhvillimore për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor dhe natyrës në shumë prej 6.000.000,00 denarë;
5. Bashkë-financim të Projektit për zhvillim të kapaciteteve për sigurim të qëndrueshmërisë së Liqenit të Dojranit në shumë prej 2.000.000,00 denarë;
6. Bashkë-financim të Projektit për përgatitje të dokumentacionit për infrastrukturë komunale prioritare në komunën Saraj në lartësi prej 2.000.000,00 denarë;
7. Përkrahje të masave dhe aktiviteteve për reduktimin e ndotjes së ajrit në Republikën e Maqedonisë në shumë prej 10.000.000,00 denarë;
8. Realizim i projekteve dhe aktiviteteve të miratuara në pajtim me Programet për investim për vitet 2015, 2016 dhe 2017 në shumë prej 18.000.000,00 denarë dhe
9. Shpenzime për zbatim të programit në shumë prej 3.000.000,00 denarë.

Krahas MMJPH, mjete duhet të sigurohen edhe nga buxheti i Ministrisë për transport dhe lidhje për financimin e projekteve që kanë të bëjnë me furnizimin me ujë dhe grumbullimin e trajtimin e ujërave të zeza.

Në mënyrë plotësuese, për financimin e aktivitete të lartpërmendura, mjete mund të sigurohen edhe nëpërmjet Programeve për zhvillim rajonal përmes Byrosë për zhvillim rajonal.



Projekti “Qytetarët – partner aktiv në reformat e politikave për ujë”

“Analizë e gjendjes së menaxhimit me ujërat në Republikën e Maqedonisë dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve”

5

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË KONSUMATORËVE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE PËR UJËRAT DHE MENAXHIMIN ME UJËRAT



5.1. Të drejtat e konsumatorëve

Në kontekst të krijimit të politikave për ujëra duhet të merret parasysh edhe aspekti i përfshirjes së konsumtarëve në krijimin e politikave si dhe pjesëmarrja e tyre në menaxhimin me ujërat.

Baza për miratimin e rregullores ligjore për mbrojtjen e konsumatorëve në botë përkatësisht në vendet e BE-së si dhe në Republikën e Maqedonisë bazohet në tetë të drejtat e konsumatorëve nga ana e Asamblesë Gjenerale të OKB në vitin 1985 të cilat kanë të bëjnë me:

1. Sigurimin dhe dispozicioni i prodhimeve dhe shërbimeve më të nevojshme të qytetarëve;
2. Kompensim të dëmit (e drejtë për kompensim të dëmit për produkte ose shërbime të cilat kanë cilësi të ulët dhe prej të cilave është shkaktuar dëm);
3. Siguri e prodhimeve dhe shërbimeve (e drejtë e blerjes dhe përdorimit të prodhimeve dhe shërbimeve të mbrojtura dhe të sigurta të cilat nuk do ta rrezikojnë shëndetin ose jetën e konsumatorit gjatë përdorimit normal);
4. Informimi (e drejta e informimit të saktë dhe me kohë nëpërmjet mediave, revistave për konsumtarotë, broshurave etj.);
5. Krijim të mekanizmave për pjesëmarrje të qytetarëve si konsumatorë në krijimin dhe zbatimin e politikës për mbrojtjen e konsumatorëve në të gjitha nivelet kur vendoset për interesat e tyre ekonomike;
6. Arsimi (edukim të konsumatorëve për të drejtat e tyre nëpërmjet procesit arsimor);
7. Zgjedhje (mundësi për zgjedhje ndërmjet më tepër prodhimeve dhe shërbimeve me cilësi të garantuar dhe me çmime të pranueshme) dhe
8. Mjedis jetësor i shëndosh (e drejta për jetë dhe punë në mjedis që nuk paraqet rrezik për jetën dhe shëndetin e qytetarit).

Duke u nisur nga qëllimi themelor i projektit për pjesëmarrje aktive të konsumatorëve në krijimin e politikave për ujëra, mund të konstatohet se pjesëmarrja është drejtpërdrejtë e lidhur me gjashtë prej gjithsej tetë të drejtave të konsumatorëve dhe atë me:

- Sigurimin e nevojave themelore të qytetarëve që kanë të bëjnë me sigurimin e ujit të pijshëm dhe të rregullt për çdo qytetar në Republikën e Maqedonisë;
- Sigurim të prodhimeve, përkatësisht ujë cilësor dhe të sigurt që i nënshtrohet kontrollit dhe standardeve të larta;
- mundësia për informim, që u jep të drejtën konsumatorëve të jenë të informuar për aspekte të caktuara shëndetësore të ujit të pijshëm, mungesa, ndërprerje të furnizimit, cilësi të sistemit distributiv nëpërmjet të cilit uji i pijshëm dërgohet në ekonomitë shtëpiake, mundësi për parashtrim të vërejtjeve dhe ankesave;
- mbrojtje e mjedisit jetësor ose sigurim të mjedisit jetësor të shëndosh dhe përgjegjësi e konsumatorëve dhe shtetit në sigurimin e tij si dhe sistem për denoncim që mjedisi është duke u ndotur dhe
- krijim të mekanizmave për pjesëmarrjen e qytetarëve si konsumatorë në krijimin dhe zbatimin e politikës për mbrojtjen e konsumatorëve në të gjitha nivelet kur vendoset për interesat e tyre ekonomike.

Qëllimi i politikës evropiane është të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe mbrojtje shtesë për grupet e cënueshme të konsumatorëve (siç janë fëmijët, të moshuarit, të sëmurit, të varfrit). Fuqizimi i pozitës së konsumatorëve dhe mbrojtja efikase e sigurisë së tyre dhe të interesave të tyre ekonomike paraqesin objektiv thelbësor të politikës evropiane, kurse me nenin 97 të MSA, Republika e Maqedonisë obligohet që standardet për mbrojtjen e konsumatorëve t'i harmonizojë me standardet e BE-së, me qëllim që të mundësoj mbrojtje efikase për të drejtat e konsumatorëve dhe funksionim të ekonomisë së tregut.

5.1.1 Rregullore për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve

Legjislacioni për konsumatorët paraqet pako vëluminoze të ligjeve dhe akteve nënligjore në të cilat janë përcaktuar norma juridike me të cilat drejtpërdrejtë ose tërthorazi mbrohen të drejtat e konsumatorëve.

Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve (LMK) është ligj i përgjithshëm me natyrë specifike juridike, në të cilin janë përfshirë rregullat e përgjithshme për mbrojtjen e konsumatorëve përkatësisht është rregullorja themelore (lex generalis), në raport me ligjet tjera (lex specialis) që kanë të bëjnë me sfera të posaçme.


Transponimi i Direktivave për mbrojtjen e konsumatorëve të Bashkimit Evropian në ligjin e përgjithshëm është bërë në pajtim me rregullin *rationae personae*, ashtu që sipas Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, me fjalën konsumator nënkuptohet vetëm person fizik, përkatësisht sipas përkufizimit, konsumator donë të thotë: “çdo person fizik i cili blen prodhime ose shfrytëzon shërbime për konsum të drejtpërdrejtë personal në hapësira afariste të tregtarit, jashtë hapësirave afariste si dhe me marrëveshje nga distanca për qëllimet që nuk bëjnë pjesë në veprimtarinë e tij tregtare, ekonomike, zejtare ose profesionale”.

Domeni i participimit qytetar në shërbimet publike në pjesën VI të LMK, që ka të bëjë me shërbimet publike të cilat u jepen konsumatorëve (prej nenit 118 deri në nenin 120). Shërbime publike, në aspekt të LMK konsiderohen shitja e energjisë elektrike prej rrjetit distributiv, energjisë termale, shërbimet publike të telekomunikimeve, shërbimet postare, shërbimet për transport të udhëtarëve në komunikacionin publik urban dhe ndër-urban, furnizimi me ujë të pijshëm, kullimi e ujërave të zeza dhe mbajtja e pastërtisë, si dhe shërbime tjera të caktuara me ligj. Kompensimi për shërbimet publike të konsumatorëve kur sipas natyrës së shërbimit publik është e mundur, duhet të llogaritet sipas konsumit në periudhë të caktuar kohore me aplikim të sistemit tarifor të përcaktuar me ligj. Nëse kompensimi nuk është llogaritur në këtë mënyrë, konsumatori, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i faturës për arkëtim të shërbimeve mund të parashtrorë kundërshtim me shkrim tek dhënësi i shërbimit. Dhënësi i shërbimit është i obliguar në afat prej 30 ditëve nga kundërshtimi i parashtruar të prononcohet për kundërshtimin, kur në bazë të LMK, tregtari duhet t'i mundësojë konsumatorit njoftim paraprak me të gjitha kushtet e shfrytëzimit të shërbimeve publike dhe ato kushte t'i publikojë në së paku dy gazeta ditore.

LMK nga miratimi i tij e deri në vitin 2018 ka pësuar numër të madh ndryshimesh dhe plotësimesh, ndërsa për të njëjtin ende nuk është hartuar tekst i spastruar, çka për konsumatorin e thjeshtë shkakton vështirësi në lidhje me qasjen dhe kuptueshmërinë e dispozitave të Ligjit. LMK ekzistues nuk është tërësisht i harmonizuar me të drejtën e BE-së dhe ka më tepër mangësi për realizimin e mbrojtjes efektive të të drejtave dhe interesave të konsumatorëve. Në vitin 2015 nga ana e Organizatës së konsumatorëve të Maqedonisë (OKM) në Ministrinë e ekonomisë janë parashtruar udhëzime për përpunimin e Strategjisë për mbrojtjen e konsumatorëve, me të cilat, ndër tjerash, propozohet edhe miratim i ligjit të ri. Aktualisht Ligj i ri për mbrojtje të konsumatorëve është duke u përgatitur dhe në hartimin e tija janë përfshirë edhe ekspertë të OKM të cilët marrë pjesë në grupin punues për përgatitjen e ligjit.

Në LMK e ri do të duhet saktë të përmenden shërbimet publike dhe të njëjtat të kategorizohen në shërbime publike që jepen në nivel qendror dhe shërbime publike që jepen në nivel lokal (shërbime komunale), e të cilat janë të rregulluara me Ligjin për veprimtaritë komunale (LVK). Pjesë e shërbimeve publike, duke i përfshirë edhe ato komunale, duhet të përcaktohen si shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik për të cilat garantohen të drejta minimale për konsumatorët. Gjithashtu, në LMK duhet të përcaktohen obligimet e dhënsëve të shërbimeve dhe organet dhe institucionet kompetente që i kanë ingerencat në sferën e mbrojtjes së konsumatorëve, procedurat dhe afatet për veprim lidhur me ankesa dhe zgjidhje të kontesteve dhe të drejtat e përgjithshme të konsumatorëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve publike. Në rregullimin e kësaj fushe vëmendje e veçantë duhet t'i kushohet mungesës aktuale të konsistencës mes Ligjit për vetëqeverisje lokale (neni 22, paragrafi (1), aline 4) në të cilin janë caktuar ingerencat e komunave përmes numërimit të 21 veprimtarive komunale që nuk janë harmonizuar me LVK (në të cilin rregullohen 19 veprimtari). Për shkak të sigurisë më të madhe në qarkullimin juridik, si dhe konsistencës në formulimin dhe rregullimin e shërbimeve publike, nevojitet harmonizim i veprimtarive në LMK, LVL dhe LVK.

Përndryshe, kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe organizatave qytetare, është e rëndësishme të përmendet se neni 126 i LMK më afërsisht i përcakton ingerencat e Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe e përkufizon strukturën e tij si trup i përhershëm punues në këshillat e komunave dhe Këshillin e Qytetit të Shkupit. Ndryshe, këta trupa përbëhen prej përfaqësuesve të institucioneve publike, sektorit qytetar dhe



afarist, përkatësisht “anëtarët e këshillave për mbrojtjen e konsumatorëve të komunave, përkatësisht Qytetit të Shkupit zgjedhen nga radhët e këshilltarëve, shoqatave të konsumatorëve dhe prej shoqatave tjera të qytetarëve, ndërmarrjeve publike, odave ekonomike dhe organeve tjera shtetërore të kontrollit inspektues që kanë kompetenca në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve.” Këshillat kanë për obligim që – këshillave komunale, përkatësisht Qytetit të Shkupit t’i propozojnë programe lokale dyvjeçare për mbrojtjen e konsumatorëve, në pajtim me Programin për mbrojtjen e konsumatorëve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Më tutje, neni 126 nga LMK parasheh që “Këshillat për mbrojtjen e konsumatorëve të njëjste të vetëqeverisjes lokale realizojnë kontakte të rregullta dhe bashkëpunim me Këshillin për mbrojtjen e konsumatorëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë”.


Obligimi ligjor për formim të këshillave për mbrojtjen e konsumatorëve në nivel të vetëqeverisjes lokale nuk realizohet në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht obligimi realizohet aty ku ekzistojnë organizata të konsumatorëve (Manastir, Koçani, Ohër, Shkup, Tetovë dhe Shtip). Shembull pozitiv për zbatimin e LMK paraqet Qyteti i Shkupit ku Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve funksionon në mënyrë aktive prej vitit 2014 dhe miraton programe dyvjeçare për mbrojtjen e konsumatorëve.¹⁴

Përndryshe shkeljet e të drejtave të konsumatorëve në domen të shërbimeve publike, evidentohen nga ana e Avokatit të Popullit. Në raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2017 sugjerohet se gjendja nga viti në vit nuk është duke u përmirësuar. Përkatësisht, Avokati i Popullit në raportin e vet konstaton shumë probleme të qytetarëve për shkak të veprimit joadekuat të dhënësve të shërbimeve – ndërmarrje publike dhe kompani tjera. Në vitin 2017, qytetarët kanë parashtruar rreth 300 parashtrësia me të cilat është kërkuar intervenim për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve. Numri më i madh i parashtrësive, përkatësisht pothuaj gjysma e tyre ka qenë në lidhje me punën e ndërmarrjeve publike që kryejnë veprimtari komunale për furnizim me ujë të pijshëm dhe kullimin e ujërave të zeza urbane, para se gjithash NP Ujësjellës dhe kanalizim Shkup (NP). Në këtë rast, është karakteristike se nuk bëhet fjalë për raste të izoluar, përkundrazi, qytetarët janë ankuar për gjendje të cilat përsëriten. Avokati i popullit pas zbatimit të procedurës së duhur, në raste konkrete ka konstatuar shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të parashtruesve të parashtrësive si rezultat i mangësive dhe parregullsive në punën e shërbimeve të NP dhe mosrespektim të dispozitave nga LMK, Ligji për furnizim me ujë dhe kullimin e ujërave të zeza urbane dhe Ligji për marrëdhëniet obligative. Konkretisht, NP shfrytëzuesve të shërbimit për furnizim me ujë, sikur edhe vite më parë, u ka dërguar “fatura të jashtëzakonshme” me shuma shumë të larta, me çrast pa dhënë arsytim përkatës për cilën periudhë vlejnë faturat dhe pa përmendur bazën juridike me të cilën mund të veprohet në atë mënyrë. Me atë, NP ka kërkuar nga shfrytëzuesit të paguajnë për shërbime që nuk është siguruar, përkatësisht ata nuk e kanë shfrytëzuar në vëllim për të cilën janë ngarkuar me borxh, thuhet në raportin e Avokatit të Popullit. Gjithashtu, shfrytëzuesit të cilët kanë qenë të shkyçur nga sistemi i ujësjellësit, për kyçje të sërishme kanë qenë të kushtëzuar nga kjo NP ta paguajnë borxhin e mbetur me një këst dhe në tërësi edhe pse një pjesë të saj është arkëtuar me procedurë përmbarimi.”

5.1.2. Të drejtat e konsumatorëve në Ligjin për veprimtari të komunale

LVK rregullon 19 veprimtari komunale sikur shërbime të interesit publik. Për numrin më të madh të veprimtarive të shënuara një-për-një në LVK janë miratuar ligje të veçanta. Karakteristike nga aspekti i konsumatorëve e veçanërisht duke e pasur parasysh përkufizimin për konsumator si person fizik, sipas këtij Ligji, shërbimet komunale ndahen në dy grupe shërbimesh: ato për plotësimin e konsumit individual dhe ato për plotësimin e konsumit të përbashkët. Në shërbime për plotësimin e konsumit individual bëjnë pjesë: përpunimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm, përpunim dhe furnizim të ujit teknologjik, kullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, transport të udhëtarëve në komunikacionin rrugor, grumbullim dhe transportim të mbeturinave komunale, ndërtim dhe mirëmbajtje të varrezave, përdorim të vendit të shitjes në tregje të hapura dhe të mbyllura, pastrim të oxhaqeve dhe pajisje për nxjerrjen e tymit, mënjanim të mjeteve të dëmtuara, mirëmbajtje të

¹⁴ Në aspekt historik, mbrojtja e konsumatorëve në nivel lokal për herë të parë është inkorporuar me Ligjin për vetëqeverisje lokale (LVL) prej vitit 2002, kur në pajtim me Nenin 56 jepet mundësia Këshilli i komunës, përkatësisht Qyteti i Shkupit, të formojë Këshill për mbrojtje të konsumatorëve. Këshillat e këtillë kanë kompetencë të shqyrtojnë çështje dhe të japin propozime që janë në lidhje me cilësinë e shërbimeve të administratave publike të komunës, ndërkaq në pajtim me LVL përbëhen prej përfaqësuesve të grupeve më të mëdha të shfrytëzuesve të shërbimeve publike. Nocioni “grupe më të mëdha të shfrytëzuesve të shërbimeve publike”, megjithëse nuk është i përpiktë, i përfshin shoqatat e konsumatorëve, shoqatat e pensionerëve, shoqatat e grave dhe tjerë. Përfaqësuesit e shoqërisë qytetare kanë mundësinë nëpërmjet këtyre këshillave të reagojnë për parregullsi të caktuara në aspekt të shërbimeve publike, ose në anën tjetër të kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.



pusetave septike, furnizim të gazit në instrumentin matës të shfrytëzuesit dhe furnizim të energjisë termike në instrumentin matës të shfrytëzuesit.

Në shërbime për plotësimin e konsumit të përbashkët bëjnë pjesë: kullimi dhe shkarkimi i ujërave atmosferike, rehabilitim dhe mbrojtje e rrugëve lokale, rrugëve urbane dhe objekteve tjera infrastrukturore, mirëmbajtje e pastërtisë publike dhe shfrytëzim të parqeve, kopshteve zoologjike, pyjeve park, sipërfaqeve për rekreacion dhe gjelbërimeve, të sinjalizimit të trafikut në rrugët urbane dhe lokale të komunave, ndriçimi publik, mirëmbajtje e varrezave, mirëmbajtje e objekteve në tregjet e hapura dhe të mbyllura për shitje me shumicë dhe pakicë dhe çrënjosjen e kafshëve të pastrehuara, dekorimin e vendbanimeve, mirëmbajtje e nyjeve sanitare dhe mirëmbajtje e pajisjeve urbane.

Në LVK parashihet rregullim me kontratë i raporteve ndërmjet dhënësve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve komunale, përkatësisht në nenin 4 paragrafi (5) të LVK thuhet se: “shfrytëzues i shërbimit komunal është person juridik dhe fizik që i përdor shërbimet e dhënësit të shërbimit, të drejtat dhe obligimet e të cilit rregullohen me marrëveshje të nënshkruar në mënyrë të ndërsjellë”, ndërsa më tutje, me nenin 18 të LVK thuhet se dhënia e shërbimit komunal për shfrytëzues të konsumit individual komunal rregullohet me kontratë të nënshkruar ndërmjet dhënësit dhe shfrytëzuesit të shërbimit në mënyrë të caktuar sipas ligjit.

Në praktikë vërehet se te disa shërbime mungon përbushja e obligimit ligjor për nënshkrim të kontrastës (në këtë rast edhe për shërbimin: furnizimi me ujë të pijshëm, përpunim dhe furnizim të ujit teknologjik, kullim dhe trajtim të ujërave të zeza), që do të ishte nënshkruar në formë të shkruar, ndërkaq prej dispozitave qartë do të shiheshin të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese, të dhënësit dhe shfrytëzuesit të shërbimit.

Në nenin 17 të LVK përcaktohet ndalesë për kufizimin e qasjes për shërbim publik të konsumatorëve përveç në raste të caktuara me kushte dhe në mënyrë të caktuar me ligj. Pozitive është se me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari komunale G. Zyrtare e R. Maqedonisë, nr.31 prej 22.02.2016 shtohet paragraf i ri (2) me të cilin parashihet që nëse shfrytëzuesit i kufizohet qasja në shërbim komunal ka të drejtë për kundërshtim në MTL, në afat prej 15 ditëve nga dita e kufizimit. Me ligjin në fjalë vazhdohet afati për parashtrimin e ankesë kundër aktvendimit të organit kompetent për kompensimin për shërbimin e përbashkët komunal prej 8 në 15 ditë.

Në të ardhmen duhet të bëhen ndryshime në LVK në lidhje me informimin për ndërprerjen e dhënien e shërbimit, përkatësisht të përfshihet obligimi i dhënësit të shërbimit që në formë të shkruar ose nëpërmjet mjeteve për informim publik ta njoftojë konsumatorin qoftë kur bëhet fjalë për ndërprerje individuale ose kolektive të shërbimit.

5.1.3 Konsumatorët në dispozitat për ujërat

Të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve janë veçanërisht të rëndësishme në formulimin e çmimit të shërbimit ujqor si dhe mundësinë për pjesëmarrje të konsumatorëve në përcaktimin e çmimeve.

Në tekstin më poshtë është paraqitur procedura dhe roli i konsumatorëve në përcaktimin e çmimit të shërbimit ujqor.

5.1.3.1 Ligji për përcaktimin e çmimit të shërbimeve ujqore

Mënyra e përcaktimit të çmimit të shërbimeve ujqore caktohet me Ligjin për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve ujqore (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 7/16).

Ligji duhet të sigurojë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ujqore për dhënie të papenguar të shërbimeve ujqore në pajtim me praktikat më të mira ekzistuese dhe aplikim të parimit ndotësi paguan, shfrytëzuesi paguan dhe parimin shpenzime për resursin në pajtim me LU dhe

- përmirësim të efikasitetit të shërbimeve ujqore që të sigurohen shërbimet ujqore me cilësinë më të mirë me minimum shpenzime dhe
- kushte stabile dhe të parashikueshem për punë të dhënësve të shërbimeve ujqore dhe mbrojtje të konsumatorëve dhe shfrytëzuesve nga keqpërdorimi i pozitës dominuese të dhënësve të shërbimeve ujqore.



Dhënës i shërbimit ujqr është person juridik i themeluar nga shteti, përkatësisht pushteti lokal që siguron një ose më tepër shërbime ujqore në rajonin e një ose më tepër komunave, komunitat e qytetit të Shkupit ose në Qytetin e Shkupit dhe për shërbimin ujqor që e jep arkëton çmim për shërbimin e siguar ujqor, nga shfrytëzuesi i fundit i shërbimit ujqor.

Shërbimet ujqore të cilat i sigurojnë dhënësit e shërbimeve, si shërbime themelore për shfrytëzuesit e tyre përfundimtar janë: furnizimi me ujë të papërpunuar dhe/ose ujët të pijshëm, grumbullim dhe derdhje e ujërave të zeza urbane dhe/ose trajtim të ujërave të zeza.

Shfrytëzues të fundit të shërbimeve ujqore janë: ekonomitë e veçanta shtëpiake (personat fizikë që shfrytëzojnë shërbim ujqor për nevoja e tyre ose për nevojat e ekonomisë shtëpiake, konsumatorë komercial dhe industrial), person juridik që ushtron veprimtari tregtare ose tjetër për shkak të realizimit të fitimit me prodhim, tregti dhe dhënie të shërbimeve në treg, kurse i cili është i regjistruar për kryerje të veprimtarisë tregtare dhe është i kyçur në sistemin për shfrytëzim të shërbimeve ujqore dhe konsumator institucional (njësi të vetëqeverisjes lokale dhe pushtetit shtetëror, institucione publike të cilat janë të kyçura për shfrytëzim të shërbimit ujqor).

Lartësia e çmimit të shërbimit ujqor përcaktohet varësisht nga tarifa e shërbimit ujqor, kompensimet për shfrytëzim të ujërave nga LU si dhe tatimet e përcaktuara me ligj.

Çmim i shërbimit ujqor është kompensimi i përgjithshëm që dhënësi i shërbimit ujqor e kërkon të paguhet nga shfrytëzuesi i fundit të shërbimit ujqor dhe e përfshin pagesën që rezulton nga tarifa për shërbimin ujqor të dhënësit të shërbimit ujqor, kompensimet shoqëruese me shfrytëzimin e ujërave të përcaktuara me LU ose me ligj tjetër, si dhe tatimet e përcaktuara me ligj.

Lartësia e tarifës së shërbimit ujqor varet prej shpenzimeve që ka bërë dhënësi i shërbimit ujqor për të siguar shërbimin ujqor, duke i përfshirë shërbimet për mbështetje.

Tarifa për shërbimin ujqor është vlera monetare e shërbimit, të cilën si pjesë e çmimit për shërbimet e dhëna ujqor, e kërkon dhënësi i shërbimeve ujqore nga shfrytëzuesit e fundit të shërbimeve ujqore.


Organ kompetent për përcaktimin e tarifës për shërbim ujqor është Komisioni Rregullator për Energjetikë (KRE). Kur bëhet përcaktimi i tarifës për shërbim ujqor duhet të mbahet llogari edhe për aspektin social përkatësisht pragun e pranueshëm për ekonomitë shtëpiake të rajonit në të cilin dhënësi e siguron shërbimin ujqor. "Pragu i pranueshëm" është kufiri i sipërm i shprehur në përqindje e pranueshmërisë financiare të shërbimeve ujqore e llogaritur në nivel të Republikës e Maqedonisë në të cilën çmimi i shërbimit ujqor nuk e tejkalon përqindjen e caktuar të të hyrave të përgjithshme për ekonomi shtëpiake në rajonin në të cilin sigurohet shërbimi ujqor. KRE së paku një herë në çdo tre vite, në periudhë të investimeve intensive, do të miratojë rekomandim për prag të pranueshëm në nivel të të hyrave në RM, kurse në çdo shtatë vite nëse ka më pak investime.

KRE me aktvendim i përcakton llojet e tarifave në vijim:

- Tarifa të shërbimit për furnizim me ujë të papërpunuar të dedikuar për furnizim të popullatës me ujë;
- Tarifa të shërbimit për furnizim me ujë të pijshëm ose furnizim me ujë;
- Tarifa të shërbimit për grumbullim dhe kullim të ujërave të zeza dhe
- Tarifa të shërbimit për trajtim të ujërave të zeza.

Llojet dhe mënyra e përllogaritjes së tarifave të shërbimit ujqor përcaktohen me Metodologjinë për përcaktim të tarifave për shërbim që është miratuar nga Komisioni Rregullator për Energjetikë dhe e publikuar në ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 63/17). Metodologjia i cakton tarifatat me të cilat dhënësit e shërbimeve ujqore do t'i realizojnë të hyrat e rregulluara të nevojshme për kryerje të një prej shërbimeve ujqore në vijim:

- furnizim me ujë të papërpunuar të dedikuar për furnizim të popullatës me ujë;
- furnizim me ujë të pijshëm ose furnizim me ujë;
- grumbullim dhe kullim të ujërave të zeza urbane dhe
- trajtim të ujërave të zeza.



Me ditën e fillimit të aplikimit të Metodologjisë për përcaktim të tarifave për dhënie të shërbimit ujor nga nenit 5 paragrafi (6)¹⁵ i këtij ligji, shfuqizohet neni 6¹⁶ i Ligjit për furnizim me ujë të pijshëm dhe kullimin e ujërave të zeza urbane si dhe ajo që ky ligj hyn në fuqi me ditën e publikimit në Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, kurse do të zbatohet nga 1 shtator 2016.

Mënyra e përcaktimit të tarifës për shërbim ujor, procedura për përcaktimin e tarifës ujore, kriteret për vlerësim të kërkesës dhe parashtrirat për përcaktim të tarifës për shërbim ujor, afatet për veprim, procedura për negociata, si dhe mënyra, procedura, kushtet dhe dokumentacioni i duhur për miratim të tarifës rregullatore për shërbim ujor është caktuar me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për përcaktim të tarifës për shërbime ujore dhe tarifa rregullatore për shërbim ujor është miratuar nga KRE dhe është publikuar në “Gazeta zyrtare e RM” nr. 63/17).

Dhënësi i shërbimit ujor, çmimin e shërbimit ujor e arkëton nga shfrytëzuesi i fundit. Tarifën për shërbim ujor përkatësisht tarifën rregullatore e përcakton KRE me aktvendim për çdo vit në veçanti.

Procedura për përcaktim të tarifave për shërbime ujore për çdo dhënës në veçanti rregullohet në bazë të vlerësimit të: shpenzimeve për sigurim të shërbimeve ujore dhe shërbimeve për mbështetje; lartësisë së tarifës së propozuar për shërbim ujor dhe çmimit të shërbimit ujor që do të arrihet me tarifën e propozuar dhe pranueshmërinë e saj financiare për ekonominë shtëpiake nga rajoni për të cilin jepet shërbimi ujor dhe përqindja e ekonomive shtëpake për të cilat do të tejkalohet pragu i pranueshëm financiar; investimet e planifikuara kapitale për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve ujore; efikasiteti i shërbimit ujor krahasuar me indikatorët e suksesit dhe arritja e vlerave të qëllimeve për indikatorët vendimtarë për përcjellje të suksesit.

Tarifat përcaktohen në bazë të kërkesës së parashtruar për përcaktim të tarifës për shërbim ujor me propozim-tarifa nga ana e dhënësit të shërbimeve ujore dhe draft-Planit të dërguar për adaptim të tarifave për shërbime ujore. Tarifa përcaktohet për çdo shërbim veçmas.

Pjesëmarrja e shoqatave qytetare mund të vërehet në paragrafin (7) të nenit 9 të Ligjit për përcaktim të çmimeve të shërbimeve ujore ku përkufizohet se KRE duhet të mbajë konsultime me dhënësit e shërbimeve ujore dhe shoqatat e shfrytëzuesve të fundit (konsumatorëve), si dhe me organet shtetërore përgjegjëse për menaxhim me ujëra dhe veprimtaritë komunale.

KRE pas kompletimit të kërkesës, të njëjtën e publikon në ueb faqen e vet dhe në gazeta ditore me qëllim që personat fizik dhe juridik të interesuar t'i dërgojnë mendimet dhe propozimet e tyre në lidhje me kërkesën e publikuar. Afati për parashtrimin e mendimeve nuk është më shumë se 5 ditë nga dita e publikimit të kërkesës. Në procedurën gjatë përcaktimit të tarifave për shërbimet ujore, KRE është e obliguar t'i shqyrtojë edhe vërejtjet e pranuar nga ana e dhënësit të shërbimit ujor, përkatësisht themeluesit të dhënësit të shërbimit ujor.

Nëse KRE vlerëson se vërejtjet e parashtruara mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në përcaktimin e lartësisë së tarifës për shërbime ujore, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vërejtjeve mund të nis procedurë për negociata me qëllim të harmonizimit të tarifave për shërbime ujore.

15 Llojet dhe mënyra e llogaritjes së tarifave për shërbim ujor, struktura e tarifave për çdo shërbim ujor veçmas, llojet e shpenzimeve që merren parasysh për llogaritje të tarifës për shërbimin ujor dhe të hyrat e nevojshme për mbulimin e atyre shpenzimeve, si dhe karakteristikat e tyre dhe mënyra e paraqitjes së tyre, përcaktohen me Metodologjinë për përcaktimin e tarifave për shërbimin ujor të cilën e miraton.

16 Mjetet për kryerje të veprimtarive nga Neni 5 i këtij ligji realizohen nga çmimi i ujit të pijshëm dhe shfrytëzimi në atyre shërbimeve dhe kompensimi për kycje në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit. (2) Çmimi i ujit të pijshëm dhe shkarkimin e ujërave të zeza urbane dhe ujërave atmosferike shprehan në den/m³. (3) Çmimi nga paragrafi (2) i këtij neni varet nga shpenzimet për furnizim me ujë të pijshëm për shfrytëzuesit e shërbimit dhe shkarkimin e ujërave të zeza urbane, shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor rreth burimit dhe në vet burimin, shpenzimet e eksploatimit, shpenzimet për mirëmbajtje, zëvendësim të pjesëve të amortizuara dhe dëmtimeve tjera, investimet kapitale, kamatat e pagesës së investimeve kapitale dhe shpenzimet tjera. (4) Përcaktimi i lartësisë së çmimit bëhet me metodologji, kurse në bazë këtyre kriterëve: - sasi e harxhuar e ujit të pijshëm nga shfrytëzuesit e shërbimit, si konsum mesatar dhe i tepruar dhe – kategori të shfrytëzuesve të shërbimit. Konsumi i ujit të pijshëm, si konsum mesatar sipas nenit për ekonominë shtëpiake e cakton këshilli komunal dhe Qyteti i Shkupit. (6) Çmimi për çdo metër kub ujë i harxhuar për pije mbi konsumin mesatar (konsum i tepruar i ujit të pijshëm) rritet për dy herë. (7) Çmimin e përcakton dhënësi i shërbimit, me pëlqim paraprak të themeluesit. (8) Çmimi përcaktohet si: - kompensim për m/3 ujë të pijshëm me derdhjen e ujërave fekale dhe ujërave atmosferike prej ekonomive shtëpiake dhe të ujërave fekale industriale; - kompensim për m/3 vetëm ujë i pijshëm dhe – kompensim për m³ vetëm për derdhje të ujërave fekale dhe ujërave atmosferike nga ekonominë shtëpiake dhe ujërat fekale industriale. (9) Metodologjinë për përcaktim të çmimit nga paragrafi (4) i këtij neni, e cakton ministri i cili udhëheq me organin e drejtorisë shtetërore kompetent për punët nga fusha e punëve komunale.



KRE e përcakton tarifën për shërbim ujor në seancë. Pas përpilimit të tekstit të aktvendimit për përcaktim të tarifës për shërbim ujor, KRE është i obliguar të konvokojë mbledhje përgatitore, që duhet të mbahet më së shumti deri në skadimin e ditës së 50-të nga dita e fillimit të procedurës. Me ftesën për prezencë në mbledhjen përgatitore dërgohet teksti i aktvendimit dhe mendimet e pranuar nga personat e interesuar juridik dhe fizik. Në debatin e mbledhjes përgatitore ftohen të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë përfaqësues të autorizuar të parashtruesit të kërkesës, të institucioneve dhe organizatave, si dhe persona tjerë juridik dhe fizik të interesuar.

Në aktvendim përcaktohet lartësia e tarifës për çdo shërbim ujor që e siguron dhënësi, përkatësisht përcaktohet shkalla minimale dhe maksimale e paraqitur në përqindje të vlerës së caktuar në suazat e së cilës lejohet dhënësi i shërbimit të merr Vendim për përcaktim të lartësisë së tarifës së shërbimit ujor. KRE i publikon aktvendimet në “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” dhe në ueb faqen e vet dhe të njëjtat menjëherë i dërgon tek dhënësi i shërbimit ujor dhe tek themeluesi i dhënësit të shërbimit ujor me qëllim të miratimit të vendimit për përcaktimin e tarifave për shërbime ujor. Kundër aktvendimit të miratuar të dhënësit të shërbimit ujor, kryetari i komunës ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore pranë Gjykatës administrative.

Në këtë Ligj ka mekanizma që qytetarët të mbrohen prej tarifave tepër të larta për shkak se vendimin për përcaktimin e tarifës dhënësit e shërbimeve, duhet ta dërgojnë për të marrë pëlqim nga kryetari i komunës i cili është i obliguar në afat prej 60 ditësh të nis procedurën për dhënie të pëlqimit, që nënkupton se kryetari i komunës mund edhe të mos jep pëlqim, me ç’rast nëse nuk është dhënë pajtim në afat prej 150 ditësh nga dita e publikimit të aktvendimit për përcaktimin e tarifës për shërbim ujor në “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, Komisioni rregullator do të sjell vendim për fillim të procedurës për miratim të Tarifës rregullatore për shërbim ujor.

KRE miraton Aktvendim për Tarifë rregullatore për shërbim ujor për çdo dhënës të shërbimit veçmas në rastet kur:

- Negociatat për përcaktim të TSHU nuk do të jenë të suksesshem përkatësisht nuk është arritur marrëveshje me dhënësin e shërbimit;
- Dhënësi i shërbimit nuk parashtron kërkesë për përcaktim të TSHU;
- Dhënësi nuk dërgon te KRE të dhëna shtesë për kërkesën e parashtruar për TSHU;
- Kryetari i komunës nuk ka dhënë leje përkatësisht këshilli i komunës nuk ka dhënë leje për vendimin për përcaktimin e TSHU.

Kontroll inspektues për zbatimin e ligjit kryen Inspektorati shtetëror i mjedisit jetësor nëpërmjet inspektorëve për ekonomi ujore.


Dhënësi i shërbimi nuk guxon të arkëtojë çmim për shërbim ujor nga shfrytëzuesi i fundit ku tarifa për shërbim ujor nuk është miratuar nga ana e Komisionit rregullator dhe nuk është e përcaktuar në aktvendimin për përcaktim të tarifave për shërbime ujore, përkatësisht aktvendim për tarifë rregullatore. Dhënësi, faturën për arkëtim të çmimit për shërbimin ujor nga shfrytëzuesi i fundit, i cili është person juridik e dërgon vetëm në formë elektronike në adresën e tij elektronike, ndërsa në adresën elektronike të shfrytëzuesit të fundit, i cili është person fizik, mund t’ia dërgojë faturën vetëm me kërkesë të tij.

